

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-1  
R14

JERONIM DE RADA

*Brëfime  
të  
Arbrit*

poemë

SHH-1  
R14

JERONIM DE RADA

# Rrëfime të Arbrit

poemë

Përshtatur në gjuhën e sotme

nga

ANDREA VARFI



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 6 000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1975

## P A R A T H Ë N I E

Poema «*Rrëfime të Arbërit*» është vepra e tretë e De Radës që poeti Andrea Varfi po u jep lexuesve të përshtatur në gjuhën e sotme, duke bërë kështu edhe një hap tjetër me rëndësi për njohjen sa më të gjerë të arbëreshit të madh të shekullit të kaluar.

Kjo vepër, e shkruar me sa duket në pjesën më të mirë krahas ose fill pas «*Këngëve të Milosaut*» dhe e përfunduar rreth viteve 1845-1846, ruan vlerat e përpjekjeve të para serioze të De Radës «për të hyrë në historinë e Arbërit (Shqipërisë), për të reflektuar në poezi aspekte nga më të ndryshmet të jetës e të shpirtit të njerëzve, për t'i çelur shtigje të reja vjershërimit në gjuhën shqipe e për të shtuar e përpunuar aftësitë shprehëse artistike të kësaj gjuhe. Në këtë novelat poetike, që përbëjnë këtë vepër, poeti i është afruar më tepër e më konkretisht se të «*Milosau*» ngjarjeve historike. Këtu ndjenjat e mendimet patriotike, në konkretësinë e tyre dhe të lidhura me

fatet e personazheve, kanë zënë vend më të gjerë dhe janë zbërthyer në disa aspekte. Po kështu edhe parashtrimi i subjekteve dhe thurja e tyre është më e natyrshme, më e detajuar, kurse stili, duke ruajtur tiparet epiko-lirike, anon më tepër nga trajta narrative, duke e bërë veprën më të kuptueshme për një rreth të gjerë lexuesish; pra, edhe të ndryshme, si nga «Milosau» i hershëm, si nga «Serafina», që duket se De Rada e ka pasur në dorë kur përfundonte dhe përpunonte «Rrëfimet», duke marrë prej saj edhe ndonjë hero si Bozdar Shtresin.

Por, megjithëse nuk mund të krahasohet me veprat madhore të poetit, «Rrëfimet» nuk e kanë merituar as mospërfilljen e studjuesve arbëreshë, ndër ta edhe të Gualtierit, as trajtimin e zymtë që i ka bërë kësaj vepre Markiano, duke i quajtur katër këngët novela «katër arkivole», i nisur prej fundit tragjik të heroinave të tyre. Në të vërtetë ky nënvleftësim i veprës, që është reflektuar edhe në studimet tona të derisotme, duket se ka pasur të bëjë jo aq me «rezervat» e studjuesve e të kritikëve për vlerat artistike të saj, po, siç vëren me të drejtë Andrea Varfi, (në revistën «Nëntori», nr. 12, 1974), me qëndrimin kritik të poetit ndaj Italisë, gjë që binte haptas në kundërshtim me ato tendenca ekspansioniste që kërkonin të fshiheshin prapa reklamimeve të «lidhjeve tradicionale» dhe të «bashkësisë së fateve» të të dy vendeve, që gjoja kishin ekzistuar e

vazhdonin të ishin aktive edhe në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Njëpërmjet materialit historik të përdorur në vepër, De Rada i ka hedhur poshtë këto pretendime dhe u është drejtuar bashkatdhetarëve me thirrje që të mbështeten në popullin shqiptar dhe jo në «ndihmën» e të huajve, as në pajtimin me pushtuesit. Ky argument na duket bindës, aq më tepër kur vëmë re se studjuesve të poetit nuk u kanë shpëtuat as hollësitë më të vogla të krijimtarisë së tij.

Vlerat ideoartistike të veprës dalin shumë jashtë kufijve të subjektit e të personazheve. Ato përmbahen në frymën e përgjithshme humanitare, demokratike dhe patriotike që përshkon novelat, në konstatiomet e holla të ndjenjave e të luftës shpirtërore, në frymën kritike ndaj çdo gjëje që cënon ose përdhos dinjitetin e njeriut, në përpjekjet për të përtëritur realitetin e dikurshëm historik dhe për ta përdorur këtë si shembull për bashkëkohësit. Vlera të tilla të bien në sy sapo njihesh me këtë vepër, të shkruar në frymën e traditave të bukura të rapsodive popullore, tradita që De Rada i përpunoi me shije dhe i ngriti në një lartësi të re si poet novator që ishte.

Shqipëria, për De Radën, pas vdekjes së Skënderbeut, «*lisit që kur ra na shembi*», ndodhej në udhëkryqet e shumta të historisë dhe shqiptarëve, që të mos humbisnin, u duhej të gjenin rrugën e vërtetë të shpëtimit, që mund të ishte, sipas De Radës, ve-

tëm lufta e vendosur për bashkim e çlirim kombëtar, duke u mbështetur në forcat e veta, ose, siç thoshte ai te *Serafina: ndihma jonë është vetja jonë*. Kjo ide, përmjet shembullave frymëzuese të Bozdarit, të Vlladanit e të Vidës ose përmjet mohimit të zgjidhjeve të tjera përshkon tejmbanë «Rrëfimet» dhe u jep atyre tiparet kryesore ideoartistike.

A duhet të biem shpirtërisht dhe të heqim dorë nga lufta pas disfatës, duke kërkuar strehë ndër të huaj, që asnjë ndihmë s'na kanë dhënë, apo duhet të qëndrojmë shkëmb dhe të përtërijmë epokën e lavdishme të betejave fitimtare, qoftë edhe të vetëm, po të bashkuar? Kjo pyetje është vënë në të gjithë nëntekstin e novelës së parë, që merret kryesisht me fatin e Mirana Arianitit, ose Anamaries, siç e ka quajtur poeti. Bosdar Shtresi dhe Vlladan Zënëbisha, që vijin nga Arta e nga Delvina për të shpëtuar Kotorin prej dyndjeve otomane, i përgjigjen pozitivisht kësaj pyetjeje, siç i përgjigjet po kështu edhe *Trimi*, që dashuron Miranën, vetë poeti me pohimet e shumta që bën nëpërmjet personazheve. Qartë është shprehur kjo ide në fjalët që u thotë Bosdari bashkëluftëtarëve pas fitores mbi armiqtë:

*Sot ne duhet që të kthisim  
një qytet me shkëmbenj shkrepash,  
dhe përçarë në trepe gjaku,  
për t'u çlodhë. E Italia,*

*e begatë e smirëzezë  
ndaj lavdisë arbëreshe,  
— t'i shikojë e të pëlçasë,  
zemërgurja e pabesë!*

Ky është qëndrim kreshnikësh, që s'ka asgjë të përbashkët me mentalitetin dhe me prirjet e «fisnikërisë», që e ngrysnin jetën «froneve të plogëta» dhe të ngushtuar prej interesave të tyre kastore dhe egoiste braktisin fushën e betejave dhe i kthenin krahët Atdheut. Poeti, nga pozitrat e një patrioti demokrat e stigmatizon këtë qëndrim dhe ngre lart figurën dhe brengën e *Trimit*, i cili duke iu drejtuar Miranës i thotë me mllef dhimbjeje e përbuzjeje:

*Zonjë, kush të pati faj,  
veç prindët, që s'u pëlqeu  
Kombi i tyre...  
se për ta:  
... Kombi yt,  
ne të gjithë, kemi vdekur.*

Larg Atdheut, ku shkoi jo vetëm e shtyrë nga prindrit që nuk u pëlqente kombi i tyre, po e gënjyer edhe nga shpresa e një dashurie të pastër e romantike, edhe vetë Mirana — viktimë e prindërve, e gënjimeve dhe e lapërdhisë së rretheve fisnike italiane, — ngrihet mbi të gjitha këto dhe çel në zemrën



e saj ndjenjat e atdhedashurisë, mendimet për vendin ku *derdhet gjak për vatra e besë*». Ajo e ndien veten të vogël para turpërimit që i bënë «nderit arbëresh» dhe, pa gjetur udhëdalje, vdes me bindjen se edhe turpin që i bënë asaj të huajt nuk do ta harrojnë kurrë arbëreshët. Me vdekjen e Miranës vdes një iluzion, mohohet prej poetit një shpresë e kotë se mund të gjendet mbështetje tek Italia dhe mund të krijohen lidhje të çiltra miqësore me të. Ky përfundim është plotësisht i drejtë, jo vetëm për kohën kur zhvillohen ngjarjet e poemës, po edhe për kohën kur e shkroi atë De Rada, i cili, siç dihet, i kuptoi mirë qëllimet ekspansioniste të reaksionit italian kundrejt Shqipërisë dhe nuk u pajtua kurrë me to, siç bëri, fjala vjen, Zef Skiroi e ndonjë tjetër me vazhden e tij.

Në mënyrë afirmuese ndjenjat dhe mendimet patriotike kanë zenë vend jo vetëm në aksionin e fillimit të novelës së parë, po edhe në krijimin e heroizmit e të atdhedashurisë së Vlladan Zënëbishës, figura e të cilit i jep tingullin kryesor novelës së dytë. Delvina, si gjithë Shqipëria, më në fund është pushtuar prej turqve, po kujtimi i trimave dhe shpresa e përtëritjes së epopesë luftarake rrojnë në zemrat e njerëzve, i ngrohin dhe i mbajnë gjallë ata, ashtu siç mbajnë gjallë *Dilinën* (Dilën) — të shoqen e Vlladanit. Dhe kujtimi i trimave nuk vdes bashkë me njerëzit. Ai kalon brez pas brezi (nga Dilina tek e

bija — Dina) dhe kështu flaka e atdhedashurisë nuk shuhet kurrë. Vdes në fund të novelës së dytë Dina (dhe kjo vdekje vërtet mund të quhet fare e papërligjur dhe pa kuptim, siç është edhe e papritur), po nuk është ky fund që do të vlente të merrej parasysh si element kryesor në vlerësimin ideoartistik të novelës e të heroinës, se «shpirti» i saj patriotik mbetet, gjithashtu, i pavdekshëm. Prandaj, ndërsa para fundit të saj të papritur mbetemi si të çuditur, ne na ushtojnë edhe më pas bindjet e saj se:

*Ndër shqota, o bija ime,  
ne, pallazgët, nisëm jetën,  
ne që ende lavdinë e lashtë,  
që të huajt gjithë e humbën,  
gjallë e kemi e s'do ta humbim!...*

— edhe pse:

*... Ca nga ne, sot zemërplasur,  
ikën nga qytetet tona  
dhe në brigje të Italisë,  
në mëshirë të fat qenit,  
copë e çikë ata na mbetën.  
Se ky truall plot të mira,  
që ishte i tyre, u bë i huaj,  
dhe mbi dhe s'kanë atdhe!...*

E madhërishme, përmjet atyre pak kujtimeve që sillen në poemë ngrihet figura e Vlladanit, që na kuj-

ton shumë trima që luftuan deri në shtegun e në gurin e fundit dhe nuk u dhanë, nuk u përulën dhe nuk u nënshtruan, po e lidhën jetën e tyre me fatin e vendit. Përshëndetja e këtij kreshniku është kulmi *ideoemocional* i novelës dhe një ndër momentet më të bukura të të gjithë veprës, prandaj meriton të citohet e gjitha. Sipas Vlladanit, Atdheun:

*S'është turp në e lë të lumtur,  
se hije e forcës së Atdheut  
kudo shkon ti nuk të ndahet.  
Por ju sot mos u çuditni,  
që më shihni se po kthehem  
në qytetin tim gjermadhë,  
se asnjë prej jush s'i lë  
këto brigje të Arbrit tonë  
për ar, lavde ndër të huaj.  
Unë, delvinjot i lindur,  
nuk i ndahem shortit tonë,  
me gjak shokësh më të mirë  
të vaditur pa kursyer,  
kurrë, edhe po të më japin  
si dhuratë gjithë botën!*

Në këto mendime të ndritura, nuk vjen erë «*kadavrash*», siç do të thoshte Markiano, po tingëllon fuqishëm ndjenja e atyre lidhjeve të thella e të forta ndërmjet njerëzve dhe vendit të tyre të lindjes dhe

ushton, përmyet një shembulli të bukur, thirrja e poetit drejtuar bashkëkohësve, që të mos e braktisin vendin në fatkeqësi, po t'i bëhen krahë e mburojë me jetën e me gjakun e tyre. Dhe shembulli i madh i së kaluarës ruan vlerat edhe për kohët pasardhëse e, në qoftë se nga ky shembull frymëzohet poezia, edhe ajo i kalon caqet e kohëve.

Edhe në novelën e katërt, vdekja e heroinës — Vidës (Videlajdës) është në të vërtetë vdekje e një tjetër iluzioni politik. Midis pushtuesve dhe të pushtuarve, do të na thotë De Rada, nuk mund të ketë pajtim, mbasi ose do të pranosh të jetosh si skllav dhe të vësh në shërbim të të huajit gjithçka, ose do të zgjedhësh rrugën e mundimshme, po të ndershme e të lavdishme të luftës për liri e për dinjitet kombëtar e personal. Është edhe ky një mësim i nxjerrë nga historia, që tingëllonte aktual edhe në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur u botua vepra «Rrëfime». Si në novelën e parë edhe në këtë novelë mësimi është nxjerrë prej pësimit, mbasi, siç ndodh zakonisht, pas gënjimeve vijnë zhgënjimet, të shoqëruara shpesh me ngjarje të dhimbshme e tragjike.

Vida pranon t'i jepet si nuse sulltan Selimit me shpresën se do ta zbutë zemrën e tij dhe do të ndikojë për t'i lehtësuar fatin të atit dhe Arbërit. Kështu mendon i ati i saj, i mundur dhe i rrenuar, kështu mendon edhe vetë Vida. Po nuk mendon kështu

Shqipëria e shqiptarët, ndër ta edhe kapedani trim — Gramosi, të cilit më në fund i çelen sytë e ndër-  
gjegjes kombëtare e të dinjitetit personal. Iluzioni i  
Vidës ndesh në logjikën prej pushtuesi të sulltanit  
që sulet me egërsi të shuajë kryengritjen shqiptare,  
kurse egërsia e tij thyhet prej trimërisë së kryengri-  
tësve, që e detyrojnë të kthehet i mundur. Vidën De  
Rada, në frymën e baladave popullore, e kthen në  
zog, jo për të ushqyer gënjinin e saj, po për ta he-  
dhur poshtë atë gënjim, duke dëshmuar se nuk du-  
hen kërkuar ndjenja fisnike as në jetën intime prej  
dhunuesve të lirisë, në pallatin e të cilëve, pas Vidës,  
zëri i një zonje tjetër dëgjohet, sikur të mos kishte  
ngjarë asgjë.

Interesante për brendinë e vet është sidomos no-  
vela e tretë, që ka si figurë qendrore *Dinën* (Adinën),  
të bijën e Vlladanit. Vajza e re, e prirë nga ndjenja  
patriotike dhe nga krenaria për të atin e saj fatos,  
nuk pranon të martohet me të birin e pashait turk as  
kur i bëjnë lajka e i japin premtime, as kur e kano-  
sin dhe e ndëshkojnë të mbyllet në manastir. Ka ndo-  
dhur shpesh në raste të ngjashme edhe në krijime le-  
trare të shekullit të kaluar, të cilat mbahen për krye-  
vepra, që heronj të rënë shpirtërisht kërkojnë «paqe»  
e «qetësi» në «fjalën e zotit», në «të vërtetat hyjno-  
re» dhe në moralin kristian. De Rada nuk ndjek  
këtë rrugë. Në veprën e tij, jo vetëm shpirti afetar  
i Dinës, që «më pak ishte e zotit» dhe «zotin e ha-

rron» në miqësi me Nushën, po edhe krenaria kombëtare dhe ndërgjegjja e kombësisë ngrihet mbi ndjesitë fetare dhe është plotësisht zotëruese. Manastiri për Dinën është robëri dhe vdekje, që bëhet edhe më i padurueshëm për shkak të përdhosjes morale që sundon atje. Dina vdes, jo si e krishtere «e mirë», po si arbëreshe, me brengë në zemër, duke lënë pas në trashëgim brezash mendimin se:

— ... është zonjë edhe e mirë  
kush gëzon nder qëkur lind.  
Kujt s'gëzon nder, s'mund t'ia japë  
askush këtë dhe n'i faltë  
krejt qytetet edhe pronjat.  
Dhe pse mëma më la befas  
e nuk mundi të ma thoshte,  
unë e di ç'hije ka nderi:  
gjithë e dinë se im atë,  
që më vdiq për vendin tonë,  
nuk më la që të shkoj nuse  
tek një shtypës i Delvinës! —

Ndoqëm kështu, në vijat më të përgjithshme fillin patriotik të «Rrëfimeve», po ky nuk është i vetmi vlerësim që mund t'i bëhet brendisë ideoemocionale të veprës, e cila ka edhe vlera më të përgjithshme humanitare, demokratike dhe etike që janë karakteristike për të gjitha veprat e De Radës e që është e pa-

mundur t'i përfshish në pak faqe e aq më tepër t'i japësh me atë forcë e freski që i ka hedhur poeti në vargjet e krijimeve të tij aq të pangjajshme me ato të poetëve të tjerë të kohës.

Edhe në «Rrëfimet» arenë kryesore në të cilën zhvillohen dramet e një kombi e të shpirtit të heroinave e të personazheve, është zakonisht natyra e hapur, vlerat estetike të së cilës De Rada i ka njohur deri në imtësi dhe i ka pasqyruar me një ndjenjë të hollë prej artisti të rrallë. Bota, toka është kushti i parë objektiv i qenies njerëzore, materialitetin e saj ai e sheh jo vetëm si një «send në vetvete», po edhe në raportet shpirtërore që krijohen ndërmjet natyrës dhe njerëzve, për të cilët ajo mbetet kurdoherë burim i pashtershëm frymëzimesh nga më të bukurat, mbasi:

*... dhe puhitë e valëve,  
freskësitë e fletëve,  
rrjedhat e lumenjve,  
me këngët e shpendëve,  
që të gjithë njerëzve  
u përtrijnë tokënë,  
që të harrojnë brengëtë...*

De Rada është, gjithashtu, poet i ndjenjave të pastra dhe fisnike, siç mund të jetë vetëm një poet, i cili ka adhurim për njerëzit dhe kërkon e çmon

në jetë gjithçka që i bën ata më të lumtur e më të gëzuar e, doemos, nga ana tjetër përbuz e stigmatizon, sipas të njëjtave koncepte, gjithçka që e vret njeriun ose që përdhos natyrën e tij, qoftë kjo një e keqe shoqërore, ose një dobësi karakteri a cen moral.

Të prek në këtë vështrim miqësia e Dinës me Nushën, që i kanë mbyllur në manastir me përdhunë, mbasi kjo miqësi ngrihet e madhërishme në pastërtinë dhe thjeshtësinë e saj mbi arbitraritetin e dhunuesve, mbi asketizmin e murgeshave, mbi intriga e thashetheme dhe, më në fund, edhe mbi vetë idenë e zotit, mbasi ato e shihnin se *kot u shkonin lutjet, tretur në erë, ku asgjë nuk njohën*. Dhe De Rada, që shumë rrallë i ka shkëputur mendimet e veta prej mendimit të heronjve e të personazheve, në këtë rast e ka quajtur me vend të deklarojë në mënyrë patetike:

*miqësi, flakë e pashuar,  
ashtu si dhe drita e ditës,  
ti m'i jep hir vetë jetës  
dhe nga guri më nxjerr ujë! ...*

Në plan të përgjithshëm shoqëror dhe etik janë me interes edhe ballafaqimet ndërmjet disa personazheve të veprës e, sidomos, ndërmjet Miranës e Mbretëreshës në novelën e parë dhe Vidës e Julias në novelën e katërt.



Mirana, e gënjyer por e ndershme, me brengën e largimit prej vendlindjes, po edhe me shpresën se do të gjente ngushëllim në dashurinë e Vanierit, bie menjëherë në ambientin e korruptuar të aristokracisë italiane (De Rada e njohu këtë edhe vetë) dhe vihet përballë dëfrimeve të shfrenuara të Mbretëreshës, e cila, jo vetëm për të, po edhe për të afërmen e saj, Garentinën, nuk pyet kur i hypën në kokë që të plotësojë teket e saj epshore. Si përfaqësuese e një shtrese shoqërore në degjenerim, gjithë kuptimin e jetës ajo e përfshin në kërkesën «të gëzojmë ditën», prandaj ajo predikon se jeta:

*është e shkurtër dhe e brishtë.  
Dhe kjo brishtësi të gjithëve  
na nxit që t'ia hapim shtegun  
kohës, që në dorë e kemi...*

De Rada, përmjet Mbretëreshës, denoncon me përbuzje moralin e aristokracisë së shturur dhe një denoncim i tillë nuk mund ta ketë bazën vetëm në sentimentet patriotike për t'ia bërë krahë heroinës e aq më pak nuk ka të bëjë me ndonjë koncept të prapambetur e me ndonjë anësi patriarkale. Përkundrazi, qëndrimi i poetit është thellësisht shoqëror dhe ka të bëjë me konceptin mbi dinjitetin e njeriut, që jo vetëm preket kur cënohet prej të tjerëve (rasti i Mi-


ranës), po edhe përdhohet prej sjelljeve e veprimeve të njerëzve të lapërdhosur. (Rasti i Vanierit e i Mbre-tëreshës).

Që ky ballafaqim nuk ka të bëjë me ndonjë koncept të prapambetur e patriarkal na shtyn të mendojmë edhe ballafaqimi i Vidës me Julian, të cilën as poeti nuk e ka gjykuar dhe as në nuk mund ta gjykojmë sipas fjalëve që thotë për të Gramosi, kur e fyen duke i thënë:

*Ty të shkojnë krejt për shtat  
ar sulltani e ashk haremi,  
ku t'harabohesh pa kujdesje...*

De Rada nuk mban këtë anë. Vetë fundi i Julias, që më mirë pranon të mbytet se sa të hyjë në haremin e Sulltanit, dëshmon se poeti edhe në çështjet etike ka ditur të niojë e të çmojë lirinë dhe dinjitetin e njeriut. Julia, e rritur në liri, shoqe e këngëve të përmallshme dhe e kitarës, që ndihet zonjë e vetvetes dhe njeh të drejtën jo që të bëhet kukull në dorën e një burri, po që të gjejë e të zgjedhë vetë shokun e jetës, megjithëse si shumë e re është e mendjes se «për puthje lindin gratë», prapë është e bindur se:

*në hareme, mbyllur brenda,  
mes inxhish, lulkash si akull,  
domosdo dhe zemrat fyshken!...*



Ose të kujtojmë bisedën me Vidën:

*Vida: Besoj, gazi për rininë  
ka më hije!...*

*Julia: Jo gjithmonë,  
se dhe gazi lind nga jeta.*

Janë këto arsytet që të bëjnë të besosh plotësisht në dashurinë e saj për Gramosin dhe në premtimet e çiltra që i bën atij. Vdekja e saj është fitore e lirisë, e dashurisë dhe e dinjitetit të njeriut, që s'pranon të rrojë si skllave, aq më tepër, nuk pranon të bjerë aq poshtë sa të bëhet vetëm *një mjet* për të kënaqur epshet e një tjetri.

Ndjenja e lirisë është për De Radën ndër kushtet kryesore të dinjitetit të njeriut, ashtu siç ka qenë edhe për të gjithë poetët tanë të Rilindjes. Është e vërtetë se «liria» është kuptuar prej tyre në mënyrë deridiku të papërcaktuar, po, sidoqoftë, e marrë brenda kushteve të atëhershme shoqërore dhe kufizimeve botëkuptimore të tyre, proklamimi i saj, jo vetëm në terren patriotik, po edhe në atë shoqëror, mbetet një meritë e madhe, që e ruan rëndësinë edhe në ditët tona. Prandaj na duket se shprehin mendimin e vetë De Radës, fjalët e Gramosit:

*Bashkë i gjen kudo në botë  
ngazëllimin dhe lirinë,*

*hapësirën që fal dita  
bukuria dëshiron.*

Dhe, po të vazhdojmë, mund të përmendim edhe shumë mendime të tjera me vlerë, që janë ngjeshur në vargjet e të katër rrëfimeve, kurse po të ndaleshim në çdo hollësi e në çdo konstatim poetik, atëherë do të na duhej të zgjateshim edhe më tepër. Po edhe kaq mjafton për të provuar se ka qenë pa baza, qoftë nënvleftësimi i kësaj vepre, qoftë edhe gjykimi arbitrar i saj si një vepër «makabre». Subjekti i një vepre, dhe aq më tepër fundi i heronjve të saj nuk janë gjithçka. Ato nuk mund të merren të shkëputura prej qëllimeve që udhëheqin dhe prej ideve që përshkojnë veprën e një gjë të tillë nuk e kanë pasur parasysh as Markiano, as Gualtieri e, aq më pak, G. Petrota, që ka ndjekur ata.

Është thënë, gjithashtu, se vetë De Radá nuk e ka vlerësuar aq këtë vepër, gjersa nuk e ka përpunuar dhe nuk e ka ribotuar asnjëherë siç e ka pasur zakon të bëjë me veprat e tjera. Po, pa dashur ta mbivlerësojmë, nuk mund të mos shënojmë se Gualtieri ka vrojtur që ky mendim është i pasaktë, mbasi ai provon që vepra është nisur në vitin 1837 dhe është plotësuar e, domosdo, edhe rishikuar në vitet 1845-1846, pra, nuk ka mbetur jashtë kujdesit përpunues të poetit. Nga ana tjetër, nuk është pa baza po të mendohet se pritja e ftohtë që iu bë kësaj vepre

për shkaqet që përmendëm në fillim, mund të ketë ndikuar që kjo të mos ribotohej krahas veprave të tjera.

Sidoqoftë, me gjithë vlerat që u përpoqëm të renditim si dhe meritat e tjera, që i gjejmë në të gjitha veprat e De Radës, nga disa pikëpamje vepra «Rrëfimet» ruan edhe karakteristikat e një pune të një poeti që duket se do të lartësohet më tepër në veprat e mëvonshme të tij.

Në aspektin historik vepra paraqet përpjekjet e para të poetit, për t'i hyrë historisë së Shqipërisë dhe për ta bërë atë objekt të krijimtarisë poetike. Në të vërtetë elementi historik këtu, është fare i paktë, dhe duket më tepër si *pretekst* e, ndonjëherë, edhe si *element* për t'i vendosur ngjarjet në rrethana që t'i kujtojnë lexuesit Shqipërinë e shekullit XV dhe jo t'i japin atij një përfytyrim të plotë të këtyre rrethanave. Dhe, megjithëkëto, vepra ka një tingull të fuqishëm patriotik dhe kjo rrjedh kryesisht për shkak të sundimit të ndjenjave mbi materialin real, të lirikës mbi tregimin epik. Por jemi të bindur se edhe këto mungesa nuk ia errësojnë vlerat ideoartistike kësaj vepre kaq të afërt e të dashur edhe për kohën tonë.

RAZI BRAHIMI

## KËNGA E PARË

MIRANA ARIANITI

*Kotor, det, Napoli, verë 1468*

Mbi Kotor, në çuka kodrash,<sup>1)</sup>  
pranë qytetarëve  
të plagosur ndënë tända,  
(që si qetësi pa jetë,  
po i ndienin tokë e qiell,  
sa më shumë shpirti u qetej  
brenda kurmesh të pagjak),  
ishin mbledhur kotoreshat,  
edhe mesin kishin zënë  
me bucela e grihë shpatash.<sup>2)</sup>  
Poshtë, deti i zbardhëlluar  
prej anijesh venedike,<sup>3)</sup>  
bregun lagte e turqëria,  
shtrirë në shatorre qetej

në mes tymit nargjileve,  
pranë kuajsh që kullotnin  
(rreth tufash kafshësh, grabitur),  
togje-togje të shpërndarë.

Sa ra dielli prapa reve,  
nis një shqotë e na përplas,  
që nga Kotori i zhuritur,  
pluhurin si tym të dendur,  
përzier me rërë e rrecka,  
lart e ngre dhe hiri i hollë  
mbulon sheshet. Atëherë  
doli hëna e drita e vagët  
ca dhi të shkreta i fshehu  
përtej gërxhesh pa vathishte  
dhe pa qentë lehmëlargët.  
Dhe këndeje u duk qyteti  
në hi kthyer shesheve,  
dhe kuajt pa zot u çetnin,  
zjarret flaknin dhe pa shkrepur.  
Po atëherë erdh ndihma e Artës  
bregut dhe flamurit kuq  
shfrynte shqotës shqipja e zezë.  
Pranë trima e bij bujarësh,  
t'ardhur prej vendesh të largme,  
ndënë qiell preheshin.  
Dhe Bozdari përmbi kalë  
mes aradhesh ngjitej lart,  
plot nderime e ankthe i pritur,

që t'u thoshte e t'u premtonte  
se proitin e Kotorit<sup>4)</sup>  
s'do t'ua zhvatnin arbëreshvet.

Kur arriti ai te lisat,  
që si në rresht fëshfërinin,  
u shtëmëng pa folë e qaset  
te një tendë e kap pas krahu  
prijë Vlladanin e Delvinës,  
që i plagosur rrinte shtrirë  
me sy kredhur në mejtime  
si suvalë e detit gjerë.  
Ky e sheh, siç shihet rrezja  
e pranverës plot shëndet  
edhe u vesh. e dolën bashkë.  
Gjithë vashat e qytetit  
i vërejnë të dy bashkë  
edhe nuk u ngopej zemra  
së sodituri Bozdarin,  
që e lavdonin këngë e valle.<sup>5)</sup>

Sapo i sheh kundrejt u ngrit  
mes shërbestaresh Dilina  
dhe m'i thirri zonjës mëmë,  
që me pleqtë ish në kuvend  
lart në sallën e pallatit.  
Si në ças kur dashuria  
tret çdo dhembje e çdo ngurrim,  
vasha shtang sa e vren afër  
gati në frymë e fytyrë,



edhe bindet se Vlladani<sup>6)</sup>  
nga rreziku kish shpëtuar.  
Dhe Dilina aq e gëzuar  
saqë askurrë asnjë kurorë  
mbretërore s'gëzon vashë,  
në ças shkëputet nga vendi  
dhe në pallat fluturoi,  
atje ku ndodhej e ëma.

Brenda, krejt në zi e veshur,  
dukesha priti Bozdarin:  
*Dukesha:* — Bozdar, mirë se vjen ndër ne!  
Kur erdh nusja e Dukëgjinit<sup>7)</sup>  
në pallat të ungjit të saj  
të më shih Miranën time,  
q'aq shumë na ngjasonin,  
edhe Fina e shkretë thoshte  
«Ç'fatos të bukur të kishte  
Arta e saj». Sa dëshironin  
djemtë e mi që të të njihnin.  
Për këtë ata iu lutën  
edhe t'yt ungji, Skënderit,  
kur si dhëndër na pat ardhur.  
Ja, sot erdhe, por ata më s'rrojnë  
dhe qyteti, që i nderonte  
sapo i shihte, ra i djegur  
nga gjaksorët që m'i vranë  
aq të rinj. Tani dhe odat  
ku më endeshin fëmijët,

s'janë më e sot një shtrat  
këtu s'kemi as për t'u dergjur.  
Bozdari: — Jetën ne ia falim ditës  
dhe vjen mbrëmja e ajo tretet  
sikur fare të mos ishte.  
Por në nder jeta qëndron:  
sapo i prek ballin çnderimi  
një zonje, nxihet shtëpia;  
kurse gruan e përdalë  
sapo rrugës e shikojnë,  
gjithnjë më shumë e pështyrin.  
Edhe djemtë e tu, moj zonjë,  
jetën drejt ia truan ditës,  
por me nder ata kujtohen,  
se për nder t'atdheut ranë  
dhe për ta këngë këndohen.  
Kështu tha edhe kërkoi  
këngë e valle të buçisnin,  
si në kohët aq të lume,  
me besim se përsëri  
Arbri do të ngrinte kryet.

Një plak nis i bi gërnetës,  
burra, gra kujtojnë e qajnë  
dhe kundrejt ylli ndriçonte  
për Bozdar Shtresin e Artës  
si në kohë foshnjërie.  
Andaj shpejt fatosit mendja

i shkoi te një ngjarje e largët,  
kur dil një mbrëmje të zbetë,  
i zbetë nga dashuria,  
nëpër tokat e të atit  
dhe mejtimet ia ndërpriste  
klithma vaj e kukuvajkës...  
Por q'ahere shkuan kohë  
dhe fatosin, ylli i Arbrit,  
gjallë e mban e përgjithmonë.

Dhe kështu kaluan orët  
gjersa tamburi ndën flamuj,  
tej në aradhet luftëtare  
u kujton të gjithve gjumin,  
pa harruar verinë akull  
që po lajmonte mëngjesin.

## II

Sapo zjarret më të shuar  
nisën prap' të nxjerrin flakë  
nga veriu i mëngjesit,  
dhe nga toka shquhet ujët<sup>1</sup>)  
shpejt Bozdari brof më këmbë,  
se nuk mundte të përmbahej  
larg lavdisë së asaj dite,  
Me të gjithë ulet për sillë

dhe kur yjet lanë qiellit  
vetëm pak re si pambuk,  
trimi shokët i rreshtoi.  
Poshtë daullet e turqve  
kishin zënë e zgjonin dheun,  
edhe me ëndje të ndryshme  
shiltet e buta i linin.  
Lart zantri, tamburë arbër<sup>2)</sup>  
bubulluan me kanosje.  
Në gjithë ato shungullima  
tokë e qiell një u duknin  
ngado që të hidhje sytë!

Dhe me flamuj që drithtonin  
shoku-shokut duke i folë,  
këmbëshpejtë ushtëtarët  
si ortekët u afronin:  
ndënë ta gjëmonte dheu!

Po vetëm pas sulmit të parë,  
sapo u zbrapsën të dy palët  
sullm të bënin për së dyti,  
vendi zbrazet edhe shihet  
gjithë i mbytur gjak e kërmë,  
(se gjat përleshjes s'u duknin  
veç shkëndija shkrepëtimash).  
Dhe ky vend plot gjak e kërmë  
me tërbim i ndizte trimat.  
Prej çukës së kodrës gratë  
fytyrëprera, pa frymë,

sytë i mbanin të karfosur  
te shqiponja në mes prijsash,  
q'urdhra u jepnin qytetarve.  
Dhe mes palësh flamujsh, shqipj;  
me sy shkëndijime drite,  
printe drejt hordhive armike.  
Pas pak, poshtë, si një mjegull  
që mbulon në mëngjes detin  
dhe ndër dallgët të mbyt sytë,  
mbushën që nga fundi i largët  
gjithë vendin nga lind dielli  
turma turqish shpatandritur.  
Kua jvet mbi zhur të djegur  
shkuma u binte copa-copa.  
Sa i pa, u sul drejt mesit  
Bozdari me djem të freskët:  
përballoi sulmin fërtymë,  
si të lumit cërshimegër,  
dhe pas tij ushtria s'tundet.  
Kush i shkiste shpatës tija,  
n'erë e prisnin gurë e shtiza  
nga shigjetarët të Ohrit.  
Kua jt, pa njeri në shalët,  
në gjak mbytur bark e thundra,  
me hingllima bënin prapa.  
Dhe kalorësit të tronditur,  
përherë e më të shkokluar,  
të drobitur mbanin frerat.

Por mbi ta si një dragua  
që ta ka vdekjen në sy  
dhe krejt sheshin ndënë këmbë,  
si një jugë mbi zjarr kallmesh  
që pështjell çdo gjë në flakë  
gjer lart në synor të qiellit,  
ishte dufi i Bozdarit,  
që mbuloi me kërma gropat,  
gjersa turqit u larguan  
apo vdekja u hodhi sipër  
velin korb që mbyll çdo shteg.<sup>3)</sup>

U ndal dhe zemra e pushtetme  
i dha një mejtim të bukur.  
Edhe shokëve sapo i erdhën  
me kurorë, ai trim u thotë:  
*Bozdari:* — Sot ne duhet që të kthisim  
një qytet me shkëmbinj shkrepash,  
dhe përçark me trepe gjaku,  
për t'u çlodhë. E Italia,  
e begatë e smirëzezë  
ndaj lavdisë arbëreshe,  
ta shikojë e të pëlçasë,  
zemërgurja e pabesë.<sup>4)</sup>  
Dhe mbi kuaj hypin, sulen  
mbi armiqtë anëzbuluar.  
Dielli vetë lart në qiell  
u ndal, them, që t'i vërente.  
Asgjë, as pjergull, as dushk,

përsipër nuk ndente hije.  
Frotat turke, të përfshira  
si në një valle pa fund,  
shkumëzonin e gulçonin.

Kur ndin zhurmën e patkonjve  
përmbi kokë hundë-përtokë,  
Bozdari përmban pak kalin,  
një vigan sterrë të zi:  
(zbrazet vendi, rrjedh gjak prrua!  
Dhe rreth male me të vrarë!)  
Trimi i Artës i kalon,  
përsëri ai sulmon  
dhe një llavë turqërie  
mbi shatoret derdhet, shembet.  
zhurmërimshëm bie, përmbysset.  
Kush iu tremb anës së detit,  
ua mbath këmbve nga veriu,  
rrëzë kodrës, që lart kishte  
grumbull gratë, pa një mbrojtje.

Veç Vlladani me djelmosha  
dhe një trumbë të plagosur,  
bënë poshtë për nga tëndat;  
ndënë këmbë u çanin shkuret,  
gurë u shkullnin që nga vendet.

Dhe ndritën drita të reja!  
Aher prej kodrës Dilina  
u zbeh, se vu re anijet  
ku na kish motrën Mirana,

nuse te Vanieri i huaj,  
dhe me shërbestaret ndezi  
flakadan të përshëndeste.  
Sytë n'atë det i treti  
dhe iu duk sikur po shihte  
ujit kaltër shkrepëtimat  
e ushtrisë, ngjeshur zallit.

Andej nga mesdita dielli  
i kish mbledhur gjithë hijet.  
Dhe n'anijet venedike  
na u dukën ca si diej,  
i pushtoi dhe velat tymi,  
një gjënim u mbyt pas reve  
t'anës s'andejme të qiellit!<sup>5)</sup>  
Edhe pse si bari u korrnin,  
hordhitë otomane rendnin  
pështjellimthi nga Veriu,  
në re pluhuri trumba-trumba  
si të ndjekur nga skëterra.  
Edhe sa t'iu qasnin, deti  
dallgëshkumë i përpinte  
dhe në çast u zbardhte flokët.  
Për ta mbetëj një shteg vetëm:  
të na binin ne në besë!

Dhe me besë u tokën duart.

U qet zhurma e mbet ushtima.

Dhe Bozdari i zbriti kalit



mбанë ujit, në një hije,  
që të çetej, të freskohej.  
Pastaj nd'ujët futi shpatën,  
që kullonte gjak të ngrohtë.  
Dhe tek vren ujët që rridhte  
ai shesh fushë beteje,  
(tash i qetë e me pak robër  
ndënë kujdes të ohrianve),  
ndër mend, dehur prej gëzimit,  
sot po m'i duket Bozdarit  
sikur kurrë s'kish të sosur,  
i pastruar nga të ligjtë  
dhe si qielli krejt i pastër,  
krejt i qetë e që zhuzhinte  
nga grumbuj e grumbuj mizash  
q'ende gjak nga toka thithnin.

Por atë qetsi e prishin  
prej anijesh venedike,  
tani ca topa, q'u zgjuan  
edhe nisën të gjëmonin,  
mbase për t'u futur dridhmën  
poshtë, thellësive detit,  
gjthë qenieve pa mbrojtje!<sup>6)</sup>...

Pastaj mbrëmjes arbëreshët  
bashkë edhe me venedikas,  
si një vllazëri e madhe,  
shtruan darkë të begatë.  
Nuset q'ishin mbanë detit,

por me zemra te dhëndurët,  
erdhë, u ulën më tryeza  
n'ish-shatorren e pashait.  
Edhe bujarja Miranë,  
që kish katër muaj nuse  
te Vanieri venedikas,  
me gëzim erdh në mes tyre.  
Kjo Mirana e Arianitit,  
dhe pse jeton tek anija  
e Vanierit venedikas,  
ende s'e pa Venedikun.  
Në të folë asgjë s'ka ndrruar,  
andaj kushdo mund të thotë  
se «s'ka dalë nga Kotori»,  
por gërshehta lidhsabardhë  
kjo Miranë më nuk është,  
edhe andaj një helm i fshehtë  
i qëndron pa fund në sy,  
ku përpara shkrepse agimi.7)

### III

Nata ra e atje i mbajti  
dhe në shtresa pashe fjetën.  
Në mëngjes, me vesën shquan  
tej një fllakadan të madh,  
ku arbëreshët plot nderim

çdo kufomë të dëshmorve  
në mes rreshtash e kalonin  
dhe në flakë e bënin hi.)

*Dilina:* — O e pastra motra ime,  
ndaj kujt vallë ke fëjyer,  
që kaq shumë helm të hodhi  
sot në shtatin tënd plot hire?

Dhembjen për dëshmorët tanë  
njësoj ne të gjithë e ndiejmë,  
kurse ty, gjithmonë e kthjellët,  
si dy kronj lotët të derdhen

*Mirana:* — As vetë unë nuk e di,  
mbase jeta që kalova  
në qytetin tim t'hareshëm,  
që sot e shoh shkrumëzuar;  
mbase është dhe parandjenja,  
që më bën ta ndjej të keqen  
sapo gdhin çdo ditë e ngriset.

*Dilina:* — Ankthi i udhës aq të largët  
edhe mërzitjet në det  
ta paskanë helmuar mendjen,  
andaj përpiqu t'i mposhtësh.  
Venediku, thonë, është drita  
për fodullët italianë!

A të dashuron yt shoq?

*Mirana:* — Ku ta di? Zemra e burrit  
i ruan thellë të fshehtat.

*Dilina:* — Qyqja motër, lulja e nderit!

Thirri, e lotët i buçitën  
e ndaj gjirit vrushkulluan,  
e për mesi e pushtoi,  
si në qytet të pushtuar,  
pushton një e shkretë grua  
më të shenjtë gjë që s'don  
t'ia rrëmbejnë armiqtë zhvatës,  
dhe Dilinës n'ato çaste,  
ashtu na i dukej motra!

Flaka e lodhur, gjelbërore,  
hirin grumbull e mbulonte  
dhe asnjë dëshmor më s'njihej.  
Qytetarëve të prekur,  
lotët sytë ua mbuluan.  
Atëherë na u dha shenja  
të valviteshin flamurët  
që po prisnin të palosur.  
Boritë ranë për mallin<sup>2)</sup>  
e qyteteve që presin  
prap' t'u kthehen luftëtarët  
gjithë gjallë e fitimtarë!  
Me mejtime plumb Bozdari<sup>3)</sup>  
trimat prin shumë i nderuar.  
Edhe luftëtarët ikën,  
ashtu siç ikin edhe fjalët  
në një lëmë gjatë shirjesh.  
Si një veshje n'ar e ndritur,  
që sa kthehet prapthi zbehet

përnjëherësh, ashtu është  
në mes dheut, dhe njeriu  
(përcëllimë e pafjalë),  
ai ngjiz vetë ngazëllimet  
edhe vetë ato i shuan.

#### IV

Atëherë qytetarët  
në Kotor të gjithë hynë  
e mbi trarët pa dërrasa,  
për të pritur diellin ndehnin  
dhe pekanët, (kur i gjenin)<sup>1)</sup>  
dhe ndën' ta, shtronin mbi shtresat  
të sëmurë e të varruar.  
Dhe te vatrat si kallkani  
vashat përtërinin zjarrin.  
Dhe fëmijë te dritsoret  
si mazgalla, po na nxirrnin  
përballë erës ca fërrere<sup>2)</sup>. . .  
Pastaj fryu veriu dhe velat  
ndër anijet fërshëllinin,  
kërpet, rrathët trokëllinin.  
Dhe pas drekës u larguan  
edhe ata të Venedikut  
përmbi detin, udhë e sheshtë.  
Si mbi ma! një re e bardhë

që ravizon kaltërsinë,  
dhe Mirana, duke fshehur  
me shamizë sytë, ndahej  
pikëllimthi edhe nga fqinjët<sup>3)</sup>  
dhe bulqizat e shtëpisë,<sup>4)</sup>  
që i përshkonte me të vllëzër  
n'ato vera që përhera  
më e gjerë u hapej bota,  
edhe mendja u zgjerohej  
pa shqetsime ndrydhëtare!

Ajo tash s'kish më njeri,  
se bujarit italian  
as nuk ulej t'i rrëfente  
shqetësimet që e mundonin.  
Ai kot ditët i ngryste,  
pra, këshillë s'kish ku gjente  
për çdo gjë që e shqetësonte.  
Krenar vetëm që kish grua  
një bujare aq të bukur,  
e nojtëshë mbi të gjitha,<sup>5)</sup>  
që ta shihnin ende jashtë  
dhe ndër dasma e kuvende  
admirali venedikas.

Pasi tok hypën n'anije  
dhe veriu për ca orë  
e gënjeu, Vanieri zbriti,  
me ca shokë në një varkë

edhe Miranën e la vetëm.  
Që nga ballshi kjo e ndoqi<sup>b)</sup>  
me vështrim hyllnarë e varkës,  
që haresh të largme çante.

Këngë t'huaja këndonin,  
mbase këngë gaz rinie,  
(se të rinj nga zërat ngjanin)  
këngë jete lulehapur,  
që Mirana nuk i dinte  
në breg zienin aq gazmore,  
si në vreshta për të vjelat.  
Dhe një mall i madh e rroku  
për shtëpi, për atë botë  
ku ajo vërtet jetoi,  
(se përpara qe mësuar  
të pushonte zemërquetë,  
si në gjumë që ikte e vinte  
e që kurrë nuk e shtypte,  
por sa e prekte pak, e linte  
që të zgjohej e gjithmonë  
të gëzonte hare të reja).  
«Por tani çdo gjë mbaroi!»  
tha, edhe e prangos dyshimi  
për të marrë vesh n' e donte  
vërtet ai burrë i huaj,  
q'ajo po i jip vetveten  
mbase e shtyrë edhe nga mosha,  
por që kurrë më s'do mundte

tej t'i flakte ato pranga.  
 E plot helm ajo kujtoi:  
 gjallë i del fytyra e tatës  
 dhe pallati mes gjirive,  
 që e shurdhonin duke i mburrur  
 Ç'kish të mira Venediku!  
 Por ata shkuan e vanë...  
 Dhe të zbetë nuk e panë  
 në mes ujrave të detit.  
 Dhe tani kjo shkon si nuse.  
 E ç'të mira do të gjejë?  
 «Mos hijen e pasmesditës,  
 që i del para e i ngrin jetën?»  
 «Ah, moj bijë, erdh një kohë  
 që s'bën dot çfarë të duash,  
 se as veten s'ke në dorë  
 dhe kjo është shenjë e vdekjes!»  
 Sa kish thënë këto fjalë,  
 tatës jeta i drithërohej  
 si e zhytur në djersë akull  
 edhe e ndjeu veten fletë,  
 që e rrëmbente era e ftohtë...  
     Gjallë i del dhe një takim  
 që pat te palestra e horës.  
 Kjo, e vetme, kishte dalë,  
 sapo na ishte martuar  
 me krenarin italian,  
 dhe plot gjurmë kish dalluar



në palestër, ku nuk pa  
veç një bir bujari arbër,  
q'ajo e dinte se në gji  
digjej heshtaz për Miranën,  
dhe kjo sypërlotur ndalet:

*Trimi:* — O bujareja Miranë,  
përse e vetme, e pa shoqe?

*Mirana:* — Para pak pranë atij **kroit**  
prej mermeri, n'hije shkozash  
dëndësore lartullore,<sup>7)</sup>

që flladitin gjer në qiell  
ndenja dhe me vete thashë:

«Përse kur jeta krijon  
dhe shkoza kaq të shëndetshme,  
po më thonë «Dil nga jeta»?

*Trimi:* — Zonjë, kush të pati faj,  
veç prindët, që s'u pëlqeu  
kombi i tyre por na zgjodhën  
zemërlehtët italianë?

E megjithëse ky qenkej fati,  
krejt sikur të të harrojnë  
si të humbur në humnerë,  
dashuria ime e zjarhtë  
udhën ty do ta ndritë!

*Mirana:* — Tani bota është e mbushur  
plot me vasha më me fat!...

*Trimi:* — Po, sepse në, kombi yt,

e sheh vetë... —

e i bërë akull,  
i merr dorën:

— Kombi yt,  
ne të gjithë, kemi vdekur!...

Sa kujtoi këto fjalë  
u dridh, dha një klithmë varri  
dhe Mirana ra përshtrolli.<sup>8)</sup>

Kur nga argtime nate  
n'anije kthehet Vanieri,  
e gjen gati si të vdekur.  
E ngre dhe në shtrat e shtrin.  
Edhe një të qetëm vdekje<sup>9)</sup>  
e jo shtrushi i suvalve  
i dha gjumin gjithë natën.

Pastaj, sa e zgjoi dita,  
sytë i hodh egër Mirana  
tek të kaltrit përtej qelqesh  
dhe kërkoi t'i mbërthente  
tej në brigjet gjetheshumë,  
kryekëput e ndryshuar.

E i shoqi na i tha:

*Vanieri*: — Lotët shumë, moj *Miranë*,  
të dëmtuan. Që asnjë brengë  
të mos kesh ti bëj ç'të duash.  
Në Kotor akoma jemi.  
edhe era ka pushuar.  
Në daç zbrit, prehu, shërohu.

*Mirana:* — Dua të dal jashtë detit.

*Vanieri:* — Po, moj nuse, e tek të **tutë**  
mund të kthehesh, si të duash. ...

Ja, ka ardhë edhe jot motër.

Shihi dhe mirë se erdhi!

Dadë Lena, që e kishte rritur,  
u përkul dhe butë e rroku  
duke qarë:

*Lena:* — Bija ime,  
o nerënxë, që të gjitha  
përmbi tokë të zilepsnin!

Dilës n'heshtje lote i rrodhën.

*Mirana:* — Si një zogë që ndjell zi,  
po ma nxin jetën, moj motër,  
me të qarët loteçurgë.

Ne një herë u ndamë të gjalla  
që të mos shiheshim më.

Pra, dhe po të vdiste njëra,  
«është e gjallë» do thosh tjetra.

Vetëm unë i shqitem Arbrit  
dhe nuk don askush të vijë  
tok me mua, as dadë Lena.

*Lena:* — Bijë, flokët që m'u zbardhën,  
thonë «lëmshi po më mblidhet»

Përse, pra, të të kursehem?

Ku të duash ti, vij unë!

Dhe pastaj ato e lanë,  
me ballin mejtimeqetë.

## V

Shkoi një javë e në mesditë  
kreshtëroi veriu i ftohtë,  
detin bruz, dhe katartesh  
fërshëllente. E shpejt e shpejt  
detëtarët ulin velat  
dhe spirancat shpejt i ngritën.  
Dhe Mirana, e shëruar,  
kotullkuqe, po shikonte  
drejt qytetit, prej nga çante  
ndaj anijes vrik një varkë  
velabardhë, ku vërente  
dadë Lenën që po i vinte.

Sa erdh varka, anija niset.  
Dadë Lena hodh në prehër  
të Miranës tufa lulësh  
lloje-llojesh sapo-çelur  
në kopshtiet e shtëpisë  
dhe që e motra ia dërgonte  
të lara me lotë motre.  
Ikte anija dhe të dyja  
s'ia largonin sytë bregut.  
Shortet e atdheut lënë  
në mëshirë njerëzish, shtazësh,  
te plakë Lena u përzienin  
si suvalët dredha-dredha  
me mejn, et akull vdekje;

po Mirana s'vërente ujët,  
gjetkë mbytej mendja e saj.

Kur ra muzgu zemërfryrë,  
në shtrat shtresalinjta u shtri  
mos qetohej. Por një balo,  
qen madhosh, përtej n'anijen  
e përparme aq ngjirur lihte,  
sa mend s'ndiheshin as dallgët  
e pasosme që e rrethonin.

E pastaj u ngrit dhe hëna  
të voziste si ngahera.

Vasha, mallit e pashmallur,  
porse pakëz e qetuar

si dhe retë kur rresht era,  
ngadal llërët i largoi  
prej të shoqit, bukuroshit.

La mbulesat edhe shkoi  
tek dritsorja e shikoi jashtë,  
gjer tek yjet ujët ngjitej  
dhe lidhte botën e gjerë.

Era anijes së detarit  
plot me bindje i shtynte velat;  
ky i lodhur tani flinte,  
vetë anija po voziste.

Zemra e Miranës donte  
ta thëthinte atë pamje,  
q'është shujtë e vetë jetës.

Dhe kur u kthye në shtrat

si një çast e kaloi gjumin  
edhe iu hap dita e kaltër.  
Pa mërzitje u ngjit sipër  
dhe në hije krahë plakës  
ndenj me vështrim nga Kotori,  
që tani mezi po shquhej  
e në çast kish për t'u zhdukur.  
Dhe të dyja, plakë e vajzë,  
me shqepzat i fshinë sytë  
dhe Mirana hoq nga tufat  
gjithë lulet që ishin fishkur,  
fletë-fletë i hedh mbi ujët.

*Mirana:* — «Ato të pakën po shkoqen  
duke parë vendin tonë,»  
tha me vete e lehtë nisi  
t'i këndojë po vetvetes  
një këngë të lashtë shumë:  
«Dhe fëmija, që e çon jashtë  
dada e saj, kërkon shtëpinë.  
Dhe bariu i lirë brinjash  
në qytet i ëndrron të kremtet.

Edhe unë shumë herë  
n'ato dit' të verës-zonjë,  
parreshtje dëgjoja këngën  
e kositësit të barit.

Trimnë e doja të më donte  
pa edhe larg të më çonte.

Doja që kryet e bukur  
vetëm te ky gji t'i prehte.

E ndieja se pas do lija  
jetë fisnikësh që myket  
fare e re fronesh të plogët  
por në gji visar do kisha.<sup>1)</sup>

Dhe ja, sot ne po vozitim  
detit që na priti i ftohët  
dhe kripbardhë si edhe fati  
që kaq vonë, s'di a më erdhi.

U ngrit nusja lehoniet  
më e lehtë, se kish lindur,  
tymi i kallmeve në fusha  
fryhej dhe kthehej në ufmë.

Djalë e vajzë ajo lindi  
që në ballë shumë i ngjishnin  
dhe tha: «më sosën sa lindën,  
gjithë dashurin ma morën.»

Katër herë dha rrush larza<sup>2)</sup>  
edhe nusja ra me kallzat.  
Dhe në vend të saj stoliset  
shpejt një tjetër zonjë e rëndë.

Dy fëmijët aq të hirshëm  
ia dëboi nga pallati.  
Pa të njohur në qytet,  
ikën pa bukë e gjiri.

Mbrëmja mbanë udhës i mblodhi.  
Veshët ngjeshur trollit, s'ndien.

zhurmë kallmesh, dushqesh, kokrrash,  
që i hanin egërsirat.

Kur na gdhiu dita e re  
vajza shkul dy fije floku  
edhe djali një lak bëri  
e me' të kapi një vidë.

Si hëngrën vanë për ujë,  
shesh më shesh dhe të djersitur  
na u ulën tek një arë,  
ku përkundte grurët era.

Por andej nuk shihnin tjetër  
përveç diellit që i digjte.  
Të friksuar qanë e thanë:  
«Sa larg paska shkuar mëma».

Kur ja, ndiejnë shtrush prej grurit  
dhe q'andej faneps një mirë.<sup>3)</sup>  
Ajo me duart e bardha  
u dha ujë që të dyve.

Pastaj mira i ve vajzës  
një anak prej perlash detit  
edhe djalin e ndërroi  
në një anije të bukur.

Mbi anije hypi vajza  
dhe vozit detit të gjerë.  
Deti vetmitar e rriste  
diçka zemrën ia tërhiqte.  
Vashës i dukej se shkonte  
ndaj një bregu ku do gjente



trimin që me mall e priste  
ta shikonte kaq të rritur.

Nën një breg dushqemëdhenj  
dhe me kallme blerimtare,  
në zall rrënjët, mbi ujë hijet,  
vasha na e la anijen.

Sapo u hodh në breg e ndjeu  
se ai vend do t'ishte Egjipti:  
«kopësht mbreti». Dhe u step,  
ndali hapat, në vend mbeti.

Namëta i biri i mbretit,<sup>4)</sup>  
shtatmbëdhjetë vjeç, i djersur,  
iu gjend pranë; vasha u zbut,  
iu afrua, i puthi dorën.

N'hije shkuan edhe shijuan  
të dy lulen e rinisë.  
Si të njohur djali e ftoi  
ta nderonte në pallat.

Iu kujtua vllau e mëma  
kur e përkundte e mejtonte  
n'ish moti kur lindi djalin  
m'i egër se moti i saj.

E përmallur dërgoi njerëz  
tek anija, por gjë s'gjetën.  
Vasha si prej ëndrre e zgjuar  
ra në mejtime të zymta.

Të mëdha, t'hapta, të larta  
ishin dhomat ku jetonte;

këndesh: mumje burrash, grash,  
ballë: prag dëshirahumbur.

Vetë ai vend: i sheshtë, i madh,  
qielli: gardh shtyllash rrethuar,  
që përmbi ujra na dalin  
kur vërshon përmbytjet Nili.  
E papunë, veshjezhurmë,  
endej dhomash dhe pyeste  
vetëm mumjet... Kujt t'i gjegjej  
do t'i truhej si një zoti...»

Këtë këngë lashtërie  
si për vete e këndo  
me zë të bukur Mirana  
dhe mejtim zhytur në motet,  
u ngrit. Edhe sa ra mbrëmja  
një përgjumje e ëmblë e mori.

Në det peshqit u tërbonin  
vorbulluar ujit turbull.  
Re të tymta e mbulonin  
qiellin bruz si danga-danga  
era e fortë fshinte drrasat  
dhe pështjellonte tërkuzët.  
Prap Mirana ish në gjumë.  
Breshri fryhej e veli shqyhej;  
mbi det ngjanin dallgët male  
kur shkrepinte shkrepëtima  
dhe si gogla krejt anijet,  
përshkënduar krahë tyre,

ase thellë në humnerë.  
Dhe sa zhdukej shkrepëtima  
krejt anijet shpejt u zhduknin.  
Prapë Mirana ish në gjumë.  
Kur u zgjua, agu i bardhë  
dritën kish hedhur mbi shqotën  
si t'ish fjala e së drejtës  
lajmëtare e kohës mirë,  
lauresha në flantikth  
përmbi ujrat e paprehje,  
këndonte nga dhoma e Lenës.

Napëzezë e pështjellë,  
ndenj Mirana dhe vështronte  
trumba-trumba pulëbardhat,  
që mbi dallgët në përkundje  
posi retë u çonin qiellit,  
lart më lart nuk di se sa.  
Gjithë ditën, q'egër shiu,  
si t'i tekej, rrih anijen,  
ndenj i zyrtë admirali  
dhe m'e zyrtë nga të gjitha  
iu duk kjo e turbull ditë.

## VI

Ditën tjetër, dielli vonë  
shkrepi velave të lagur.  
Pasi çanë si një lumë

mes pyjesh plot që dhe zjarre<sup>1)</sup>  
me ngazllim, larë prej shiut,  
anijet Napolin panë  
dhe kambanat i dëgjuan,  
që me gaz i përshëndetnin.  
Anijet me breshëri topash  
përmbi bumbuj dallgësh gjegjën<sup>2)</sup>.  
Mbi pallate e ndënë diell  
na buisin vashat-zonjza  
të fejuara dhe shikojnë  
djemtë e fqinjve mbi pullazet<sup>3)</sup>  
aty afër. E sa i shohin  
ndjejnë çaste lehtësimi  
pas fejesash aq të zymta,  
(me burra që u gjenin prindët),  
ashtu si ndien dhe Dhezuri  
kur i zhduket tymi i zymtë  
dhe del krenar dhe i freskët.  
Te pallati i Mbretëreshës  
ndënë valzime koltrinash  
dritsoresh dalin dhe shohin,  
me çdo vashë nga një djalë  
që m'i fliste e kjo mjaftonte  
për t'i qojtur «të martuar». <sup>4)</sup>  
Ndënë vigth ari e mëndafshi  
qëndron Mbretëresha e sheh<sup>5)</sup>  
dhe tek çdo dallgë që ndërrohej  
në det poshtë kjo ndiente brenda

vetëvetes sikur ndrronte  
apo i tretej një mejtim.  
Dhe së bijës së Foskarit,<sup>6)</sup>  
që më këmbë i rrinte pranë.  
pa iu kthyer, kjo i thotë:

*Mbretëresha:* — Short të mirë ty të rojti  
zemra jote, që plot hire  
ta pajisi munështiri.

Admiralin që kërkoje,  
posi zogun n'arë gruri  
era sot këtu ta solli. —

*Garentina:* — Ç'po më thoni? Mos është  
ëndërr?

Ah, ta kem sonte e të vdes.

*Mbretëresha* e vërejti:  
ish biskajë, e re, e hollë,  
si mermeri zbardhëllonte.

*Mbretëresha:* — Folmë, e zemrën lehtë-  
soma.

*Garentina:* — Në kodrë të vilës isha  
kur erdh për të parën herë  
për gjah me të mi vëllezër.  
Si yll drite ai m'u duk  
mua, që sa kisha dalë<sup>7)</sup>  
prej kafazit, afër nesh  
po mblidhej një grigjë delesh,  
që më këmbë po zbardhonin.  
Dhenarët milnin të shtrunga

dhe stanarët bënin gati  
tiravolet e rrugenjtë.<sup>8)</sup>  
Vanieri nga poshtë ngjitej  
me një vashëzë për krahu.  
Ish e huaj dhe me dorë  
ndreqte velin rreth gërshetës  
sepse frynte era e detit,  
që çdo gjë terte sa jashtë  
mund të flihej edhe natën.  
Sa i panë, ngado u sulën  
qentë e bardhë, duke lehur.  
«Ndillni qentë!», klithi vasha  
dyllë e verdhë. Qentë i ndollën  
dhe me zvoj shpejt i larguan.  
E të dy i përgëzuan  
edhe shumë u bënë nder.  
Unë duke shkukur flokët  
te vilë e prindve u ktheva...  
Kaq tha vasha e që së jashtmi  
brenda jonet u përhapën.  
Sallat çelen. Dhe krenare  
tok me tringe-tringe shpatash  
hynë edhe harenë e mbushën  
djema zotërinj të huaj.  
Faqeskuqur Garentina  
çap përpara e ndaj Vanierit  
kryet plot perla përkuli  
edhe atij dorën ia puthi.

Por askush as në mesnatë,  
kur hap sytë e befas sheh  
vendin më të keq të dheut,  
(varrin driza e dushk mbuluar)  
nuk do të tronditej aq,  
sa Vanieri u trondit  
kur këtu pa Garentinën.

Vasha e vrejti të pabesin,  
më s'u mbajt dot edhe ra  
krejt e prerë përmbi fron,  
kryevarur, flokëshpleksur.

«Ndihmë!» thirri Mbretëresha  
dhe nga dera një tok grash  
hynë edhe si t'ishin lule  
rreth një lulje që e grin breshri,  
pranë i vanë e lehtë i folën.

*Mbretëresha:* — Të na bindë për fitoret  
e tij, ky zotni goditi  
shoqen time më të afërt!

*Vanieri:* — Madhëri, sapo e pashë  
këtë fluturim të saj,  
që nga vatra e prindvet mi  
gjer këtu, unë mejtova  
se më kishin vdekur gjithë!

*Mbretëresha:* — Jo, askush ty s'të ka  
vdekur,

por si vetë vasha Psike  
në pikzore grekërie<sup>9</sup>)

Garentina m'i ka krahët.  
Heshtja ra, u përmend vasha,  
u ngrit e tha plot nderim:  
*Garentina*: — S'është gjë. Lutem më ndjeni,  
s'di si m'erdhi!

Shpejt një zonjë<sup>40)</sup>

e ponishme i ndreqi flokët  
me një krëhër të florinjte,  
me pëllëmbë ia lëmoj.  
Rrinte vasha si një dele,  
krejt e zbutur prej së keqes  
që e goditi edhe secila  
bënte çmos që t'ia largonte,  
duke e fshehur zemrës thellë.  
Veç një tufë floku i zi,  
që ende i rrinte mbanë syrit  
Garentinës mollzadyllë,  
si lot dhrie pas shartesës  
kujton breshrin që sa shkoi.

## VII

Mbretëresha kur u gdhi,  
hypi tok me Garentinën  
në një varkë velaartë,  
shpejt e shpejt filli të vetme.  
Në hije të nj' a dy reve



që binin poshtë mbi det,  
prej anijes admirale  
një varkë e vetme u nis  
drejt te varka velaartë.

Sa e pa se kush po vinte  
admiral Venieri e humbi,  
strehët ku fshihej iu zhdukën  
truri valë-valë i sillej,  
rend Miranën për ta nxjerrë  
që nga dhoma e tij në pod  
lart ku ishin dhe detarët.  
Si njeri që një të vdekur  
nxjerr nga varri dyllë i verdhë,  
zbriti e Miranës i thotë:

*Vanieri:* — Si ahëre që fëjeva  
dhe të vodha dashurinë,  
e ti «jo!» s'më the një herë  
dhe sot, me hir si ahëre,  
më ngjish brezin e argjentë,  
vërë kejkën e llambarme  
edhe sipër me bujarët  
dil e prite me seni<sup>1</sup>).  
Mbretëreshën që vjen mike.

Vanieri fytyrëprerë,  
anakë margaritarësh  
ia vë llërëve të borme,  
gajtan arit i zgjat krahësh.  
Ajo e qetë zbardhet, skuqet,

gjersa, taka-trokëllimë  
ngjitet lart me shpirt të pastër,  
të kthjelluar si rrallherë,  
ngaqë e di se askurrë dorën  
nuk e ndejti për të ndarë<sup>2)</sup>  
valë shoqe. E jashtë odës  
po këndonte lauresha  
si t'ish lajmëtare e qiellit.  
Thikë ish kënga për Vanierin,  
që të shoqen po stoliste.  
Dhe Mirana e dliirë del  
taka-trokëllimë lart.  
Dhe Vanieri me llahtarë  
rend e mbyt zogun e qiellit:  
*Vanieri*: — Dhe tani mua askurrkush  
s'më padit se kam dy gra!  
Tha Vanieri ballëdjersur,  
ballëdjersur, mendjeshtregull.

Lart hare na vlonte vera!  
Dhe pijet sheqer-e-akull  
e kafeja vinin shkonin  
ndër zotrinjtë. E diçka kishte  
dhe për të shkretët detarë,  
shokë vetëm nëpër shqotat<sup>3)</sup>  
të shpërthyera larg brigjesh!

Filli i vetëm, i pështetur  
te një djalë zemërmirë,  
një plak, lindur larg në Spanjë,

ngjitet, tek shisnin edhe ulet,  
krejt mënjanë, krahëlënë  
dallgësh t'egra, theror kryqit,  
edhe bukën thatë ngrënë,  
skllav tek kush krahun i mori.  
Liruar nga venedikas  
q'atëhere me ata rri,  
djegur mallit për vendlindjen,  
ku një grua t'ia lan teshat.  
Plaku lodhshëm i hedh sytë  
larg në largësitë e detit  
pa ngjeruar asgjë t'ëmbël  
nga sa shiteshin atje.  
Qeshi, se kujtoi mjerimin  
e kalorësit që u plak.  
Djali i tha: «A don të vij  
të të marr pastaj?» «Jo, bir!  
Sa të çlodhem pak, do vij  
i pështetur në shkop tim.»  
Fryma i merret dhe mbi gji  
e ve dorën e i tret sytë  
andej nga dikush i thotë:  
«Pi një kafe, e pushon dhembja.»  
Plaku sy-për-lot e vren,  
po Mirana pranë e ndjen  
që s'kish pare i shkreti plak.  
Ulet dhe në dorë i ve

një kuletë duke i thënë:  
*Mirana*: — Këndej rrojnë, o plak, në **kanje**  
dhe nuk dinë se tejdetit  
derdhet gjak për vatra e besë!  
Namta vjen mbretëresha  
me Garentinën përkrahu,  
ia shpërvesh stolitë era  
që me re mbulonte qiellin.  
Të tri gratë u panë e u matën.  
Edhe pse pakëz barkfryrë  
si shtatzënë, arbëreshja,  
në atë cohë gajtan arit,  
gërshetë arit, mollza mollë,  
zbardhur nga trishtimi i brendshëm,  
me të folurit plot hire,  
që të dyja italianet  
krejt kish për t'i errësuar,  
po mos ish që i shoqi fjalët  
e lëvdatat e kujdesjet  
t'i kish vetëm për Mbretreshën.  
Bija e dukës Venedikut,  
Garentina e Foskarit,  
arbëreshën si pikzore  
e vërente dhe nuk ngopej  
e çdo fjalë aq ia përpinte  
sa Mbretresha qesh e thotë:  
*Mbretëresha*: — Para se t'ikim, ju **ftoj**  
të më nderoni tryezën

me t'arbreshen kaq hirplotë,  
që të dyja na magjepsi!  
Fliste e vërente, e sytë ia ngjiti  
plot me ngasje ajo Vanierit  
dhe ia shqit kur ai kuptoi  
se Mbretresha ndezej epush  
që t'i binte atij në dorë.  
Pasi shqota e zezë afrohej  
që ta lij pa pluhur verën,  
Mbretëresha e Garentina  
kthehen sërish për të zbritur:  
*Mbretëresha*: — O, moj vajzë, m'u sos gazi,  
siç na soset më të ngrysur  
të një dite Virgjëreshe,<sup>4)</sup>  
si mejtimet e pacak  
na iu sosën dhe latinit  
që me Romën tok përmysej  
sa la detin që e pat mbajtur  
larg qytetesh, për të zbritur  
zallit, ku iu derdh dhe gjaku.<sup>5)</sup>

Garentinën e grin ankthi  
që s'pyeti e kujt ish grua  
arbëreshja dhe as vinte re  
çfarë thoshte Mbretëresha.

## VIII

Zonja Miranë u stolis  
për mbrëmjen te Mbretëresha.  
Ajo vu një anak prej perlash  
si kokrra rrushi t'arrira,  
cohën mpiksur në fill arit  
dhe dadë Lenës i thotë:  
*Mirana:* — Dadë, në pësosha gjë,  
këto merri e në Kotor  
shko... se si po duken shenjat  
ndruhem se kishte të drejtë  
trimi i arbër kur më tha  
«gjithë hiret që ti ke  
sa të shkelësh në vend të huaj,  
do të fishken sikur t'ishin  
një diçka pa farë vlere!»  
Ai të mirën ma deshi...  
Tani shkoi... Sa për vete  
nuk më vjen asfare keq  
por më vjen keq për tim-shoq,  
që tani, si rrodhën ngjarjet,  
më mbet i vetmi gjiri,  
një short: lidhur me kurorë;  
dy vetë: një fat i vetëm!

## IX

Kur u ngrys zbritën në varka  
gjith të ftuarit për darkën  
që kish shtruar Mbretëresha.  
Në breg hypën në karroca  
drejt pallatit. Dhe në rrugët  
krejt të lagura prej shiut,  
qerresh tërhequr prej mushkash  
plot gajtanë e fletë vidhash  
përçark tëmthash dhe në duar  
me dafina e grumbuj-grumbuj,  
zbrisnin nga Shënmri e Malit  
lazanjarët lukuni<sup>1)</sup>  
dhe u këndonin «mrekullive»  
të trurrudhurave plaka.  
N'ato rrugë e n'ato qerre,  
n'ato thirrma ish jeta e tyre  
dhe puhia, si çdo ditë,  
niste flladiste çdo gjë  
rretheqark e hijeshonte.  
Nga pallatet bujaria  
englandisej kur shikonte  
si vllazron qytet i moçëm!  
Por, papritur, shpërtheu shqota  
me kërcëllima përmbi qelqet,  
bujarët u futën brenda,  
lazanjarët mbetën jashtë!

Në pallat dhe Mbretëresha  
sa Miranën e shikoi,  
e zu përdore e i thotë:  
*Mbretëresha*: — Unë e arrita mesnë e  
jetës.

Më pëlqen kur gjëmon qielli  
dhe kur bie me rrëmbim shiu,  
sepse më kujton se jeta  
është e shkurtër dhe e brishtë.  
Dhe kjo brishtëri të gjithve  
na nxit që t'ia hapim shegun  
kohës që në dorë kemi.

*Mirana*: — Këtu, si në pallat qielli,  
bubullimat na shkojnë afër  
por s'na bëjnë asnjë të keqe!  
tha dhe ulet në një fron  
dhe sakaqë ajo tërhiqet  
nga disa tinguj muzike.  
edhe veshi i saj i bukur  
dëgjon një vashëz bujare,  
me trupin vllastar tek orga,  
me gishtrinj unazandritur  
jone nxjerr foljetash ashti.  
Mendja e vashës kalon malet,  
larg e çon, se trimit saj,  
t'arratisur nga qyteti  
i këndonte guximtarja.  
Asnjë natë s'iu lejua



që t'i ndodhej trimit pranë  
dhe në dritë të hyllnarit.  
Por tani, në drita jonesh,  
i ndrit trimi brenda zemrës  
dhe rreth saj gjithë tronditen.  
Trimit q'u ndruhej armiqve  
dritë bese i ngjall në shpirt.  
Edhe i ngjan sikur i thotë:  
«Fatmirosh, o vashë linda  
sepse pata pranë vetes  
ty, gjysma ime më e mira!»  
Syri i saj ndrit dhe i duket  
sikur është posi syri  
që shëroi trimnë e plagosur.  
E të lumtur gishtërinjtë enden  
mbi foljeta t'asaj orge.  
Por pse nga trimi s'largohet  
dhe s'mbulon harmoninë  
me krejt madhështinë e botës,  
prej nga erërat dhe valët  
marrin lule edhe shkumë  
dhe gjatë udhës ia lëshojnë  
prehrit Banit, gjithësisë?)  
Jashtë shiu i ngujuar  
nga gjëmimet bumbullore  
në mes reve, ai zbuluar  
nga shkrepimat, tani treste  
kufomat që linte vdekja!

Me dritsoren krejt të hapët  
flokët bërë qull nga shiu  
në një dhomë të pallatit,  
Garentina e vetme grihej  
ndënë ankthet, që i maisnin  
jonet, që i godisnin veshët,  
kur e vetme hyn Mbretresha:  
*Mbretëresha:* — Ngreu, Garentinë! Jetën  
në hauzet gufa e prita  
një det i madh na pështjell  
përherë t'i marrë frymën.  
Porse jeta ngrihet, çan  
dhe shkon sheshesh që pëlqen.  
*Garentina:* — T'isha djalë, zotit tatë  
helmë e rëndë do t'ia fshihja.  
Për një trim që përball shqotat,  
egërsirat e lumenjtë  
dhe meritë e të fuqishmve,  
hije ka një vashë trime.  
Trimja i thotë atij: «Shikomë,  
dhe gëzoi ti këto hire  
nga të gjithë aq të lakmuar!»  
Pa një trim s'kam veçse lotët.  
Mbretëreshë, të të dhimsem!  
Më s'jam vashë si ahere  
kur përkrahë zonjës mëmë  
mbi anijet velaqeshur  
dilja e lirë, e lakmuar.

Ndër të gjithë djemt bujarë  
zemrën time ai e pati.

Në shtëpi të tij vend desha,  
pa si trëndafil t'u fishkja,

Kurse ja, tani kam mbetur  
pa Vanier e pa njeri.

Edhe sonte jam si e huaj

në harenë që po bëjnë

bujarët, bij të llatinit.

Si ta shoh barbaren arbëre,

që të rritë ajo në gji

bij gazmorë, që do t'ishin

bij të zonjës Garentinë! —

*Mbretëresha:* — Ti mos qaj, moj bijë e  
dukës!

Si një motre të jap besën

kudo sytë që t'i hedhësh

këtu cilido prej meje

ka të keqen dhe të mirën.

Ti në krahun tim mbështetu!

Dhe fryn jashtë e i ndez ëndjet<sup>3)</sup>

kthehet shpejt edhe dëshirat

për vallzim zgjon ndër zotrinjtë;

jashtë s'kish të sosur shiu.

Zotrinj, zonja faqemollë

gjith përdore zënë, u ngrenë,

një rreth bënë e në mes vunë

zonja flokë-krehur-bukur,

që duart butë u humbisnin  
në të zotrinjve plot zjarr...  
Dhe tej, (në pasqyra muresh)  
larg, nuk di se ku, rrëmbyer  
prej së njëjtës erë-afsh,  
po njësoj, pa fund, vallzonin  
si të donin të largonin  
qdo mejt看 që i shqetësonte...  
Edhe vallja u ndal njëherësh  
kur fort jonet tingëlluan,  
të kalonte Mbretëresha  
fort e skuqur, si Vanieri  
prej krahësh i heq pashnikun,<sup>4)</sup>  
edhe na doli nga salla...  
(kinse të mbulonte turpin)...  
Pas pak kthehet dhe e skuqur  
kërkon që t'i japë vetes  
sjellje e hije mbretëreshe.  
Në tryezë ulet në ballë  
me Vanierin dhe Miranën...  
Goja e saj qeshte dhe fliste  
si askurrë ndonjëherë.

Shqota reshti e hëna qeshi  
lart në qiell; poshtë te sheshi  
para pallatit fenerët  
sërish ndezur, në rresht ndrisnin;  
atjë të varfër vallzonin  
nën tinguj tumbarinesh.

Atje një trim e një vashë<sup>5</sup>)

hidh e prit këndonin bashkë:

«*Trimi*: — As ma tregon atë ballë  
posi një dritë hareje.

*Vasha*: — Trim, kur të bëri jot ëmë,  
si t'i bëri ato llërë,

ata flokë e ata sy,

për mua vallë a e dij

se do të m'ishin magji?

*Trimi*: — Vashë e bardhë, që bën bukë  
a më shet mua një bukë.

Përnjëherë unë s'e ha.

gjith ditën dua ta mba

*Vasha*: — Mëma m' kanosi mua

se bukën e bëj të bardhë

si trimi që do më marrë.

djali që do rrit më duar.

Por nga nata shpejt, më shpejt

po ndehet kujtimi i gjumit.

Dhe nga dera, q'u hap t'iknin,

fillimi frynte shumë i ftohtë.

Si gjithë ikën shtrati i butë,

rreth me shpërvjerëse si bora,

në pallat të Mbretëreshës

na qe ngritur për Vanierin.

## X

Me dyshim të lehtë ballit  
Mirana e vetme hypte  
në anije. E asnjë kândil  
pranë shtratit nuk e priste,  
që t'i ndriste harenë e mbrëmjes.

*Mirana:* — Kaqë vonuam shumë, **o Lenë,**  
sa ti u kote e drita u shua.

*Lena:* — Po llatinin ku ma ke?

*Mirana:* — Është im zot!

*Lena:* — Mos qoftë **kurrë!**

Ai sot po më shtrëngon  
që me rrënjë të ta zhduk  
edhe gazin që ta ndeza.  
Përse vdekja, si tim ëmë  
s'më mbuloi në dhe të zi  
dhe sot nderin arbëresh  
s'do ta shihja të njollosur  
prej llatinin! Ah, si deti  
që s'ka veshë, mos past' as dheu!

*Mirana:* — Ç'rëngë tjetër të ka **ndodhur!**

*Lena:* — Rënga e parë edhe e fundit!

Në të rëndet fjala ime,  
ndjemi flokët, moshet thinjur.

Qen llatini, që gënjeu  
vashën e zotrinjve t'mi,  
na qenka burrë i martuar

me llatinen q'erdh n'anije!  
*Mirana:* — Ç'po më thua? N'është **kështu**,  
para se të lenim vendin,  
nderi e donte të na e thoshte  
në Kotor... Sot ne dy gra!  
Dhe si nj' arrë që dy shqota  
e sulmojnë ta shfarosin  
dhe arrë e shkretë përplit degët,  
e kur sytë as e besojnë  
arra bie e rreth trënd tokën,  
vasha lëshoi një rënkim,  
ku varroste gaz e jetë  
edhe ra mbi shtrat, papritur  
hundësh gjaku i buçiti.  
*Lena:* — Qyqja unë! Mos më vdiq! :  
Brenjë jete, me ndrrim vendi,  
ja ku lindën ato thahen  
ja me kalim kohe treten  
por gjithmonë helmi i vdekjes,  
qoftë borë a kohë e mirë,  
rëndon sa gjithë gëzimet.

## XI

Edhe n'atë qeli helmi  
plaka s'thirri asnjë të huaj,  
por i puthte dorën vashës

dhe ia mbante shpresa zemrën  
se të zbetë krejt s'e shihte.

Edhe si kalonin orët,  
vasha brenda përpëlitej  
zhytur si në det të turbull  
të palavisë q'i ngjau.

«Ah, te ato hije shkozash  
ku s'arrinte zhurmë dallgësh!»  
tha, pshertiu edhe u kthye  
e me dhembje hapi sytë  
dhe më lot ia ngul kandilit.

N'odë agimi depërtonte.  
Zbret te froni e arbresha qan  
për ditën që i hapi plaka.<sup>4)</sup>

*Lena:* — Kam për ty një kshillë, **o bijë!**  
por si të marrësh pak forcë.

*Mirana:* — Mëmë, gjithmonë e **mirë,**  
më ndihmo! Se kurrë s'qeshë  
më e vogël se jam sot  
ndënë turp. Kur të shkosh, **shtroje**  
para krejt bashkatdhetarëve,  
(s'flas për gjakun tim, se gjak  
nga bujarët tanë derdhet  
si ujë lumenjsh përdita  
edhe për dobit të huaj!)  
por ti shtro përpara gjithve  
nderin që një arbresheje i mori



një i pander përpara syve!  
Skënderbeut edhe Golemit,  
Shtresit, prijësve të luftës,  
tek unë u është palavitur  
nderi i mëmave arbreshe,  
që aqe bij të mëdhenj lindën...  
Ah, ky det t'ish aqë i gjerë  
sa të dukej dhe Kotori,  
kuja ime atje të ndihej.  
Atje gjendet dhe Vlladani,  
tash prej plagësh i shëruar,  
që prej turpit që më ndodhi  
aq ai do të tërbohët  
sa do donte të kish jetë  
(qartë e shoh këtë si ditën)  
aq sa jeta atij t'i mbytet  
në gjak të të gjithë armiëve,  
që bujarin fis na ndotën.  
T'i mbytet!... por pa m'ia larë  
gjirit tim ndragun llatin,  
që përjetë do më mbetet.  
Në gjak të ndyrësh Vlladani  
do të shuajë ankth e duf  
për shpagim e për fitore.  
Një ditë, eh, arbreshët trima,  
pasi shqota që zhvesh pyjet,  
gazë armikut do t'ia fshijnë  
atdhenë e lirë do mbrojnë,

shpatëngjeshur, sogjetarë,  
me sy hëne edhe natën.  
Por sot unë tatë e vllëzër  
dhe ndën varr, i turpërova!  
Me turp sot më mbyllet jeta  
në mes njerëzve për gjithmonë!

Tha dhe kokën e pështeti  
gjirit plakës, edhe lotët  
faqesh sumbulla i lëshonin;  
mendja lart më e lehtë i ngrihej. . .  
Por sa shternnin lotët, i dukej  
se po binte që nga retë  
befas poshtë e me drithirë,  
buzëtharë vasha thotë:

*Mirana:* — Unë po bija në lumë  
edhe poshtë s'po më dilte  
për ndihmë asnjë arbëresh!

*Lena:* — Korba unë, ç'flet, moj bijë?

*Mirana:* — Oh, jo, unë nuk u çmenda!  
Dhe fytyra nga llahtara  
po m'i zbardhej. Por pastaj  
krahët kryq i vu mbi bark,  
brenda të cilit një foshnjë,  
që nuk dinte çfarë ndodhte,  
krejt në paqe merrte frymë  
edhe zemra i shpihej vashës  
dalngadal, ashtu si syri  
hapësiravet na shpihet.

## XII

Ish gdhirë e dita kish marrë  
dhe pas pak përpara i dolën  
Miranës së Arianitit  
dy bujarë të pallatit  
të Mbretëreshës llatine.

Dhe më zi, siç qe, i priti  
me fjalët e saj plot mend:

*Mirana:* — Do t'ish mirë të pyesnit  
dhe detarët do t'ju thoshnin  
se n'anije im zot s'ndodhet.

Dhe ndër ne, n'Arbrin tej detit,  
gratë pa një burrë pranë  
para të huajve s'dalin.

— Njëri ndër 'ta, një syterur  
si sy gjarpri, çeredyllë  
dhe zëçjerrë na i përgjigjet:

*I huaji:* — Edhe ne nuk do të donim  
që një vajzë ta shqetsonim  
por ne këtu na dërgoi  
drita e grave, Mbretëresha.

*Mirana:* — Në më do për gaz, për mua  
kjo ditë është ditë zie.

N'ju dërgon si mbretëreshë,  
unë linda e lirë e zonjë  
dhe besoj të lira janë  
këtu dhe këto anije.

Në vetveten unë e dhashë  
dorëllirë, kjo sot mbaroi.

*I huaji* — Gaz Mbretëresha s'ka për **helmin**

tënd edhe as këshill të keq.

Mbase do me ty të flasë.

Krenaria larg atdheut

te këjo anije e huaj,

në një mbretëri të huaj,

filli e vetme e pa një ndihmë

veçse keq, s'të sjell të mirë!

Fytyra vashës iu ndez,

pastaj jo zakonshëm zbehet,

*Mirana*: — Ora e fundit na gjet, **Lenë**,

krejt të zhveshur nga çdo nder

siç na ka hije ta presim!

Ç'ish njëzet vjet më përpara

shtati im? U thuaj tanve

në Kotor. Dilinën puthma.

Porosi nuk kam për të,

së gjithmonë e pafajme

ndaj të gjithve, unë humba

hijen, nderin, veten time.

*Lena*: — Ime zonjë! O bija ime!

Më ngjan vdekja e veshur grua!

Korba! Ç'na gjet kjo mënxyrë!

Edhe Lena flokëbardhë,

ditëzeza, qafëthyer,

duke qarë i bie më gjunjë.

*Mirana:* — O vërsnike e zonjës mëmë.  
lindur motesh kur drithmohej  
kush ngit lumturinë tonë,  
çohu, mos më ligështo.  
Turpit tim sot iu pre ora:  
tani veten unë e ndjej  
dru që digjet, kthehet flakë.  
Pas pak orësh turpin tim  
do ta laj me gjakun tim!

Tha dhe zemra e mundi mendjen  
e i hedh sytë nga dritsorja,  
detit pa fund që lan tokën,  
n'atë çast rrëpirej shiu  
dhe fshihte botën e njohur.

Vasha shpejt e mblodhi veten  
edhe krenarisht na niset.

*Lena:* — Bijë! O bijë hijemadhe!  
Ku më shkon? As burrë as trim  
nuk të pret. Si aq lehtë  
ti me të huaj m'u nise  
për atje që vetë e the?  
Nuk të pret ty, si një herë,  
qyteti yt halshtuar,  
kur më dilje e ku ia nxure  
udhën detit për dhe t'huaj!  
Ku më shkon, sapo t'arrish  
s'do të puthë buzëqeshja  
buzën tënde, porse vdekja!...

Bubu për mua, moj bijë!  
Zemërpastrë si fëmijë,  
kur vëllezërit t'i vranë,  
në pallat të nxinë mëmën,  
shoqet skllave t'i dhunuan,  
ti më shkon filli e vetme!..  
Bijë! O bijë hijemadhe!  
Ky vaj larg e lart e ndiqte  
vashën, prej shiut vetmuar  
dhe fytyrën po ia zbehte  
një mejtim i ftohtë borë.

Korrësit e kallztoret  
larg në fshatra n'ato çaste  
hijesh të freskta gorricash  
hanin qetësisht mursillën,<sup>1)</sup>  
kur Mirana zbreti n'udhët  
qull prej shiut dhe pa shitës.  
Një njeri kalonte e mbarte  
përmbi krye në një drrasë  
një të vdekur të zbuluar,  
duarvjerrë. E në pallat  
të Mbretëreshës llatine  
çdo derë e qeltë ish mbyllur.  
Vasha ngjit shkallët e ngushta  
edhe t'errta, siç i thanë.

Shquan një derë të bardhë  
e sa i hapet, duhmë e kripur  
ujrash pisë e qelbësirë,

shpërthen jashtë, e gjëma e detit  
ndënë pragun drithtëroi.

N'atë çast dielli çjerr retë  
dhe rrezet si rrëmba shiu  
i përplas në mes të detit  
dhe gjer në breg hodhi dritë,  
duke u nderë kodrash dallgësh  
gjer ndënë atë prag të errët.

Në parmak Mirana u mbajt  
të vij re dheun ku rrojti,  
se s'e njohu ditëshkurtra.

*Mirana*: — Tatë, zot, që s'të kam pranë  
në këtë çastin e fundit

më dëgjo, tok me të tjerët,  
që mbase më shumë i deshe:

«La fëmija gjinë e mëmës  
me harenë e një premtimi.

«Mos beso!» i tha gjitonia,  
e fëmija nis të qajë,

dhe pse mëma i jepte zemër  
me të qeshurit e saj».

Unë, e rritur, e pandehja

të zbrazët ashtu si erën,

mendjen e asaj fëmije;

por tani dhe më të zbrazët

shoh jetën time, të shkrirë

për tekjet e një llatini.

Zoti tatë, më rrëmbyen,

edhe s'pata hare dite,  
as paqe netësh të mira  
siç kisha në shtëpi time!  
Këtë çast që po më mbetet  
më dëgjo, të përgjërohem  
Me dashuri, si edhe djemtë,  
që si bisqe të dëgjuan,  
mëshiromë e në gji pritme!  
Diell drite, kushtrim jete,  
dilmë e folmë, e kurrë s'ka  
ç'të na bëjnë as ujra detesh!»<sup>2)</sup>

Dhe Mirana e pushtuar  
nga një besim shumë i madh  
u lëshua si mbi krahë  
drejt fundit botës pa fund.  
Si zog që të parën herë  
pa mbështetje nis çan ajrin,  
ajo besim të përjetshëm  
pati në veten e saj.  
Edhe çante atij deti  
të pafund, drejt malesh, hënës,  
dhe më tej. Si ngjet në jetë  
që mejtimit shkojnë e vijnë,  
për gjithmonë një na mbetet  
posi qielli, ashtu Miranën  
e rrëmbeu, por më i ri,  
dielli, që nga lart i ndriste  
dhe n'hare ia tret mejtimit.



Edhe poshtë që prej sheshesh  
të botës shumë të largët,  
për atë, si për një mirë,  
zienin këngë plot hare.

---

## KËNGA E DYTË

### DILINA ARIANITI

*Delvinë, nata e kërshëndelleve, 1492*

#### I

*Dilina:* — Vishu, Dinë, se Delvina  
me gërneta e bibizane  
në rrugicat, po na zgjohet  
dhe m'e madhe nga sa është,  
pasi edhe ndënë zgjedhë  
kjo s'përkulet edhe pret,<sup>1)</sup>  
se nuk vdiqën gjithë trimat  
tok me tim shoq e tët atë,  
prijs Vlladanin, q'asnjë çast  
s'do jetonte ndënë turqit.  
Tha, dhe flokarta Dilinë,  
e bija e Arianitit,  
derën hapi edhe nga pragu

hodhi sytë e vërejti kohën;  
nëpër re në qiell yjet,  
si anijet në sulm dallgësh  
në një det shumë larg tokës,  
aty u duknin dhe u zhduknin.  
Dhe n'atë shesh gjithësie,  
që gëzohej në mes dritash  
ajo s'gjet një gjurmë shprese.<sup>2)</sup>  
E në mendje i përtërihet  
një kujtim i ëmblë i largët.<sup>3)</sup>  
Në një natë, posi sonte,  
një trim, që veç dashuria  
dimrit mund ta mbante jashtë,  
dil mbi kullë e shihte dhentë  
që zbardhonin ndënë hënë  
teksa era fshikte majat  
dhe pandehte se kjo botë<sup>4)</sup>  
përgjithmonë ashtu do t'ishte.  
Por ndërpret befas kujtimin  
dhe me pamje krejt të qetë  
kthehet brenda e të bijën  
duarnjomë, sapo veshur  
plot kujdes nga shërbestaret,  
merr përdore e me hyllnar  
tok me të hyn në një sallë,  
ku nuk kishte shkelur Dina,  
që mermer, ar, mëndafsh ndriti

si prej diellit ndaj agimit,  
plot erëndje e vezullime  
si kënd toke plot blerime.

Dhe shkëlqimi habit Dinën<sup>5)</sup>  
tok me gjithë ato pikzore.

*Dina:* — Ajo vathmargaritare  
dhe gërsheta lidhsabardhë  
cila është, o zonja mëmë?

*Dilina:* — Është e mjera ime motër,  
plagë e vatrës sime, o bijë!

*Dina:* — Në Delvinë pse nuk vjen?

*Dilina:* — Nuk vjen dot, se s'është e gja-  
llë. . .

Teksa e bija rrinte e heshtur  
edhe e ëma lehtë-lehtë  
shtëmëngte një vel të gjelbër  
prej një pikzorje të madhe,  
Dina prapë e pyet t'ëmën:

*Dina:* — E, po emrin si e ka?

Prapë e ëma s'iu përgjigj-  
dhe po ndizte një llambadhë  
të vendosur ndaj pikzores.

*Dina:* — Emrin si e ka, më thuaj!

*Dilina:* — Emri i saj ishte Mirana.<sup>6)</sup>

Tani eja e shih këtë!

Dina q'ende kishte sytë

po te pikzorja e parë,

që po i dukej si fantazmë

sapo drita zu largohej,  
tek pikzorja e dytë erdhi.  
Atje ngriti sytë e pa  
një si tempull dyerhapët,  
ku përpara altarit madh,  
mbi tryezë prej mermeri  
shtrihej një bujar trupmadh  
(me pekan të bardhë sipër,<sup>7</sup>)  
mbase hedhur prej të huajsh).  
Këmbët si prej një vigani  
që po flinte, sapo u duknin!..  
Lart altarit në qiellzanë,  
një si mëmë e shenjtë dukej,  
që mes resh të bardha ngrihej  
mbi duar fëmijësh ëngjëj;  
poshtë e jashtë trumbë grash,  
shqepzandryshme e veshjenjëjta,  
prej qytetesh të një gjaku,  
te sheshi para një dere,  
të gjitha me sy përlotur  
se kish rënë Atdheu i tyre!  
Dhe të gjitha po e shikonin  
plot besim si shpëtimtar  
një djalosh shumë të bukur,  
që u dukej se s'do prekej  
nga asnjë shigjetë armiku,  
edhe që u kishte mbetur  
posi një flamur lirie

qyshse humbi Prijsi i madh,  
që më nuk u kthehet prapë  
nga tryeza ku e shtrinë.

*Dilina:* — Bija ime, e njeh kush është  
ai trim? —

*Dina:* — Kush është?

*Dilina:* — Shihe!

*Dina:* — Zoti im atë.

*Dilina:* — Oh, bija ime,  
ku më sheh ti?

*Dina:* — Te tryeza.

*Dilina:* — Yt atë është ai te dera.

Te tryeza është një tjetër,  
është prijsi përmbi prijsa.

biri i madh i Voisavës,

lisi që, sa ra, na shembi.

Tek ai shesh përpara derës,

që ti po sheh në pikzore,

edhe unë isha, moj bijë.

Por në mes të gjithë turmës,

që me lot tim shoq nderonte,

qaja fshehtaz se më ndillej

dicka e keqe në zemër.

*Dina:* — E, po sonte përse bijen

kaq gërneta e bibizane,

sikur vashat të na prisnin

zbritje trimash fitimtarë?

*Dilina:* — Mbase zbret fryma e tim shoqi<sup>6)</sup>

që nga qielli posi dita  
dhe vërtet sjell lumturinë,  
ashtu si deshëm dhe duam!

Dhe me sytë shpresëndritur,  
shkoi përdore me të bijën  
drejt pikzoreve të tjera.

Në një mal të gjelbëruar,  
me kripin qelesheborë,  
shumë e largët dhe mënjanë  
dallohej një kambanore,  
sapo kthyer në gërmadhë  
e lart qielli i thellë, i kthjellët  
me një shqipe të vetmuar.  
Poshtë rrëzës, pa flamurë  
edhe plot me të plagosur,  
ishin dy aradhe ushtarësh  
të trishtuar dhe q'u zienin  
ende veshët nga të qara e  
ahe Kruje, (tani mbytur  
në gjak, eh, larg syve tyre!).  
Lart Vlladani e kont Urani,  
të dy prijsit ndën dy ahe  
maja gjethe e akuj bore,  
në një lug uji vështronin.

Mëma ngre në krahë Dinën  
dhe në lug vajza shikon  
një si fushëz me një lumë,  
që kish lule më dy anët

e mbi to një vërshim shqote  
përziante lulet e kuqe  
me të bardha e me të verdha,  
që mezi u bënin tufa  
ndën një diell mjaft të zbetë,  
teksa shqota, (s'di se nga)  
po vërshonte pa u ndalur.  
Mira nd' ujët përmbi gju,  
vrente prijsit e u tregonte  
me gjisht lulet edhe dukej  
sikur n'ajër po shënonte:  
«Sot pushton në zemra njerzit  
urrejtja për ç'ndodh në botë,  
për ata që gzojnë jetën!  
Urrejtja si shqotë e ftohtë,  
rreshton njerzit në aradhe  
edhe i ndan gjithnjë më shumë.  
Fjala «dashuri» ndër njerzit,<sup>9)</sup>  
u harrua e për çdo herë  
bie si bora edhe më e akullt.»  
Edhe Mira, bijë e ujit,  
rrinte e qetë, krejt gjakftohtë.  
E Dilinës po i bëhej  
sikur dy prijsit e kapnin  
për gërshetash edhe kokën  
ishin gati për t'ia prerë  
Mirës-vashë, që si motrë  
e përjetshme u fliste



dhe me sytë mbytur lot,  
dukej se të dyve u thoshte:  
«Zotrinj, mos e prishni vallen  
këto dit' që jemi bashkë,  
se kjo botë, që ngjan jona,  
më mburon në gji të saj,  
ku këdo njoh dhe më njeh.»

Dhe prijsit të përmalluar,  
ndalnin pa ia prerë kokën.

Edhe Mira tash i dukej  
sikur thoshte çdo të ndodhë  
me t'arbreshë edhe me Arbër.

*Dilina:* — Ndënë shqota, o bija ime,  
ne, pellazgët nisëm jetën,  
ne, q'ende lavdinë e lashtë,  
që të huajt gjithë e humbën,  
gjallë e kemi e s'do ta humbim.  
Ca nga ne sot, zemërplasur,  
ikin nga qytetet tona  
dhe në brigje t'Italisë  
në mëshirë të fat'qenit,  
copë e çikë ata na mbeten,  
se ky truall, plot të mira,  
q'ishte i tyre, u bë i huaj  
dhe mbi dhe s'kanë atdhe!  
Kokë në kokë do presin  
rreth një vatre si familje.  
E bujarët do t'i duan

gjithë skamsit e s'do t'i flakin,  
se të keqen tok përballën.  
Kështu, tok dhe të hareshëm  
mëmë-zonja kryelarta,  
vasha të pastra, si mëmat,  
këtu prapë arbreshët kthehen.  
Dhe këtu, në këto brigje  
sërish-kët' ajër do thithin.  
Sërish, pellazgët e lashtë,<sup>40)</sup>  
n' Arbër, ku na ndriste jeta  
lulembushur, jo shkëmbshkretë,  
gjirin plot me zogj të lumtur  
kundrejt detit të kulluar,  
n'atë tokë tul të gratshëm,  
që prej erërash mburohej,  
ne Atdheun do përtrijmë  
tok me besën e të parëve  
dhe si det prej brigjesh mbrojtur  
nga çdo shqotë do ngazllojmë!

Ra kambana e meshës madhe  
posi një hare e lashtë  
dhe Dilina, e nxituar,  
shkoi te një pikzore tjetër.

Sipër një lúmi të turbull  
shfrynte shqota, përçark varakat  
shkumëzonin edhe kallmet  
trup e kreshta shkundullinin,  
lisat degë fletëzverdhur,

grisur rrzhagash<sup>11)</sup> shkrepëtimash  
që nga retë gjer më tokë,  
zhurmëronin me rënkime.  
Ndënë vidha ushtarë u duknin  
dhe ndër shkulmet përmbi ujët  
shihej një kokë njeriu,  
me kurm zhytur si në gufër  
brenda atij lumit të gjerë.  
Shiu i qiellit, tok me njerëz,  
naks i dheut, shkrepëtim,<sup>12)</sup>  
shqotë e egër, ishin lidhur  
që ta mposhtnin rrezikzinë!  
Ai, zemërshtëmb kalonte,  
kokëllart por pa hare,  
si një anije e magjepsur  
përmbi valët me tërbim,  
si një shqipe që shkund pendët  
prej dëborës, lart në qiell  
dhe ndën vete shikon brigjet.  
Pa droje e me jetë t'hajthme  
që shkrepëtim e thëthin lehtë,  
përball dallgët që e thëthinin,  
dhe valvit përmbi të gjithë,  
një qetsi që të mahnit,  
si qetsia e pikzores  
së atij lisit degëgrisur  
nga rrufe, breshër e shqotë!  
Si dashnore shumë e fshehur,

rri mbi mjegullën e malit  
një qytet i shkretëtuar,  
psherëtimë e shtrenjtë e tij,  
me dërrasa ndënë breshër  
dhe me shkallët faqeskuqur.  
Por gjë s'ndjeu qyteti më,  
si nuk ndiente edhe përpara,  
ndër net vere hënëzuar  
thirrma foshnjesh buzëqumësht,  
që në djepe na i tundnin  
nuse-vasha fatmiroshe.

Re në grumbuj-grumbuj duken  
larg në qiell e mbi qytetin,  
si dallgë të fryra detit,  
që vështrimin na mbulojnë  
pastaj shkojnë e gjë nuk shohim.

*Dina:* — Po ai trim mbaroi në det?

*Dilina:* — Ai trim të gjithë i mundi!

Sërish pa diellin që shkrep  
përmbi ujra e i iu shfaq përpara  
gazi i jetës pa kufi.

Dhe të dielën në kuvendin  
e bujarëve shpirtdrojtur,  
shkoi me ballin rrezetor,  
dhe tek po i puthnin dorën,  
pleqtë i ul në frone e u thotë:  
«Shumë e kanë atdhenë e tyre  
kaq të shtrenjtë e sa u zhduket

prej anijeve i thonë:  
«Lamtumirë, o vend ku linda!»  
S'është turp, në e le të lumtur,  
se hije e forcës s'atdheut  
kudo shkon ti, nuk të ndahet.  
Por ju sot mos u çuditni  
që më shihni se po kthehem  
në qytetin tim gërmadhë,  
se asnjë prej jush s'i le  
këto brigje t'Arbrit tonë  
për ar, lavde ndër të huaj.  
Unë, delvinjot i lindur,  
nuk i ndahem shortit tonë  
me gjak shokësh më të mirë  
të vaditur pa kursyer,  
kurrë, edhe po të më japin  
si dhuratë gjithë botën!»  
Kështu tha Vlladani, yt atë,  
dhe nga thirrja e zhurma e madhe  
në shesh zbriste krejt qyteti  
dhe rreth tij qanin të gjithë.

Dhe Dilina shumë e zbetë  
u qas dhe përmbi altar  
vren një pikzore të madhe,  
që iu duk se në syonat<sup>13)</sup>  
ngjyrat era i kishte tretur.  
Lart, i vetëm, brigjeve,  
pa pengore hingëllinte

veshëngritur një dori  
thundrafundosur në bar.  
Përmbi të pllakoste nata  
dhe prej saj një kukuvajkë,  
ndjellëkeqe e botës, dilte  
e të gjithve u zbehte gazin.  
Kukuvajka vinte t'ulej  
mbi një bosk me shkultën lart<sup>14</sup>)  
dhe që kish në mes të gdhendur  
një pallat, seli bujarësh.  
Po ai zjarr që dhe përpara  
ngrohte sa shkuan e vanë,  
vatrën nxehte e ndriste dhomën.  
Pranë, e përgjumur në fron,  
rri Dilina e fundosur  
si në qetësinë e madhe  
të një varri ndënë tokë,  
ku nuk ndihet asgjë më.  
Por ja, dada plakë derën  
ia hap trimit, që me zërin  
ushtë drite drejt në zemër  
e shkund, dhe zbardhur prej gjumit,  
skuqur prej ëndjes m'i thotë:  
*Dilina*: — M'erdhe trim edhe një herë  
më në fund në varkën time,  
te ky det që do kalojmë  
dhe ne të dy përgjithmonë,  
të pakën, si më premtove,

më gëzon një çast të vetëm.

Dhe Vlladani i përgjigjej:

*Vlladani:* — Ti në dhomat që çdo verë  
do pastrohen merimagash<sup>15)</sup>

dhe në vend tim qëndron zonjë,

kurse unë sa të dal

që këndeje, kthehem në varr!

Dhe Dilina q'i besonte

në çdo fjalë, brof më këmbë

flokëshpleksur e lokrua.

Por për të s'ndjeu dhembje trimi,

si për trimin s'ndjeu dheu.

*Vlladani:* — Nesër, kur të jemi bashkë,

mund të puthemi e te dera

gdhendim katër gërmat tona.

Ah, po t'ish se dashuria

do më ngopte me sy vetëm!

Por dhe kjo sot s'është e mundur,

mua helmi po më mbyt,

se pardje m'u vranë shokët

dhe nga deshën brodhnë armiqtë.

Vetë u ndala mbanë lumit

ku m'erdh gjumi e më pushtoi

pa ma lehtësuar brengën,

se djema turq, që njihja, pashë,

të mëdhenj e të pabesë,

edhe ty, të re e vashë,

(flakë e ditëve të mia),

tok me ta hypur në kalë,  
tek po nisheshit që t'iknit  
brigjesh për një vend të huaj.  
Me ca fjalë ata edhe lotët  
shpejt nga sytë ty t'i terën,  
kur ende nuk t'ishte terur  
skemandili që më tunde  
kur më thoshje «lamtumirë!»  
Retë e zeza pas ju ndiqnin  
dhe si në krahë të gjumit  
unë lumit iu lëshova  
dhë ne humbëm njëri-tjetrin!  
Zonja boskun e vërente  
dhe në gji iu përtërit  
çasti kur e patën gdhendur.  
*Dilina:* — Uh, përmbi mua të shkretën,  
ndje, o vdekje, hijen tënde!  
*Dina:* — Mos më qaj, o zonja mëmë,  
sepse unë këtu trembem!  
E ëma e puthi e i thirri Lenës,  
që për meshë ta stoliste.

## II

Dhe me Lenën fliste vajza:

*Dina:* — Sa vjet shkuan qëkur linda?

*Lena:* — Njëmbëdhjetë.



*Dina:* — — Më përpara  
ku kam qenë?

*Lena:* — Ti s'je foshnjë e  
kupton vetë, s'kishe lindur.

*Dina:* — Po kur linda këtu ishe?

*Lena:* — Këtu isha, dhe te jot ëmë<sup>1)</sup>  
isha para se të lindte.

Dhe kur isha fare e re  
isha në shtëpinë time.

Po tani vazhdojmë fjalën  
atje ku e lamë, o vajzë.

N'agim mbrij në Moroyll.<sup>2)</sup>

Malet bëheshin të kaltër,  
një veri tundte shpërvjerrset  
me qindizma lloje-lloje  
të nuseve t'arbëreshe.

Më del para lumi i kaltër  
dhe gjatë e gjerë kënetë,  
që nuk mundja ta kaloja.

Sa dal te dera e shpërvjerrses  
më pa prijsi e shpejt stolisi  
murgjarin të bardhë borë.

Fati i shkretë i atij djali  
dhe i murgjarit t'atij djali!

Psherëtiu, e fshiu lotët  
dhe më plaka s'desh të fliste.

*Dina:* — E pastaj? Fol! Ç'bën trille?<sup>3)</sup>

*Lena:* — Ti nuk di ç'zjarr ishte ai...

M'ul në fron në mes bujarësh  
dhe më thotë: «Dhelpër mali,  
sa fërghesa na ke sjellë?»

«Aq sa mund të pjekë dielli,  
pjek dhe dora e zonjës sime.

Ti asaj besën s'ia shkele,  
edhe ajo të adhuron.

Ajo sonte lindi vajzë,  
që i shënoi shorti dorën  
e më të hieshmit djalë  
që e bën krenare një mëmë.»

Ra kambana e meshës tretë  
edhe del zonja Dilinë.

*Dilina:* — Ndiz, o Dinë, pak llambadhën,  
edhe shkojmë, se kjo dadë,  
kur nis fjalët i përngjan  
krejt një mokre të mullirit.

Kështu tha, por e kënaqur  
për gjithë ato që dëgjoji  
dhe krenare për të shoqin,  
kaloi derën, posi hëna  
kur del malit e ndrit vendin,  
shkallët zbret edhe mban cohën.<sup>4)</sup>

Shpati i ullinjve fletëprirur  
ndaj veriut, majakredhur  
ajrit kaltër, t'hijeshuar  
nga skyfiterë edhe pëllumba,  
ngjante i veshur me hare,

Ashtu ngjante edhe Dilina  
tek po zbriste krejt e kredhur  
në kujtime të një kohe  
që në gji i përtërihej  
si më e bukura e dheut;  
por rrëshqiti dhe ra më ije  
mbi një gur. Dhe thirri: «Vdiqa!»  
Dina shpejt me turr e kap  
për një krahu e s'e ngre dot!  
I kap kryet, i mbet veli,  
faqja e djathtë i puthte trollin,  
syri majtë i hapej turbull,  
flokët, fitilë rreth kejzes!

*Dina*: — Zonja mëmë! Mëmë, folmë!  
Ububu, mëma më vdiq!  
Kushërinjtë, që jashtë i prisnin,  
edhe gratë u hodhë, e ngritën,  
në mes të dhomës e shtrinë.  
Dhe Dilina e ftohtë dukej  
aqë larg nga jeta e toka,  
sa ç'është edhe vetë toka  
që nga dita që u pat ngjizur.

---

KËNGA E TRETË  
DINA ZËNËBISHA

*Delvinë, Janinë (burg), 1497-8*

Një puhi e lehtë, e ngrohtë  
gjithë qiellin mugëlloi  
të dielën e luleve.  
Pastaj rrezja ar e diellit  
rrallë e për pak zbardhëllonte  
nëpër rrugët e Delvinës.  
Dhe larg deti i zbërdhujtur  
plogët pa suvala shtriqej.  
E njerëndje manushaqesh  
përhapej udhëvet kroit  
edhe njerzit në kurm ndienin  
një si vlagë, s'di nga se,  
mbase nga buisja e verës,  
apo nga një zgjim i ri  
i kujtimeve-dëshira.

Atë ditë në Delvinë  
nuk dëgjoheshin fyufyake<sup>1)</sup>  
dhe s'kish lule për në kisha,  
as dafina për altarin  
se nuk kish as në atë vit  
as dhëndurë, as edhe nuse.  
Veç këmbana e kishës madhe  
lart, larg brengëve të dheut  
duaj t'i sill gaz qytetit,  
që sa qe gjallë Skënderi  
ish plot vashëza velbardha  
e plot djem mëmash të bukur  
nëpër lodra e në kuvende.  
Vetëm katër bijtë e pashës,  
sapo t'ardhur nga Janina,  
mbi katër kuaj të brimtë  
vinin kusht në rendje kuajsh  
në gjithë udhët e Delvinës,  
si sheshesh të s'emave.<sup>2)</sup>  
Në shtëpitë dyermbyllur  
me syonat ngrysur gratë  
rrinin fronesh, ashtu si rrinte  
mbi pullaze i ngrysur dielli.

Por vashza mitare Dina,  
(me pallate që hijesonin  
në Delvinë e buzë detit,  
me anije, prozhme e pyje,  
që nga prindët ende kishte),

na u gdhi e ngazëlluar.  
Dhe ajo pallatin brenda,  
(që tani e njih për zonjë),  
po ma ndriste anëmbanë,  
(pas një zie katër vjeçe,  
që na kish mbajtur për të ëmën),  
si një yll, që e zgjuan era  
sa nis fryn në mugëtirë  
dhe kur retë nuk e presin,  
era i fshin dhe duket ylli.  
Në fron Dina faqemollë  
në të kuqe e t'arta veshur,  
trupbëshme, e lulëzuar,  
(krejt si dëshironin prindët),  
tek m'i lidhte plaka Lenë  
me një jetullëz të bardhë  
gërshetat atij mëngjesi  
në vetvete thellë ndiente  
se diçka të madhe priste!...  
Dhe duke soditur jashtë  
dëgjonte Lenën që fliste,  
porse mendja i bredhërinte.  
Dhe pastaj ngarlat gërshetat<sup>3)</sup>  
derdhur n'ar, edhe nga froni  
ngrihet dhe del te dritsorja.

## II

Shoh të vjerra degzash kokrrat  
t'hajthme e në mëshirë t'erës,  
dhe njeriun, zot të tokës,  
që sa më lart ngre shtëpinë,  
aq më shpejt ia shemb lëkundja.  
Kështu vashës më të bukur  
aq më shpejt na i vjen e keqja.

Te rrugica ndën dritsores,  
ku nuk dukej asnjëri,  
m'i madh i djemve Pashait,  
kur askush s'e priste hyn  
posi zot dhe i bie me shpor  
kalit trokëllimëgjatë.  
Si një ninull i përkundur  
përmbi kalin fluturor  
sa pa fytyrën e saj,  
ai afrohej. E vasha e urtë  
me një vështrim pa të keq  
dhe plot hir e mirësi,  
ia rrëmben zemrën dhe kali  
sa ndien veten si pa fre  
rend me shpejt dhe djali i Pashës,  
krejt i mahnitur pas vashës,  
befas bie shakull përdhe.  
Dhe, padashur, vasha klithi  
por mbledh veten dhe e penduar

shpejt hyn brenda duke thënë:  
«Mbase nuk e vuri re!  
S'di si m'iku vetvetiu!»  
Po dhe brenda ajo fytyrë  
nuk i largohej nga mendtë  
dhe iu drithtërua kurmi!

Vrap zhvesh cohën dhe pështjerit<sup>1)</sup>  
iu vu si në ditë pune  
dhe kur zbriti nata i iku  
dhe nga mendja ajo fytyrë;  
kur u gdhi krejt i venitet  
si një re që krejt po tretet.  
Dhe puhitë e valëve,  
freskësitë e fletëve,  
rrjedhat e lumenjëve  
me këngët e shpendëve  
që të gjithë njerëzve  
u përtrijnë tokënë,  
që t'harrojnë brengëtë.

### III

Më të gdhirë dita e enjte,  
pa shami, gërsheta mpleksur,  
Dina e bukur zbret me shoqet  
që të spastrojë lirishten.<sup>1)</sup>  
Po kur erdhën shërbestaret



me kufa plot bukë gruri<sup>2)</sup>  
na i thanë që e kërkonin  
në shtëpi. Dina, cilonën  
e përveshur, sërish zbriti,  
vu në krye shqepnë e vjerrur  
në një degëzë qershie  
edhe shkoi të ndriste dhomat,  
siç i ndritin edhe lulet.

Sa në sallë hyri shqoi  
Dorën e Gjinlekajve<sup>3)</sup>  
edhe Verën e Toçenjve,  
e një t'huajë kurmlartë,  
n'ar mbështjellur, faqendezur,  
që në ças balli i shkënditi:  
*E huaja:* — Ti, moj vashë bukuroshe,  
bijë e prindëve raje,  
sa të mira ka xheneti  
hem i duam, hem s'i duam  
që t'i kemi në saraje.  
Edhe ftesën për gjerdek  
të një trimi bukurosh  
hem e duam, hem s'e duam.  
Toka gjithë është bahçja jonë,  
ç'egërsira ka ndër pyjet,  
ç'të sheh syri zog në qiell,  
ashtu siç i sheh ndër ëndrra,  
na i sjell dita në saraje.  
Por im bir, për ty më digjet

dhe më soset si qiriri  
që jep dritë e loset n'ajër.  
Që të jesh gjithmonë diell  
unë s'dua që të ndrrosh  
as besimnë e prindve tu  
ndaj, edhe si nusja ime,  
prej pallatit, mund të dalësh  
dhe të zbresësh me allajka  
dhe në kishë e me rajeshat  
mund të përzjehesh të dielat.  
Asgjë ty s'do të mungojë!  
*Dina:* — Dhe kështu, gjë s'më **mungon**.  
Është zonjë edhe e mirë  
kush gëzon nder qëkur lind.  
Kujt s'gëzon nder, s'mund t'ia japë  
askush këtë dhe n'i faltë  
krejt qytetet edhe pronjat.  
Dhe pse mëma më la befas  
e nuk mundi të ma thoshte,  
unë e di ç'hije ka nderi;  
gjithë e dinë se im atë,  
që më vdiq për vendin tonë,  
nuk më la që të shkoj nuse  
tek një shtypës i Delvinës!  
*E huaja:* — Re s'e vure, moj e **shkretë**,  
që nuk doja ç'të kërkova! . . .<sup>4)</sup>  
Kështu shfryn fytyrëprishur  
dhe ngërqesh me aq kanosje

tek po sulej për nga dera,  
sa ment vashës edhe zemra  
në kufar i llaftarisi.

Shpejt, shpejt n'emër të Sulltanit  
krejt pronjat e vashës Dinë  
shiten tok me pela e lopë  
dhe me manat fletëdrudhe  
në kohën kur nisnin pubzat<sup>5)</sup>  
dhe një lot nuk i shpëtoi.  
Dhe ndaj peshkopit Janinës,  
që i përloti flokët ar,  
Dina gur qëndroi krenare,  
bijë çlirimtarësh t'Arbrit  
dhe një lot nuk i shpëtoi.  
Por kur pleqtë e Delvinës,  
pasi erdhën ta shikonin  
dhe në shenjë lamtumire,  
mbase për të fundit herë,  
nisën ta puthnin me radhë  
si bijën e prijsit tyre,  
më s'duroi e i plasi vaji.

Atë ditë krejt e vetme  
mbet mbi shtrat dhe sytë e saj  
si nëpër tym e shikonin  
kundrejt malin plot burbuqe,  
fletët si prej shiut lagur,  
liqenin si re të kaltër,  
shtëpitë shkrepnë në mbytyje.<sup>6)</sup>

#### IV

Mbyllur ndën pullaz të hua;  
pa një shpresë që të kthehej  
tek ish zonjë, në helm tretej.

Çdo ag kallkan, kur veriu  
mbi të mbjellat fshikullonte  
dhe kur gjerat flenë vrimash,  
vashat-murga e Dina u ngrinin  
dhe q'askush të mos i shihte,  
në kafaz të kishës hynin  
nga një derë afër pullazit.

Por q'atje, pas pllakash qelqi  
të tejdukshëm, hapësira  
mjaft e gjerë e qielli i kaltër  
ku vozitnin kashtra e tufa  
kallmesh shkoqur prej përrenjve,  
u rrëmbenin sytë e njomur  
edhe zemra nuk u ngopej  
prej erëndjes që m'u vinte  
nga ai kopshtë i madh i botës,  
aqë larg nga ai burg i errët  
ku jetonin, sa që thoshnin  
«Si ndodh vallë që një zot<sup>1</sup>)  
na paska si këtë burg  
dhe atë kopshtë aq të madh?»

Por prap vashat-murga **shihnin**  
poshtë n'atë burg të hynin

njerëz të tretur, që i mbyllnin  
derën së jashtmes plot ajër.  
Hynin krejt të shqetësuar  
prej andrallës aq të madhe  
që dërrmonte njerzit jashtë  
edhe n'ankth para laltarit,  
n'heshtje ata dëgjonin priftin.  
Edhe tek altari u dukej  
sikur ngjiteshin si hije  
njerëz që s'janë më gjallë  
por që flisnin dhe një gjuhë  
të largët, që më s'kuptohej,  
porse balli i tyre ndriste  
plot me hir dhe rrezatonte  
një shkëlqim që ndër shtëpitë  
e këtij dheu më s'duket.  
Dhe çdo ballë sikur thoshte:  
«Përmbi tokë e kanë vidat  
gazë e jetës dhe njeriu  
ndrron mbi tokë e gjen ngazllimin.»  
Edhe kjo është e vërtetë  
andaj dhe njeriu i shkretë  
lidhet me grua, fëmijë  
dhe kur larg i vetëm ndodhet  
ndien në dliresi të tyre,  
si, me gjumë e ecejakë  
me ujë e bukë të dheut,  
ngazllon grua dhe fëmijë,

posi lulet që çdo ditë,  
i ngazllon qielli e hëna,  
kur dhe natës del hedh dritën  
dhe në praqe dritësoresh  
na i bën të shtriqen macet.  
Po ashtu dhe vashat-murga  
hajné e pijnë e vijnë e shkojnë,  
dhe pastaj asgjë s'do lënë  
pas vetvetes kur të zhduken!

Porse Dinës, që nuk solli  
te ky burg një shpirt të lodhur,  
(sepse nga pallati s'doli  
as kur çonin me vajtime  
arkivole me të vdekur,  
as kur me këngë e me valle  
vasha nuse po përcillnin)  
tani brenda këtij burgu,  
një mejtim i vagëlluar,  
prej trurit të saj' i çohëj,  
edhe i tretej hapësirës  
e të shkretë ia linte shpirtin.

Pranë odës së Dinës ishte  
vasha Nushë e Cërikut?)  
buzëmjahtë e flokgështenjë.  
Pamja e pastër, e mejtuar,  
llërët, beli e çdo gjymtyrë,  
bukur derdhur, këdo e bënin

të zilepste trimnë e lumtur  
q'atë vashë do ta puthte.

Edhe ajo e kish dritësoren  
posi Dina nga veriu,  
lart, përballë dheut murrinë.  
Në një kohë në to dilnin,  
por, të dyja kryelarta  
për mjaft ditë me radhë asnjërës  
nuk iu dha që t'i flit tjetrës;  
por të dyja i vërtitnin  
sytë në të njëjtat anë  
dhe kur njëra hynte brenda  
edhe tjetra mbyllte perden,  
sikur më nuk donte asgjë.

Miqësi, flakë e pashuar,  
ashtu si dhe drita e ditës,  
ti m'i jep hir vetë jetës  
dhe nga guri më nxjerr ujë!...  
Dhe dy vashat që kundruall,  
si ta njihnin njëra-tjetrën  
qëkur pati lindur dheu,  
lidhen shpejt dhe në çdo fjalë  
që sapo shkoqej nga goja,  
ato vinin gjithë besën  
dhe prej saj merrnin aq ëndje,  
sa marrin prej çdo puhie  
zogjtë gjatë fluturimesh  
lart në qiell përmbi dhe.

Por atë dimër çdo ditë  
derdhej që nga retë shiu  
dhe te kopshti kthyer brrakë  
kurrë nuk na zbritën bashkë.  
Disa mbrëmje nga veriu  
dlirej qielli e psherëtima  
po te brraka e zemrës tyre  
na i mblidhte që të dyja.  
Po kur gdhihej prapë i shihte  
rrezja e diellit po të zbeta  
në fytyra, siç ish vetë  
dhe si shpuza ndënë hi,  
miqësia i digjte vashat.  
Kështu zgjati gjer në pashkët,  
kur retë ikën e ato dolën  
pas mesditës edhe panë  
hired, nuret e shoi-shoqes  
dhe të dyja u përjoshën  
plotësisht, edhe u ulën  
përmbi vjollcat q'ishin terur  
pranë e pranë në një hije.  
Kështu gjithë vera e kthjellët,  
si një ditë agimzgjatur  
gaze t'atilla u solli  
si rrallherë ndodh mbi dhe.

Posi dy zonjza fatmira  
në hije, krye më krye,  
për çdo ditë u lumturonin



me qindizma e kuvendime.  
Dhe të nesërmen s'kujtonin  
veçse nanurisje ëndjesh,  
këngë zogjsh e tinguj fyejsh  
te çdo fjalë e shoqja-shoqes.  
Dhe te shkrepni sipër kopshtit  
sytë e tyre i qetonin  
dhe nuk kish se kush t'u thoshte  
se në botë ende kish vasha  
që i stoliste dashuria,  
apo që ishin nuse-zonja  
tejembanë një shtëpie.

E nderonin njëra-tjetrën,  
ishin yll për shoqja-shoqen  
përmbi gjithë vasha e murga,  
përmbi gjithë sa mësonin,  
përmbi vetë gjithësinë,  
që nuk dij t'ua lidhte sytë.  
Dhe në stinën e qershive  
nëpër degë e fletë pemësh  
ngjiteshin dhe fshiheshin  
aqë lehtë e guximtare,  
jo si vasha, po si vida.  
Njëra bënte anak për shoqen  
tjetra vathë për të parën  
e plot mall na u stolisnin  
brenda asaj foleje fletësh.  
Dhe sapo ndienin kambanën,

shenjën se kish ardhur ora  
për t'u mbyllur në flanikthe,  
me trishtim ato na zbrisnin  
dhe u ngjitnin n'odat burgje  
larg shoi-shoqes e më kot  
ftonin gjumin që t'u vinte  
n'errësirë përmbi sytë  
gjithë dritë e përmbi faqet,  
ku të kuqtë e saj kish lënë  
dita plot qershi e mollë,  
edhe ndënë gjinjtë e fryrë,  
ëmbël zemra atyre u rrihte.  
Dhe pas mizash, që mes vapës  
zëzëllitnin e u përpiqnin  
që të dilnin nëpër kricat,  
prej nga u vinte drita e ditës,  
vashavet u fluturonte  
mendja jashtë, ku edhe fletët  
s'pipëtinin dhe nuk ndihej  
asnië zë njeriu e vetëm  
dielli plogët po kalonte,  
edhe hijet, pa u ndier,  
prapa murit po u ngjitnin.  
Dhe dy vashavet u dukej  
se po u sosej, tok me ditën,  
një visar, dhe helmi i mbyste.  
Edhe flokët, prerë rrotull,  
tek po u rriteshin si djemve,

u djersiteshin në tëmthat,  
ndër ato pasqyra jete.

Por, hej, vinte çasti e u hapnin  
po me ditë dritësoret  
e ato dilnin dhe së toku  
te liqeni i heshtmë, i gjerë,  
zyntërisht i kaltëruar,  
buzëqeshmë, kuvendonin.

Po të pakripet murgesha,  
nakarzeza, se askush  
kur na kishin qenë vasha  
nuk u ishte qasur kurrë  
me një ndjenjë dashurie,  
këtë dashuri prej motrash,  
në mes Dinës edhe Nushës,  
nisën që ta përgojnin  
edhe pasi u rrinin larg,  
murgasorravet u dukej  
se dy vashat mëkatonin  
si gra të përdala rrugësh!  
Te kjo tokë e çuditshme  
dhe një degëz mund t'ia errë  
dritën e përjetme diellit!  
Por dy vashat, si dy yje  
që re s'vënë ç'dërdëllitet,  
pranë njëra-tjetrës ndritnin.

Ato dhe zotin harruan.<sup>1)</sup>  
 Rrallë e tek ndonjë të dielë,  
 si na u çonin nga tryezat  
 shtruar mbulesa të bardha,  
 ku ç'kërkonte jeta e kishin  
 dhe tek hekurea shkonin  
 të gëzuara të dyja,  
 vetëm atëherë Dinës  
 që nga balli i fluturonte  
 s'di se çfarë qiellit qetë  
 dhe ia linte më të dhembshëm.  
 Pa nga hekurea shihnin<sup>2)</sup>  
 si na bëheshin lëmoshat  
 nga pasuria që patën  
 këto vasha, sot murgesha.  
 Plaka, llosha të rrëgjuar,  
 të verbuar dhe të marrë,  
 të pandihmë njerëzie,  
 vinin, si t'ishte një krua  
 që këtu hapej për ta.  
 Edhe Dina, bijë prijsi,  
 shihte cunga e të plagosur  
 dhe rrallherë i thoshte shoqes:  
 «Mbase me prijës tim atë  
 dhe këta mbetën të gjymtë!»  
 Po shpejt një mejtim i largët

buzës drejtë ia prit fjalën,  
sepse e dinte që mes tyre  
ajo kishte më pak pjesë,  
(se më pak ishte e zotit).

Dhe pa lot s'ndahej, e mjera.

Edhe pak nga pak me dimrin,  
q'erdhi prapë, edhe një hije  
zymtëroshe ra mbi vashat.

Mbaroi dimri, që qull dheun,  
toka mbushej lule e grurë.

Në dritoret ndaj veriut  
vashat dolën dhe soditnin  
përkundruall një pallat  
plot me drita e muzikë;  
vallja dridhej edhe hapej  
e përpara ajo shkonte,  
si shkon dita qiellkthjellët  
mbrëmjes majës së Tomorit.<sup>3)</sup>

Në mes valles si një diell  
ndriste nusja e praruar:

*Nusha:* — Atje lidhen nuse e dhëndër,<sup>4)</sup>

por jo me zemrat si flakët  
e një hyllnari të vetëm,

por me një kurorë «paqje»,  
gati si mes dy armiqësh.

Dhe kur në frone do ndodhen

pranë vatrës e ajo do t'ulet

të shkrepë urat, sytë e dhëndrit

nga çdo anë do mbikqyrin  
 si shtëpinë ashtu edhe nusen.  
*Dina:* — Po në një pallat të atillë,  
 n'ëndërr dje isha edhe vetë;  
 mbi mermere shkelja e ndieja  
 afshin e shtëpisë sime!  
 Si një zonjë te dritsorja,  
 era posi vel ma frynte  
 mbi zverk shqepzën dhe gërshetat  
 përçark veshve m'i shakmizte.<sup>5)</sup>  
 Shqepza m'ik mezit shtëpisë,  
 tri herë u ndejta ta kapja  
 por si pendë ajo vërtitej  
 pastaj hapej dhe të ra  
 ty më gjunjët. E ti e kape  
 dhe duke qeshur, sërishmi,  
 pasi më ndreqe gërshetat,  
 prap ma lidhe atë në kokë.  
 Dhe te kjo botë e pabesë,  
 vetë qeshë aqë e kënaqur  
 se ty prap të kisha pranë!  
*Nusha:* — N'ëndërr dhe mua shtëpia  
 m'u shfaq dhe n'odë tek flinte,  
 zoti tatë; e dritë s'kishte  
 as në dhomën aty afër.  
 Shërbestaret ishin jashtë.  
 N'atë dhomë ishim të dyja  
 dhe tek fundi i shtratit rrinim,

e mbështetur unë qaja  
dhe ti prerazi më thoje:  
«Unë s'tundem nga sa thamë!  
Një bujar më kërkon nuse  
edhe vetë do të shkoj,  
sepse ne të dyja lindëm  
në shtëpi që s'janë fis.  
Zoti yt atë ne na ndau  
dhe ka javë që humba shpresën  
se s'do kthehet koha e parë.  
«Por unë me kë të rri  
dhe kë të dua pas teje?  
Se qëlloi fati keq  
që shtëpitë fis s'i kemi,  
ti zemërgure më shkon?»  
«Do të shkoj, po s'më premtove.»  
«Çfarë?» E aherë zoti tatë  
hapi derën dhe më pa  
tek me sy më tretje shpirtin,  
mua, visarit të tij. . .»

Dina qeshi e vrejti prapa,  
ku me veshët ngritur rrinte  
në përgjim kryeklllogjresha  
*Kryeklllogjresha:* — Bijë, çfarë faj i madh  
të largoi nga gjiri i zotit?

## VI

Sapo u gdhi Nushën e nxorën  
nga qelia ku ishte; e çuan  
në një tjetër nga ana e jugës.  
Pranë shtratit, sipër fronit,  
i bleronte më një kënd  
coha e sjellur prej shtëpie.  
Dhe mejtimet për shtëpinë  
edhe për fatin e saj,  
posi retë iu grumbulluan  
dhe me lot ia mbytën gjirin.  
Por as dhembja e Dinës s'matet:  
mbyllur brenda gjithë ditën  
e kapluar krejt nga brenga,  
ndihej gati si kënetë  
ku na zhytej hëna e re,  
pastaj mali plot me mjegull,  
pastaj kumbulla e rrahur  
nga murlani e pështjellimthi  
fytyrim pas fytyrimi.

Në tryezë e para altarit  
Nusha më nuk e pa Dinën.  
Ditët gdhinin dhe u ngrysnin  
po njësoj e vasha ndiente  
se gjithnjë aq shumë i zbehej  
koha e kaluar me shoqen,  
sa tha «Po kthehem kufomë,



se asgjë nuk po kam timen,  
porsi lulet, pres të thahem!»  
Për pak mbrëmje ndenj te fronti  
përmbi kopshtë, ashtu siç rri  
ditësh shqotash edhe resh,  
krejt i ngrysur, duarlidhur,  
kundrejt dallgësh buzë detit  
i përzëni ndër të huaj.4)  
Ajo shihte kundrejt hënën  
q'ikte, vend t'i bënte ditës...  
Dushqet fërshëllinin n'erë  
plot me jetë e n'errësirë  
fletët rriteshin plot hire  
edhe botën zbukuronin...

## VII

Dhe ja, ndodhi ashtu siç donte:  
era që po frynte jashtë  
dhe suvalte lulekuqet.  
një të dielë e zgjon, dhe Nusha  
sapo zbriti, sheh në kishë  
Dinën e saj tek kungohej!  
Në ças ç'ndjeu brenda e ndrydhi  
ndënë sytë si të qetë  
dhe syonën plot me hire  
e më lehtë e ndjeu veten.  
S'vonoi shumë e Dina kthehet.

(Ish e zbetë edhe e hajthme,  
si trëndafil më të shkoqur).

E rrethuar, ndënë vrejten  
e të bushtrave kllogjresha,<sup>1)</sup>  
ku qe Nusha ajo afrohet  
dhe i thotë: «Si më je?  
Për së gjalli ne na ndanë!»  
Pa mbaruar fjalët, Nushës,  
posi flakë n'erë, lotët  
i shpërthejnë pa ndalesë.  
Dina shpejt dhe si mermeri  
ndahet, shkon në vend të saj.

Dhe q'ahere gjumëqetë  
bëhet Nusha edhe zgjohet  
me besimin që na zgjohet  
neve nga veriu i verës  
për t'ia ftohur ujrat tokës.  
Dhe me shoqet ajo ulej,  
radhëtarisht kuvendonte,<sup>2)</sup>  
se për një kohë të gjatë  
i qe përtëritur shpresa.

Edhe për rrushajet priste  
që të ndodhte ashtu siç donte:  
duardredhur u vesh bukur  
afër orës që n'oborr  
murga e vasha u grumbullonin.  
Arat ku qe pjekur gruri  
n'ato ditë po valzonin,

qartësia zbuste botën  
gjersa dielli mesit qiellit  
ndenji i vetëm u qetua  
dhe ngjyra lulesh kudo  
me erëndjet ajrin mbushën.  
Atëherë zbriti Nusha,  
në krejt shoqet më e fundit  
dhe shpejt në kishë kërkoi,  
por gjëkund Dina nuk ishte!  
E, sikur dikush t'i thoshte  
«ti këtu nuk ke ç'bën më»,  
me ngut doli nëpër grumbull  
jashtë kishës, por, papritur,  
sapo e puthi n'oborr dielli,  
kotullohet edhe i duket  
se një shi lulesh i zbrazet  
që nga lart. E ngriti kokën  
te dritsorja, në mes vashash  
jomurgesha, shqoi Dinën,  
(që e dinte të sëmurë),  
tek i buzëqeshte ëmbël  
dhe me duart posi bora  
me shi lulesh e mbulonte,  
qëndrimqetë, por e mundur,  
sy pa lot, por dhe të kthjellët,  
posi qielli me pak re,  
që iu duk se po i thoshte

«qofsh e lumtur, dhe pa mua!»  
Dhe largohej e përcjellur  
nga vështrimi gozhdë i Nushës,  
si vështrimi i të sëmurit,  
që nuk shqitet dot nga bota.  
Por pas pak Nusha mbledh veten  
dhe me gaz na shkon ndër shoqet,  
ajo buzë-tinguj-ëmbël.

Nuk shkoi shumë edhe nga shoqet  
na mëson papritur Nusha,  
se prap' Dina zuri shtratin;  
në ças iu fik drita e ballit,  
porse fjala ftohtë i doli.

Dhe sërishmi posi hëna,  
kur humbet në mbrëmje dritën,  
për çdo ditë nga trishtimi  
nis të bëhet dhe më e zbetë.  
Për çdo natë të asaj vere  
yjendezur në pasosje,  
me veri që fërshëllinte  
dhe në veshë bishësh pyjesh,  
nuk i ndahej me mend shoqes;  
për krejt të sëmuret lutej  
por më kot i shkonin lutjet,  
tretur n'erë, ku gjë s'njohu!<sup>3)</sup>

## VIII

Dina, vashë e lirë e lindur,  
flakur në burg nga të huajt,  
digjej n'ethe, pa pikë uji,  
pa njeri t'i gjendej pranë,  
me të shkretët sy të lodhur  
së shikuari në drrasa,  
në kllapi e rënë endej  
gjithë e veshur në të kuqe,  
nëpër malet shpatethikë  
thërrmohej si flok dëbore  
dhe përmes maleve binte  
në një lumë-det e tretej.  
Por ai s'ishte as lumë-det,  
po na ishte vend i huaj,  
ku na i dukej se përshkundej  
nëpër fusha mjaft të gjera,  
që përskuqnin fierthata,  
kundrejt: kodra verdhacuke,  
lart: një qiell si shumë i ngrirët,  
ku i dukej sikur ajri,  
fluturim i zogjve t'ujit,  
mpiksin qiellin gjithë driza.  
Si det lehtë era lëkundej,  
si det n'ato fusha e mbyste,  
dhe zjarrmia e kurmit flakë  
e zhyste thellë si ethe,

ia këpuste gjunjët Dinës.  
Dhe në çdo zgjerim të gjoksit,  
tok me zgurdullim të syrit,  
thekshëm i vlonte dëshira  
ndaj një rrezeje të diellit,  
ku të ndalej të shikonte  
atë vend që s'ishte i saj,  
tani krejt i errësuar...

Jashtë binte muzgu, e shqota  
kundrejt diellit vrundullinte.

Dhe kur i ndezën hyllnarin,  
zgjuhej si një vel i mbytur  
nga shtërngata në një det.

Një të premtë më t'aguar,  
e djersitur dhe pa drithma,  
Dina zgjohet, se i duket  
sikur ndjeu disa tinguj  
fjalësh gjuhe të panjohur;  
hap sytë e mbi fron i shfaqet  
kthyer nga muri një vashë  
me gërshetat lidhsebardha  
veshur nuse. Dina ndehu  
dorën dhe iu duk se preku  
një dorë akull dhe të butë.  
Ajo nga Dina u kthye:  
për nga balli, ngjante e ëma,  
për nga sytë, ngjante Nusha,  
nga vështrimi, si e huaj.

Pa iu duk sikur u ngrit  
edhe sikur hoqi brezin  
dhe ia vuri anak qafës  
edhe doli, e la vetëm...

Në këto vegime e gjetën  
dhe kur dritsoren ia hapën,  
me gaz dielli i mbush qelinë.  
Atë ditë pa ethe e panë,  
por sylote e të pafjalë,  
në një det mejtimesh kredhur.

## IX

Kur erdh nata, kotullohet.

Prapa froneve hyllnari  
hidhte hije si të gjalla  
dhe te dera ndien trokitje.

Ndjeu e s'foli... Prap' trokitje

*Dina:* — Kush je ti?

*Zëri:* — — Eja dhe hapma!

E pështjellur në të linjta,  
nxori këmbët nga mbulesjet  
edhe shkoi e hapi

*Nusha:* — — Bubub!  
motër, ulu! Shpejt mbulohu,  
se mos ftohe!

*Dina:* — — Jo! Nuk ftohem.

Afro fronin kësaj ane.

Pata frikë se po vdisja,  
pa të parë edhe një herë!

*Nusha:* — Ç'po ma mban gjithnjë në tru  
këtë përndjellje të keqe?

*Dina:* — I tillë është edhe mejtimi

që çdo ditë mua më zgjohet;

qyteti ku zura e fola,

ato toka plot të mira

ku unë endesha nga doja,

ajri, ujët aq të shijshëm,

që gjithmonë atje më janë,

unë nuk do t'i shoh më!...

Në vend tim s'kthehem më kurrë

që t'i thoshja «Po të kthehem

pamjendrruar krejt prej helmit,

po besimin të patundur

ndaj arbreshve e kam në gji!»

Ah, sa do të doja unë!

Por ç'të bëj? Më qenka shorti

që dëshira e pashojtur

për t'u prejtur dhe një herë

n'afsh të njerëzve të zemrës,

kundrejt maleve me borë,

që të bardhë e bëjnë jetën,

kurrë s'do të më përmbushet!...

Edhe Nusha, që e dëgjonte,



në çast rrokur nga mejtimi,  
gjendet tek ujdheza e saj,  
shkëmbi i zhveshur ku pat lindur,  
strehë malli rreth me det.  
Po pas pak i thotë Dinës:

*Nusha:* — Këto janë ethe si bora  
që mbulon në dimër arën,  
por prapë ara, sa vjen vera,  
gjelbëron dhe më shëndetshëm.

*Dina:* — Ah, më prek, Nushë, e shikomë;  
edhe ty mezi të njoh  
dhe më duket sikur ndrron,  
Dje n'agim, s'erdhe më fole?  
Në të blerta të pashë,  
hoqe brezin edhe anak  
mua qafës ti ma vure.

Tha dhe hedh dorën rreth qafës,  
por anak qafës nuk gjen!  
Nusha shpejt me destemel  
mbulon sytë, gurrë lotësh.  
Dhe të dyja qanin bashkë.  
Nga gërhitjet zienin dhomat,  
fletët jashtë, nga zhuzhitjet  
si në një hauz të rënësh  
çastesh të fundit të jetës.  
Edhe nënëkrejsa e Dinës  
po kthehej liman prej lotësh.  
*Nusha:* — Mjaft, moj, qave!

Dina: — — Do të terren

shpejt, se po zbardh edhe dita  
e ti shkon dhe do më mbeten  
në vend të lotve, mejtimet.

Hap dritsoren! Ja, e sheh?

Akerusi dhe për pak<sup>1</sup>)

do të vishet me të kaltra  
në mes brigjeve të blerta.

Tani ndahemi, moj motër!

Nusha e kuqe në fytyrë,  
me flokë ar i përkdhel ballët,  
i puth buzët dhe ndër gjiret  
të dy zemrat drithtëruan.

Dhe si nata e dita ndahen,  
n'ag u ndanë vetmitaret,  
se dhe Nusha më s'përzihet  
me të tjerat. Pas tronditjes  
s'asaj nate, për çdo ditë  
një çupe prej vendit saj,  
nis qindizma t'i mësojë.  
Nis në veshët t'i jehojë  
po një këngë helmimtare,  
aqë e gjerë sa edhe vera  
plot të lashta zverdhur mbrëmjes,  
këngë që prej arash ngjitej.

«Një dit tufë fluturuan  
përmbi burg të Lulebardhës  
zogjtë që rriti në prehër,

me ato fjalë të asaj buze  
kur e mbronte hije e s'ëmës.

*Lulebardha:* — Ku po shkoni, o zogjtë e  
butë,

që me frymë time u rrita?  
Nëse fluturimin tuaj  
e nxit ashk që s'ka vdekur,  
ndonjë lajm nga zonja mëmë,  
zogj, më jepni edhe mua.

*Zogjtë:* — Ne kaluam male e borë  
edhe shumë u lodhëm nd'erë.

*Lulebardha:* — Çlodhi pak mbi piring të  
burgut,

ku më mbajnë mua mbyllur.

Në s'u ktheva atë natë,  
fajnë e pat vajza e mëndeshës.

Më tha: «Toka plot me lule  
më verbon ndaj shkojmë detit,  
që nuk ndrron ngjyrë asnjëherë.»

Unë ashtu, siç isha, hypa  
në anije e mora detin.

Por e rritura me dromcat,  
që më binin nga tryeza,

hyp me nj'arkë stolimbushur...

Zvjerdhur nga të tilla fjalë,<sup>2)</sup>

befas zogjtë u ngritnë e shkuan.

Kështu ndodh gjithnjë në jetë!»

Dhe kjo këngë për çdo ditë

pak nga pak ia shkrinte jetën.

Nusha herët një të dielë,  
kur e zgjoi një të mardhur,  
ndien hingllima e patkonj kuajsh  
tek oborri e nga rruginza  
erë kafje mbi prush pjekur.  
Ngre dhe çupën, shpejt e lan  
dhe e çon të marrë vesh.  
Edhe vetë shkon mbështetet  
në dritsore e si mermeri,  
mejtimpleksur, sheh fushën,  
ku mbi ajrin aq të ftohtë  
ndehej napë rrezesh dielli.

Çupa e vendit saj u kthye  
me unazë e anak në duar.

*Nusha:* — Sa vonove! Erdh njeri?

*Çupa:* — Erdhi që të shohë Dinën,  
gjyshja e saj, zonjë Arianitja.<sup>3)</sup>

Zonjë e madhe i ka nxjerrë  
vendimrënien e burgimit!

*Nusha:* — Në qeli të Dinës ishe?

*Çupa:* — Isha dhe mbi fron i pashë  
dhe në cohë kinde arit  
dhe përparsje brezergjentë.

Dinën ndjeva që t'i thoshte

«Tani, zonja mëmëmadhe,  
unë as mbahem dot më këmbë!...»

Këtu timen s'kisha as kohën!...»

U ndje zhurmë e çupa hapi  
derën: në rrugzinë panë,  
në mes kllogjreshave, zonjën,  
krejt për zi në mëndafsh veshur  
edhe duke fshirë lotët  
sikur dil nga një shtëpi  
vatërshuar nga të zotët,  
nga të zotët që pas lanë  
dashurinë më të madhe,  
dashurinë arbëreshe.

E pa Nusha e gjithë dhembja  
e përmyti, i errësoi jetën,  
e përmyysi shuk mbi shtrat  
edhe lotët i shpërthyen.

Buka, gjumi kundrejt dhembjes  
kaq të mëdha nuk u dukën.

Dhe të gjitha ato që donin  
ta shikonin më të lehtë  
në mejtime, plot nderim  
heshtnin ndaj duhmës krenare.

## X

Vasha e mjerë, e këputur,  
një mëngjes, sa e mposhti gjumi  
ndjen në veshët: «dang, dang, dang».  
Brof tronditshëm: «dang, dang, dang.»

Zëri: — Paske vdekur? «dang, dang,  
dang.»

Nusha: — Qyqja unë, m'iku motra!

Dhe me vrull brof e hap derën  
e siç ishte rend pas dritës,  
që po ndriçonte rrugzinën  
e të gjitha i bënin udhë  
dhe me thirrjet: «Motra ime!»  
bie mbi Dinën si të donte  
t'i nxirr nga buzët një fjalë.

Por ajo me duart shtrirë  
dhe me ballin pa një hije,  
sytë e hapur, si të huaj,  
përmbi shtrat pa jetë ndihej.

Nusha: — Dinë, motër, si më shkove?

Si më le mbi dhe të vetme,  
në këtë jetë të zezë,  
ku të ligjtë shtrijnë rrjetat  
si të marrin nëpër këmbë  
nderin, djersën e të mjerve,  
ku kudo le gjurmë vdekja?  
Ti më shkove kur tek unë  
këto gjurmë që le vdekja  
zhdukën çdo ngurrim e frikë  
për të ndjekur atë rrugë  
ku ti prijë po me zemrën  
e tyt eti, trim bujar...<sup>4</sup>)  
Ndaj vajzash-kuklla pa vlerë,

që paska mëma t'i mburrin,  
Dinë, bisku që shpërtheu  
mbi gërmadha shtëpi prijsash,  
lule ke qenë e do jesh!

Dhe gjoksi, si borë, i fryrë  
nga pikllimi, përnjëherësh  
shfryhet e më gjunjë Nusha  
bie dhe duart gjithë hire  
përmbi llërët si qirinj  
të Dinë shkretës mbërthen,  
në përpjekjet që të mblidhte  
qiellin brenda syve saj.

---

## KËNGA E KATËRT

VIDA ARIANITI

*Arbër, det, Stamboll 1512*

### I

Pas mesnatës vala e detit  
m'iu duk Vidës zhurmë dite,  
dhe nga shtrati vasha ngrihet.  
Del te pragu e shikon malet,  
kruan, kopshtin e shtëpinë  
ku pat lindur, dhe lart yjet,  
që të rrallë kudo ndritnin.

Pastaj brenda hyri e ndezi  
një hyllnar edhe shikon:  
qengji i bardhë, prej saj rritur,  
shkundet në shtrofkë e shpejt **ngrihet**  
dhe në mes gjunjësh i shkon.  
Bar i nden vasha dhe thotë:



bulurimë e valëve  
i shurdhonin veshët vashës  
dhe s'dëgjonte blegërimat.  
Mbi faqet i përhapej  
një si re e hollë, e bardhë,  
që në s'prish harenë e qiellit,  
ajo prap' s'e le të plotë.

## II

U rrasbit anija e niset<sup>4)</sup>  
edhe kapedan Gramosi,  
arbëresh fytyrëbakri,  
rregjur dielli e kripe shqote,  
arbëreshës Vidë i thotë:  
*Gramosi:* — Zonjëz, ti në këtë anije,  
q'është ndën urdhrat e tua,  
ke një dhomë, siç e kanë  
në pallat vashat prijsesha,  
dremit suvala poshtë e afër.  
një spanjollkë gojëmjaltë.  
Kur të duash, t'argëton,  
me biseda dhe zakone  
nga qytete të hareshme.  
*Vida:* — Ditën që hype n'anije,  
pranë mëmës, them, ke lënë  
vllëzër, motra edhe gjiri.

Unë, o zot, në breg nuk lashë  
veçse tatën plak pa ndihmë,  
pranë tij: varrin e mëmës.  
Dhe tani si varr më duket<sup>2)</sup>  
kjo anije që më shqiti  
prej kasolles sime e bregut.  
Ndaj, siç jam, këtu më lerë  
sa të shkojmë edhe më larg,  
gjersa sytë të më lodhen.  
Si zog unë u linda i lirë  
dhe kjo kaltërsi e gjerë,  
si një qerthull i pafund,  
ah, sa shumë më mërzit!

Iku trimi e u tha shokve  
që asnjëherë mos t'ia prisnin  
pamjen e bregut të Arbrit  
vashës gjatë gjithë ditës.

Vida, ashtu siç ishte mbeti,  
e vetmuar dhe rreth drita,  
nëpër velat e tejdukshëm,  
para saj lehtë lëvizte.  
Atje ngjante me një mirë,  
(në mal prrallash, pa kënd afër,  
përveç erës q'hingëllinte  
nëpër gryka e sipër pirqjesh),  
që asgjë s'donte, veç të shikonte.

Dhe kur dielli kapërceu  
mesit qiellit, por s'kish ngritur

ende hijen mbrëmjesore  
përmbi sheshin me suvala,  
pika shiu, tok me shqotën,  
që desh të rrëmbente velat,  
i lagën vashës gërshetat.

Dhe te vasha shkoi Gramosi:

*Gramosi:* — Bashkë i gjen kudo në botë  
ngazëllimin dhe lirinë<sup>3</sup>),  
hapësirën që fal dita  
bukuria dëshëron.

Pra, përshtat a të shkon gardhi  
ty, që kur ishe në breg,  
po të doje, si pasqyrë  
vetë deti i madh të bëhej;  
po të doje, pylli i filladshëm  
hije për flokët të bëhej?  
Tash aq larg na çuan dallgët,  
sa nuk ka sy vashë e trimi  
që të mundë të dallojë  
bregun arbër nga u nisëm.

Dhe në mes detit njeriu,  
lule e rritur në mes dhomash,  
zverkun, pjesët më të hajthme,  
di t'i mbrojë prej athtisë  
përcëllore t'erës detit!

Kjo do t'ishte fare e thjeshtë  
dhe për ty, o vashë Arbri,  
dhe pse ranë plot mynxyra

përmbi zonjën, mëmën tënde,  
bijë fisnike Muzakajsh,  
mbi bujarin plak tët atë,  
që në varfëri ngrysh ditët  
zhytur n'ankth për jetën tënde,  
Por ti ndryshe e paske fatin,  
pas pak ditësh do ngrehohesh  
mbi të gjitha sipër fronit  
që ta dhuroi... dashuria!

*Vida:* — Po më sheh, o trim, se qysh  
unë plot me brengë bëhem  
dëshmitare për ndryshimet  
që gjithnjë ngjasin mbi dhe,  
ku pa u korrë kokrra e vjetër  
nuk të mbillet kokrra e re,  
po s'u ngrysh, as mund të gdhiet.  
Nga kjo edhe dora e njerëzve  
shkreton të mirat e botës:  
kështu prindët e sulltanit  
bënë edhe me tokën tonë,  
që ia lanë trashëgim.  
Sulltani më dashuroi,  
edhe unë, vajzë e hajthme,  
që të marr mbi vete fatin  
e qyteteve të Arbrit,  
duhet krejt t'i ngjas të ligut,  
q'është fyl, po pajë e dheut!  
Tha këto dhe si pallua

u ngrit edhe futet brenda,  
ku përtrihej në mermer  
dita që jashtë zymtohej.  
Atje gjet një erëndje lulësh,  
që i përshtat dora e njeriut  
të gëzojë atdhenë e tij.

Si në qiell të kaltër ylli,  
si në shesh të blertë flaka,  
qetsisht ndjeu se qe rritur  
atje, mes aresh, pasqyrash.  
Pranë saj, fytyrëprerë  
nga zilia e papritur,  
me nderim ngrihet një vajzë.

*Vida:* — Turkë je?

*Julia:* — Spanjollkë, zonjë!

*Vida:* — Besoj, gazi për rininë  
ka më hije!...

*Julia:* — Jo gjithmonë,  
se dhe gazi lind nga jeta.

*Vida:* — Fryn një shqotë tërbimplotë  
edhe retë i nxinë brigjet  
e nuk shihen më qytete!

Të pakën të binte pak  
ndënë ne batica e madhe,  
zonja e ujrave të detit.

Pra, ki mendjen!

Shtëmëng qelqet  
dhe afrohen ndën shqepza,

që të dyja larg vërejnë.

*Vida:* — Këtu, n'anije të brishtë,  
krejt të mirat që ka dheu  
neve përpara na shtrohen.  
Por këto xhingla të rreme,  
virgjëreshës që s'qas njollë,  
nuk i shtrohen asnjëherë!

*Julia:* — Që nga juga e detit Spanjës,  
u shkull, zonjë, e erdh ndër ne  
një polem, djegur prej diellit...

Ai tha se «për njeriun»  
dhe kur helm të kenë fqinjët,  
n'argëtim ndrit lumturia,  
si edhe drita që nuk digjet  
as mes zjarrit më të fortë,  
si edhe qielli i pasosje,  
që ndrit lart pa turbullimë  
se ndën «të përleshën retë.»

*Vida:* — Këto fjalë gaz e verë,  
që po nxjerr nga goja, o vashë,  
n'akull helmi po më kthejnë...

*Julia:* — Ti të mirë e ke qëllimin  
por për puthje lindin gratë  
dhe në puthje ato treten.

Por n' hareme mbyllur brenda,  
mes inxhish, lulkash si akull,  
domosdo dhe zemrat fyshken!...

*Vida:* — Jo për mua, që gjithmonë

besa e prindërve të mi  
s'do më ndahet, po do ndrisë.  
me shqepthin e saj të kaltër,  
krejt si kaltërsi e qiellit  
gërshetat do m'i mbulojë...

Mbrëmja lehtë-lehtë ndehej  
përmbi dallgët — male e detit,  
që gjëmonte rëndë e turbull,  
sa vetë erën dridhtëronte.  
Por shkëmbenjtë, të padukshëm  
atje thellë, nuk pyesnin  
nëse po ndridhtrohej era,  
siç nuk pyesin edhe ligjet<sup>4</sup>)  
(gjithë pyka) te kjo botë  
nëse drithtrohen të mjerët!

Pastaj Vida lart u ngrit  
dhe më këmbë ajo përngjante  
në mes detit edhe dheut,  
si një rreze e posazbritur  
në gji shtërgatash që shfrynin  
ta përmbysnin këtë tokë  
edhe atë rreze ta fiknin,  
që njerzia të mos shihnin;  
por ajo shkëlqen e s'tundet  
posi nxitje e përjetshme,  
që mbush zemrat plot me shpresë.

### III

Çdo gjë heshti dhe në t'errët  
qetë-qetë u nde një mjegull  
përmbi rrapëllima dallgësh.  
Edhe vashëza spanjolle,  
djegur mallit në buçimë,  
drithtërim në fund të zemrës,  
(shfaqur dje si në pasqyrë  
para Vidës), merr kitarën,  
hidhur buzëqesh dhe vjetve,  
që i kaluan u këndon  
këngën «Vasha e Granadës»:  
*Vasha*: Përse m'ikën trim e s'rri  
të fjalosemi edhe pakëz  
tash që tata e mëma flenë?

Kaq e pahirshme, s'e di,  
në jam, sa ty t'u rëndova  
sonde edhe në dritë hëne!

Po të dilën si të dal  
para ty ditën me diell  
në pod të arenësë?»<sup>1</sup>)  
*Trimi*: Buzëshegëz e Granadës,  
mua nuk më rëndet deti  
tok më brigjet aq të largët.

Pra, si mund që të më rëndesh  
ti, o zemër, që më dojë  
si një krua shkretëtirës?



S'ndenja, vashë, por do kthehem;  
zogj e njerëz era zgjuan  
dhe këtu mua më shohin.

Më shikojnë bij bujarësh  
edhe tek të tu vëllezër  
nga zilia na kallzojnë.

Pastaj n'ar prej mëmash veshur,<sup>2)</sup>  
ty të gjejnë larg meje  
dhe dëshirat krejt t'i vjedhin.»

Vasha: «As anija që të ruan  
nga tallaze e shi e shqota  
s't'është e besës, trim, sa unë.

Në shtëpi pa helme u rrita  
por më tepër se krejt dheun  
të dua pranë përdita».

Trimi: «N'është kjo dëshira jote,  
shqota e anije që i munda,  
me ty pranë i mposht i lumtur».

Vasha: «Edhe Vida bykut lëmit  
njeh e merr kokrrën e grurit,  
njeh e lë kokrrën e gurit.

Porse vasha s'di ta njohë  
në mes fjalve të një trimi,  
atë fjalë që e gënjen.

Mos m'u ngrys, se sikur bota  
të më ngrihej kundër, zemra  
të zgjodh, trim, e nuk zgjedh tjetër.

Por një ditëz e pandehja

se mos bëhesha shpejt grua,  
edhe shpejt do të mbaroja».

*Trimi:* «Gjinjtë, o vashë, ty t'u frynë,  
që një foshnjë yll të rritësh,  
o moj lule në buçimë!»

*Vasha:* «Eja, pra, se fati im,  
ja je ti, ja deti i thellë!»

Iu mpi dora e llavë helmi  
kurmit ndien sapo dyshoi  
mos arbereshja e butë mbudhë  
i vodh zemrën trimit saj.

Ngjitet lart; detarët flinin.  
Dhe Gramosi tek dremiste  
zhytur thellë në mejtime,  
sapo ndien zhurmën e lehtë,  
lehtë ngre me dorë velin  
sytë hedh në dritë hëne  
e sheh si lehtë e hapdrojtur  
Julia e zbetë i afrohet.

*Gramosi:* — Kur bie era e djemtë shtriqen  
n'hije velash gjatë ditës,  
sa bie nata e s'ngrihet hëna  
zhurma m'e lehtë e një vajze  
shpejt e ngre më të zhdërvjelltin!  
Porse sontë djemtë, o vajzë,  
të këputur nga duhia,  
krejt të turbull, si të vdekur  
po më flenë që të gjithë!..

*Julia:* — Grazhdeve shtëpisë sime  
a parmendave, të mbytur  
djersë e pluhur, kanë hije  
këta, që ndruhesh mos ndajnë  
tok me ty, edhe zemrën time!...  
Po ç'të bëra? Ç'faj të kam,  
që me kaq mëri më pret,  
si mund të më presin vetëm  
të mi vllazër edhe mëma,  
që për ty i neverita?  
Pse t'i nxirrja këto fjalë,  
zemra ime, si m'u errën  
kësaj nate gjithë mjegull  
gjithë pamjet aq me hire,  
ashtu helmi po m'err zemrën.  
Rrezja e hënës që ty ballin  
ta zbeh egër, më ngrin gjakun.  
O ti bir bujarësh arbër,  
skllev arabësh dhe të varfër  
edhe prindët e mi rrojtën  
shumë kohë. Po kush vallë  
çmon njeriun veç nga fati  
që mund ose s'mund t'i qeshë?  
Neve grave na thëthijnë  
ja se hije e kurmit burrit,  
ja fuqia prej fatosi!  
S'desha nder shtëpie princash,  
as fqinjë, as qytetnë e shtrenjtë,

që më kish në zemër brenda,  
por ty desha edhe pas t'ardha.  
Në kur nxehem, s'i mat fjalët,  
mos m'urre, se brenda meje  
zjarri i dashuris' për ty,  
nuk le dot një cep të zbrazët  
q'ato fjalë të qëndrojnë.  
Vetëm (dhe ty nuk ta fsheh,  
se nuk kam për kë ta ruaj),  
që në çast që këtu sollëm  
ne sulltanën, unë ndjeva  
një si xhëngë mynxyrjare;  
mbase që kujtimi i vendit  
ku do ngremë ne shtëpinë,  
mbase mejtimi se shtyrej  
koha që t'hapnim shtëpinë.  
Dhe tani unë pa dashje,  
para se ta preknim dheun  
të gëzuar, bëra gjëmën  
ty t'helmoja edhe vetveten!  
Më fal, më mbaj si të duash  
nuse, motër, shërbestare,  
në helm, burg, si të më duash,  
për gjithmonë do jem jotja!  
Merrmë vajzë krejt të mitur,  
mëshhiromë e më bëj grua!

Dhe arbëreshi i thotë i ngrirët:  
*Gramosi:* — Julia, ajo liri pallatesh,

me të cilën je mësuar,  
të gatoi për një rend tjetër,  
nga ai rend që do i kish hije  
nuses sime ndër gjitonet,  
ku edhe dashuria jote  
do të dukej lapërdhi  
mëmave që rritin bija  
(trimëresha edhe të pastra),  
dhe ku ty nuk do të qasnin  
në mes tyre, edhe fëmija  
«pjellë rrugash» do të quhej!  
Për këto, ai vendi im  
është m'i egër nga deti!  
Ty të shkojnë krejt përshtat  
ar sulltani e ashk haremi,  
ku t'harrohesh pa kujdesje  
dhe të thuash: «Veç dy brigje  
pashë, edhe të dy fatmirë!»

Julia e prerë në fytyrë,  
me një hap q'ushtonte lehtë  
si kambanëz e përzishme,  
zbriti poshtë e u plas te shtrati;  
psherëtima lak në grykë,  
i zë frymën dhe ngjan gjëmë  
e një zogu buzë agimit,  
të një dite që s'do i ndrisë.

## IV

Dhe Gramosi digjej brenda  
symbërthyer larg te hëna,  
që nga lart dilte dhe vishte  
mjegullën si më të verdhë.  
Bota më çdo anë flinte  
dhe pse pyjesh shinte shiu  
e ndaj muresh ndër qytete  
fshikullonte edhe veriu,  
E Gramosi flet me vete:  
«Mos në gjithë këtë heshtje,  
si bie bora përmbi brigje  
edhe gjatë rrugës tretet,  
ra vallë ora që të ndahem  
prej asaj që desha, e sipër  
t'i kaloj, siç u kalova  
gjithë atyre zotërinjve  
që familjet, vatrat donin...  
Po edhe deti për ndënë yjet,  
rri me tokën plot me njerëz,  
që kudo i japin hije.  
Edhe jeta e të gjallve,  
me shtërgata t'egra e breshër,  
me to bashkë përshtjellohet  
brenda gjirit gjithësisë.  
Edhe unë a s'jam si ta?  
Apo linda si rrufeja,<sup>1)</sup>

që nga retë bie mbi dhe,  
djeg ç'gjen para e tok me to  
djeg e zhduk edhe vetëveten?  
Por ajo lindi me hire,  
që i ngjiz koha të mos zhduken;  
rreth saj pati ajo vëllezër  
me flamur stemë plot ndere  
e plot vajza ndënë urdhër...  
Sa më pa, qysh vallë iu duka,  
që m'u skuq e aq ëmbël foli?  
Dhe sa mori vesh që e doja,  
çdo gjë Julia e harroi,  
mua veten ma dhuroi...  
Mua, që mjafton një shenjë  
prej sulltani e shpejt më flakin  
(si qen me një gur në qafë)  
poshtë në hauze deti,  
edhe krejt mburrjet e mia  
shkrijnë në një tufë valësh!..  
Domosdo n'oborr më qasën  
si një krimb më hikzathurës,  
që në fije prej mëndafshi  
na tërheq dhe stolis gusha  
vashash, lindur të begata.  
Domosdo si krimb më mbajnë,  
se nuk kam përkrahë Atdheun  
plot me nder e në liri!..  
Po dhe Julia vrer më derdhi

kur më shfryu kundër djemve,  
shfryu kundër vendit tim,  
që e kam larg dhe, siç ka hije,  
nuk di ç'janë lapërdhitë,  
ku çdo vashë nderon trimin,  
bashkëshort të jetës saj  
që të gjithë rod bujarësh!  
Drita e vashave t'arbresha  
dhe në skamje është aq e ëmbël,  
sa dhe drita e vetë diellit,  
që çan rreth degë edhe gjethe,  
dhe liqenit pasqyrohet.  
Eh, një agim sikur t'i gdhija  
djalosh dheut edhe detin  
larg të kreshtur ta shikoja,  
pa mejtim të përcaktuar  
n'hapësirën e pasosur,  
edhe pas të kisha malet,  
me ato kreshta gjer në qiell,  
napë e përjetshme e nderë  
që nga juga në veri,  
mua do të më pushtonte  
një brengë e madhe, e pamasë.  
Edhe sikur të shikoja  
se nga bregu do më vinte  
drejt një shqitëz krahëbardhë,  
dhe me synë e saj të thellë  
do më vrente si të njohur,



i mahnitur do ta prisja,  
sepse n'atë vetëmi  
do më sill jetën e dashur,  
por nuk do ma thithte zemrën!  
Porse Vida sa të shkreppte  
vetëtimë para meje,  
zemrës së saj qiellore,  
fjalës së saj njerëzore,  
ah, Vidës do t'i uroja  
vetë fronë e gjithë dheut!...»<sup>2)</sup>

Dhe Gramosi ballëdirsur,  
ngrihet, shtyn velin me dorë,  
mbi katartet lart në qiell  
dhe mbi mjegullën përjashta  
shenjzën pa dhe fërkoji duart;  
era frynte dhe e rrihte anash.

Pas pak tha si i çliruar:  
«Me ju pjesë gjithësie,  
të shëndosha përgjithmonë,  
të sigurta në vetveten,  
edhe unë do të vij  
dashurive edhe rinisë,  
fund u dhashë e s'dua prehje  
në gjí grash, dua liri!<sup>3)</sup>  
Si nga gjiri i çdo shtërgate  
unë dola edhe më i fortë,  
yjet që po ndrisin kohën  
më thërrasin t'u shkoj pas,

gjersa vendeve të Arbrit  
shorti im të ngrihet pìrg,  
që çdo natë të ndritë udhën  
në mes shpatesh për qytete.  
Atje djelmëria e rritur  
plot me hije e larg së keqes,  
brennga e thinja do më fshijë  
edhe do të më përtrijë,  
ashtu siç qielli përtrin,  
juve, o erë, o ujra, o yje,  
me vesë e shi përgjithmonë!»

Dhe anija fluturonte  
e nga shkiste aty-këtu  
ujët vorbull po ndriçonte  
nëpër mjegull që po shqyhej.

## V

Përmbi ujët shkumëftohtë  
çeli dita e tash te bregu  
mbi pallate trumba vidash  
nga qyteti, si pa mend,  
me gëzim që ne s'e njohim,  
n'erë lart po hidhnin valle.  
Aher gjumi Julien lotve  
ua muar, sikur donte  
t'ia shtëmëngte vetë ditës  
posi trimi i arratisur

shtrofkës te kopshti i shtëpisë,  
tek vren yjet që dridhtojnë  
si tërzimë karkarelesh<sup>1)</sup>  
lart në mana dhe ndjen udhës  
si në dritë hëne enden  
vajzat fqinje e i vlon urrejtja  
kundër zgjedhës dhe tiranve,  
pastaj qetet dhe dremitet,  
me plot bindje se edhe bota  
do të gdihet pa zinxhirë,  
ashtu Julia kotullohet  
me një mjetim mjegullimë,  
si shtatujat femërore  
në mermer të bardhë flenë  
përmbi varre pasanikësh.  
Pas ca here shtrohet vala  
para diellit, që mbi ujrat  
del dhe velat skuq e ngroh.  
Vishet Vida e del të shohë:  
gjithëkund valëvet lehta  
trumbë peshq bishtër argjentë  
brofnin lart dhe vetëtinin  
edhe vërvëllimë e shkumës  
vende-vende i tërheq sytë.  
Afër bregut portokallet  
dhe dafinat dallgëzonin  
jo rrëmbimthi, si shkëmbenjve  
të vetmuara ndaj diellit,

por së butthi e nga puhija  
frymë merrnin si ndaj vashash.

Nga këto krejt e rrëmbyer,  
Vida vë vathë e anakë,  
dhurëti të zotit madh:  
hijeshtohet, hap dritsoren  
edhe n'ujët si pasqyrë,  
vetëveten e sodit.

Dhe lart ngjitet si purtekë,  
e shkëlqen pranë bajrakut  
të sulltanit në mes tymit,  
që nga gryka topash villej,  
si shëndetje për sulltanën!  
Dhe Gramosin krejt të zbetë,  
Vida e skuqur e pyeti:

*Vida:* — Cila nga kullat e bardha  
mban në gji zotin e madh?

*Gramosi:* — Ajo që po errson detin!

*Vida:* — Atje do më kalben eshtrat?

*Gramosi:* Ç'është ky mejtim i ngrysur,  
që n'agim kaq të hareshëm?

*Vida:* — Përse vallë mos të jetë?

Sa të ngryset do të gjendem  
unë atje si krejt e huaj  
dhe një rrugë do t'i hyj  
gjer në vdekje, pa gjë timen.

*Gramosi:* — Me det unë do vozit  
afër bregut arbëresh,

andej nga ndodhet yt atë.

Dhe tyt ati do t'i them  
se «jot bijë zemrën vuri  
përmbi zjarr posi theror  
për arbreshë e Arbër tonë!

*Vida:* — Edhe se jot bijë, i thua j,  
atje ka gjithë të mirat! . . .

E sa nxori këto fjalë  
i mbuloi me shqepze sytë.

Buzë detit zhurma e madhe,  
që po prit vashën sulltanë,  
Julien në shtrat poshtë e zgjuan  
zemërcopë e buzënxirë.

E tronditur brof siç ishte  
edhe ngjitet lart te podi.

Por, sa sheh tok Gramos-Vidë,  
mavijoset, turbullohet,

dhe kur vren se Vida zbriste,

Julia pas e ndjek si hije

buzë detit në mes njerzish,  
pa kuptuar se ku shkonte.

Vetëm nis diç të përmendet  
kur sheh veten të rrethuar

prej avllive të haremit.

Dhe atëherë zë shkul flokët,

bie më gjunjë e shfryn ndaj zotit:

«Deh, në je vërtet, o zot,

si vërtet dhe brez pas brezi

fisi im ta mbrojti besën,  
shpatëzhveshur përmbi tokë  
dhe fitoi, ti dil nga qielli  
edhe shih (se çdo gjë sheh!),  
se sot unë jo me hir  
por me pahir po përdhosëm  
prej të ligut, që për ty  
as pyet, as do t'ia dijë,  
ndaj pa ty, pa qiell mbeta!...  
Kjo greminë m'u gatua,  
pasi mua dashuria  
më gënjeu dhe n'emrin tënd!...  
Në mos qofsh veç qiell i zbrazët,  
siç goditi ai tim atë,  
me rrufe në det godite,  
kur të ndihet më i lumtur!»  
Me besim se do të ndodhte  
siç ajo i kërkoi zotit,  
Julia hedh një sy të ftohtë  
si mbi hijen e vetvetës,  
si mbi botën, vatrë e saj,  
që për të më s'kishin vlerë.

## VI

A s'ka nata plot fantazma,  
brennga të së bukurës,  
që më rri pa drithtërima,

o moj Julie e bukurë,  
ndënë fletëgjerën panjë?  
Ky Bizanci, mbret qytetesh,  
asnjëherë s'pat hare  
më të madhe se sa sonte...  
Dil Julie, e si mbretëreshë  
e haresë në fund feste,  
jepi mbylljen më të bukur!  
Dil, çdo brengë hidh pas krahësh!...  
Porse Julia, pre pendese,  
aqë larg tani kish ikur  
nga haremi, sa dot s'ikën  
as me mendjen aq të shpejtë  
një fëmijë drejt shtëpisë,  
i rrëmbyer prej gëzimesh  
që atje pat me mëmë-zonjat  
dhe që gjallë s'i ka më!...  
Te një kënd Vida na doli  
ngriti sytë e shikoi yjet,  
që si tufë xixëllonjash  
i vozitnin drejt vendlindjes;  
shikoi dritat e shtëpive,  
më tej malit ndonjë zjarr  
të vetmuar edhe poshtë  
detin fushë shkretëtirë,  
por me dritë hëne veshur  
dhe të madh sa gjysma dheut.  
Edhe me vete mejtoi:

«Ndoshta nesër edhe qielli  
sytë e tij nuk do m'i hedhë,  
sepse shtetase po bëhem  
e një vendi të pabesë!»  
E nga ky mejtim drithtuar,  
Vida shpejt e shpejt pështillet  
me një vel që ia pat hedhur  
mbi djep mëma kur e la  
edhe shkoi të vdes për nder.  
Pastaj shkoi dalngadalë  
dhe djaloshi sulltanin pa.

Ai ngrihet e sodit:

*Selimi:* — Këto ditë, sa më të **madhe**,  
aq dhe t'egër mos të bënë?

*Vida:* — Ku ta dish, mbase edhe **unë**  
e pësova si dhe ajo,  
që me këmbë të saj detit  
iu fut vetë e sa më thellë  
shkonte, deti e mbulonte,  
edhe ajo për të shpëtuar  
matej të bëhej m'e madhe!...

*Selimi:* — Sytë e mi sapo të **panë**  
kur nga shiu që errte dheun  
në shtëpinë tënde erdha,  
zemra ime nisi e ndjeu  
ç'ngazëllim dhënka kjo botë!  
N'emrin tim, të tjerë rripnin  
arin, edhe të tjerë vrisnin,



porse unë asgjë s'dëgjoja  
veçse fjalën arbëreshe  
dhe mejtoja vetëm «paqe  
për të gjithë», e sa më parë  
për vetvete e për krejt botën,  
sepse zemra dot s'm'u shqit  
nga shtëpia jote. E sot  
këtu në saraje m'erdhe  
kaq e dliër, sa edhe bora  
ngjizur natën lart në re  
dhe që zbret e zbardhon dheun.

*Vida:* — Në çdo gjë që më bën zonzjë,  
nga unë asnjë dëm s'do kesh!  
Edhe s'ka sesi të kesh,  
sepse dhe sonte që fjeta  
n'ëndërr isha në vend tim  
tok me motrat arbëreshe,  
ca plot lot e pikëllima  
për vëllezër e dhëndurë  
që po kalben nëpër burgje,  
apo nëpër ushtëritë,  
ca me tim atë strehuar  
ndënë pemë a ndër gërmadha  
pullazprishura prej shqotash,  
po dremitnin dheut zi.  
Andaj unë, o zot i madh,  
them se do t'ishte më mirë,  
që këtu të mos më mblidhen

prap' të gjitha edhe në gjumë,  
vetë ne atje të shkojmë.

*Selimi:* — Unë, o zonjë, tani dua,  
tok me ty një kënd të qetë  
të shkoj ditët gjithë qejf.

Andaj ti, o zonja ime,  
me kë do dhe ke për zemër,  
ashtu si me një vëlla,  
vendit tënd i ço lirinë,  
se tani vetëm allahu  
më tërheq njësoj si ti.

Pra, përse të ngurroj unë  
që të mos i bindem zemrës?

Unë zgjidh në besën tënde  
sot nga prangat një dragua!

Ashtu qoftë nga allahu!

Po ti ç'ke? Përse po qan?

Vida, që me mendje ndodhej  
pranë tatës larg në Arbër,  
iu përgjigj, si mblodhi veten:

*Vida:* — Vendit tim, mejtoj, lirinë  
mund t'ia çojmë me Gramosin!

Sa tha Vida këto fjalë  
heshtje bije në mes tyre,  
dhe të dyve goja u qepet.

Dhe pas pak Selimi shkoi,  
kurse Vida një copë herë  
si qiri në vend qëndroi,

mbase që mos t'i shpëtonte  
as më e imta imtësi  
e një vlimi të përbrendshëm  
që papritur nis ta zbehë...

## VII

«Mund të jepen zotërime  
vetëm me një fjalën time?  
Por a s'u tha se «në botë  
toka gjithë është krijuar  
ta gëzojnë gjithë njerëzit!»  
vetëm sa të jenë gjallë,  
dhe pastaj ata ta lënë  
të madhe e ashtu siç ishte?»  
Kështu tha me vete Vida  
dhe si lule në mesditë  
u përgjunj, dhe ashtu fjeti.  
Dhe ëndrriti sikur shihte,  
si në skenë, pasqyruar  
detin edhe në fund qiellin  
si më poshtë e si më thellë.  
Sipër dallgët bulurimshëm  
shkonin dhe Vida dëgjoi:  
«Kjo është jeta, hapi krahët  
edhe kape, është jotja!»  
Vida gjegjet: «Si ta kap?»

Dhe nga bregu ajo shihte  
si venitej skena e detit  
dhe pastaj Vida kalonte  
një si gropë barzhuritur,  
mbushur koska e nga hauzi  
i shkretuar ajo ndjeu  
«Shkuan dhe askush s'm'u fall!»  
Kaq dëgjoi e zë më s'ndjeu  
nga hauzi i shkretëtuar.

Kur u zgjua pamjezbetë,  
pa shtëpi e qytet, ulet  
mbrëmjes mbi një fron të ftohtë  
ndaj shtatorres së mermertë  
të një vashëze hyjneshë,  
të nderuar dikur shumë  
në Grainë e lashtë, e sot<sup>2</sup>)  
nga gjithë e qojtur «një vashë  
bukuroshe e panjohur»...

## VIII

... Dhe Selimi vetë ish nisur  
drejt Arbrit (në kryengritje!),  
zemërzymtë edhe pse linte  
verën buzës së Bosforit,  
që vozitja po ia fshinte  
dhe prej syve, ashtu si fshin

era pendët nëpër sheshe,  
sa më larg anijet iknin.

E, si ish larguar shumë,  
me anijet më të rënda,  
pamjerëndë u ndal Selimi  
në një ujdhezës të bukur,  
që të çlodhej, të mblihdh veten,  
për të vozitur më tej...

Pasi u çlodh vazhdoi vozitjen  
e, si një javë kish shkuar,  
që të mbrohej prej shtërgatës,  
kthehet në një gji të gjerë.  
Pas e rrih furishëm dallga,  
në breg shiu kokrrabreshër  
mbi të derdhet që nga dushqet  
dhe si llavë sulmon detin!  
Po detarët për Selimin,  
me shulë, degë e mbulesa,  
një kasolle mjaft të madhe  
shpejt përmbi një sop e ngritën,  
dhe me zjarr të madh ia terën.  
Atje brenda i shkoi Selimit  
mendja tek gjithë të rinjtë,  
që në zhurmërimë shiu,  
me gaz jete thellë zemrës  
në shtëpitë flenë qetë,  
si nuk fle dot tash ai!

Prap vozitje edhe Selimi

më në fund arriti n'Arbër.  
Por këtu rëndë goditet  
kur merr vesh se na «ish një grua  
ajo që na e paskej ngritur  
kundër zgjedhës otomane  
trim Gramosin, miknë e saj.  
Ajo qenkej aq krenare,  
sa lakmonte që në Arbër  
të zij fronin e rigatës,  
dhe mbi Arbër të sundonte,  
siç sundonte përmbi botë  
bir i sulltanit, Selimi!»  
Dhe Selimi sa dëgjoi  
këto fjalë, i tëri zbehet,  
tronditur dhe nga zilia.  
Nga të tjerët na shtëmënget  
fill i vetëm mbi një shkëmb,  
vren anijet edhe truri  
nis t'i vlojë nga dyshimi  
se «ajo grua» do t'ish Vida,  
ajo, që nën pamje ëngjlli,  
si plloç akull mbi batak,  
që përpara paskej vënë  
mbi një fron tjetër Gramosin,  
përmbi fron të zemrës saj!  
Eh, ç'dinake që na qenkej!  
E kështu mejtonte e qante

moshën, jetën, flakur lumit.  
Ai Vidën fajësonte,  
se në botë, ai mejtonte,  
përveç Vidës s'gjendej grua  
që Gramosin ta thëthinte,  
aq sa t'i pushtonte zemrën.  
(Ai Gramosin mirë e njihte).  
Retë lart shqyhen dhe lënë  
mbi sop diellin të shkëlqejë  
dhe Selimit po i duket  
sikur dielli vetë i thotë:?)

«Këto vende ngjeshën shpata,  
jo për nam, se namin unë,  
o Selim, ua kam dhënë!  
Vetë unë, të vetëm filli  
e kam parë atë fatos,  
që me fjalën e vëllaut,  
gjithë i mblodh si në të korra  
n'arat q'u lanë stërgjyshët.  
Unë atyre ato të korra  
ua kam dhënë përgjithmonë!  
Ti ç'kërkon në vende t'Arbrit?»

Dhe këto fjalë diellore  
sikur e shkundën Selimin  
e prapë i ngjallën besimin,  
por shpejt edhe krenarinë,  
që atij i qe selitur  
brenda sarajesh-hareme,

sipas urdhrave të s'ëmës,  
hanëm valide sulltanës.

## IX

Ç'po sjell era prej së largu,  
që po ngrihen male dallgët,  
mos ta lënë që të vijë?  
A s'është e mbuluar toka  
me plot kokrra pemësh rënë,  
me plot degë gjethezhveshur  
sipas tekjeve të shqotës,  
malet mbuluar me borë?  
Me baltë akull u mbuluan  
edhe duart e gjymtyrët  
aq të dashura të kohës,  
që kur zbriti për të fjetur  
Julia, vasha që i zgjoi fatit  
të Gramosit ndjenja e mendje.

Vida e zbetë edhe e vetme,  
pasi lë në avëlmend  
tok me troket dhe shigjetzën,  
del te dera mbi bedena  
dhe teksa shqota i rrihte  
valë-valë petknë e kaltër,  
ajo vren sheshin e detit  
tejmbanë të përflushur



nga zhavori i zalleve,  
që pështillej dhe në ujrat  
shkapërderdhej i përpirë.

E tek vrente mendja e çonte  
dhe në ditët kur mund t'ishte  
e dëbuar nga pallati,  
dhe sërishmi prapë e varfër,  
do t'i duhej të lëvronte  
tokën dhe të nxirr me djersë  
bukën, edhe kur fuqitë  
do ta linin më të dobët.  
Dhe ja, larg sheh tri anije,  
që në çdo rrëtokth të egër<sup>4</sup>)  
dallgëzor, si djepe anonin.  
Deti n'ujët e pasosur  
i ka dhe me bubullimë  
fryhet si male që kanë  
në gji zotërit e botës,  
kryelartë e mendjehollë.

*Vida:* — A mos janë ata që kthehen?  
I tund dallga si ndër djepet  
dhe flamurët nuk po duken!...  
Njëra s'duket! Mos u mbyt?...  
Prapë duket!... Ata janë!...  
Edhe sytë e saj të bukur  
hapësirën përçafuan;  
dhe atëherë nga selvia  
aty pranë, siç rrëfëhet,

një zog pendëkaltër foli:<sup>2)</sup>  
Zogu: — Unë vij andejë, o zonjë.  
Dhe fytyrëzbetë e pashë  
trim Gramosin sapo gdhiu  
pranë anijes së Selimit.  
«Eh, të shkretën, tha Gramosi,  
sot m'u dashka që të lahem  
dhe me gjakun e Selimit,  
që harroi armiqësitë  
e të parëve të tij  
edhe mua më zu besë  
dhe në prona të pallatit!»  
Por atje, me velat fryrë,  
qark anije turke i bëjnë,  
dhe për fatin e Selimit,  
me një breshëri shigjetash,  
thajnë duar, shpojnë gushë  
ndër djelmosha të Gramosit,  
bij nga rod që mundi Azinë!<sup>3)</sup>  
Dhe Gramosi krenar sulet,  
e me predha shemb e çan  
një anije plot zabitë  
dhe si rreze i ndriste bindja  
se as gjyle, as shigjeta,  
nuk do kishin se ç't'i bënin,  
andaj balli i shkëlqente,  
zemra zjarr i ngazëllonte.  
Përmbi ujrat, që të fryra

ndenin hije shqetësimi,  
binte dielli dhe nuk mbytej  
si katartet copë-copë.  
Dhe lart n'ajër shungullonin,  
posi një përmbysje qielli,  
gjëmë gjylesh dhe baroti.  
Përmbi vela i ulrinte era  
dhe anija q'i rrëshqiste  
mbi kurriz valësh, e shqeu  
në bark një gale të madhe  
ndënë klithma djemsh e burrash,  
tek e shihnin që u epohej  
mbrapa e anash si një mal.  
I kënaqur se mbaronin  
turqit brenda detit thellë,  
trim Gramosi me anijen,  
që nga kulmi i dallgëzuar,  
si prej një bregu përballë,  
na mësyn drejt dy anije,  
të pështjellura në flakë  
nga detarët arbëreshë.  
Ato digjeshin me nxit.  
dhe Gramosi i lë të mbyten  
dalngadal' edhe çan gjetkë,  
pa mos ditur se në 'to  
ishte edhe vetë Selimi  
gjithë helm edhe llahtarë,  
por plot fat e jetëgjatë,

se dhe era ia vë përpara  
anijen gërmadhë e flakë,  
dhe Selimin larg e çon.

Trim Gramosi atëherë,  
me gaz t'egër që s'rrëfeket  
pasi i kthen qytetit tij<sup>4</sup>)  
lumturinë që pat humbur,  
që t'i mblidhte shtati forcat,  
shtrihet sipër mbi anije  
dhe këtë e lë të lirë  
që të shkonte nga të donte  
përmbi detin komandare.  
Edhe anija shkoi e hyri  
mes dy brigjesh një të ngushte.  
Buzë saj ish një hardhi  
plot me rrush vlosh dhe më tej  
një shtëpi me derën hapur.  
Shokët e Gramosit vanë  
tek hardhia e mblodhën rrush,  
dhe m'ia sollën që të njomte  
gjoksin kazan të zhuritur  
dhe ca shkuan te shtëpia.  
Kur u ngrys, te e ngushta e huaj  
hëna e përgjysmuar shkrep,  
edhe e vrejtur që prej qiellit,  
Gramosit lart, mbi anije,  
dukej sikur po m'i thoshte:  
«Shiko lart, se jam Julia,

që të doja kaq të madh;  
dhe tani jam këtu lart,  
pasi qiellit iu përdhëmba,  
dhe përdhëmbja është e mirë  
për këdo, se po s'e pate  
edhe ç'ke, shpejt e humbet,  
siç të humba edhe ty unë...  
Edhe brenda kësaj dite  
që mbaron, ti s'u kujtove  
t'ia ndeje dorën për dhëmbjes...»

Trim Gramosi, zonja Vidë,  
(vazhdoi t'i thoshte zogu),  
pasi unë fluturoja,  
përherë e më larg më mbetej,  
dhe nga sytë e mi i fshehur,  
ashtu siç fshihen dhe orët,  
nga të cilat fshihet jeta,  
por i madh si hie e mbrëmjes,  
kur nis zgjatet të mbulojë  
gjithë botën pa kufi.  
Por, siç thanë e dëgjova,  
sa në breg zbritën detarët,  
përnjëherësh që nga kodrat  
aty afër frotë grash  
jo arbreshe e pa opinga,  
dhanë kujën dhe ndaj bregut  
sulen djem, burra të huaj,  
me shumicë edhe përleshen

me detarët e Gramosit.  
Ky ndjen zhurmën e shpejt ngrihet  
dhe zbret të fashitë grindjen.  
Por përpara se t'arrinte  
të merrte vesh shkaknë e grindjes,  
t'huajt për vdekje e goditën  
drejt e n'ije e trim Gramosi,  
si një lis në det përmbysset,  
dhe prej ujrave përpihet.»  
Mbaroi zogu edhe ngrihet  
nga selvia e fluturon,  
e lë Vidën të shastisur...

## X

Shpejt te kopshti zbret, e ulet  
më diell, ballë pallatit,  
ku dritsoret po u hapnin,  
nga dil tymi i thimjanit,  
posi erëkëndje qiellit.  
Pishat, palmat e dafinat  
majë muresh, rreth pallatit  
valëzonin fletëzymta,  
si të vetmet plot me jetë  
edhe në kallkan të dimrit,  
dëshmi se këtu në tokë  
është edhe pavdekësia!

## XI

Dielli ende s'kish lënë bregun,  
kur hyn velagjerë, e lagur,  
anija që pritin zonjat.

Dhe në ballë tyre ndriste  
Vida si një mbretëreshë.  
Sapo prek Selimi bregun,  
kjo shkon përdore ta zërë,  
por një llahtarë e drithtoi  
e si dyllë ia zverdhi ballët  
me sy t'akullt e të huaj,  
me një hije buzëqeshje,  
ai Vidën e shëndeti  
dhe shkoi drejt e në pallat,  
ku të motrat i shëndeti  
po me mallin e njëhershëm...

Mbi një shkëmb që prekte retë,  
ngarkohen mjeshtër e ngrenë  
një pirg vetëm me një dhomë,  
në katrë anët e pullazit  
katër zgavra krejt të hapta.  
Dhe n'atë dhomë të madhe,  
çojnë, veshur e stolisur,  
Vidën, e pas saj dhe shtratin,  
dhe mejtimin se do rrihej  
më çdo kënd prej ere e dielli...  
Ngrirë akull na u gdhi

dhe një plogështi prej ethesh  
i mbërtheu kurm e méndje  
ditën gjithë, e kur erdh nata  
vonë i mposht gjumi qepallat  
dhe e rrëmbejnë dallgë ëndrrash:  
Nga qyteti Vida dilte  
edhe hynte në një dhomë,  
ku mbi shtrat koltrinabardhë  
ndritur lart nga katër zgavra,  
sheh Julien prej ethesh tretur.  
Dyllë e verdhë, me buzët flakë,  
Julia ngrihet dhe plot zjarr,  
në mes krahësh e pushton,  
edhe buzët skuqur flakë  
ua mbërthen buzëvet të saj  
dhe i thëthin me sy prej bishe  
gjithë jetën aqë t'ëmbël.  
E Vida kot po përpiqet  
të shkëputet dhe të zbrapset:  
Si në det vithiset shtrati  
ndënë tokë e llërëzhveshur  
Julia Vidën merr me vete,  
duke kundërmuar vdekje.

Me llahtarë Vida zgjohet,  
dhe, si t'ish dehur prej ajrit  
që po zbrit lart që nga malet,  
shkon ndaj zgavrës dhe ndër veshë  
prej qytetit aq të largët



ndjen, përplasur ndër luginat,  
ushëtimë prej këmbane  
edhe gjuri iu përgjunj...  
Dhe përpara syve saj,  
si palë perdesh të lehta  
që puhiza e lehtë i trete,  
hije njerzish iu shfaqnin...  
Dhe nga qielli tok me dritën,  
zbriste e ëma, zonjë e re,  
i merrte në prehër duart  
e si motrë i fshinte lotët.  
Pastaj mbi kokë i vinte  
një kurorë lule bore  
edhe niste ulërimën  
plot me kuje dhe me gjëmë,  
se nuk shihte asnjë të gjallë  
që me mall e me përdhëmbje  
atë kurm vllastar të Vidës,  
me kujdes t'ia jepte zjarrit,  
që të bukur ende tokës  
t'ia shkëpuste, edhe qiellit  
aq të dliurë ai t'ia çonte;  
dhe këtu vetëm t'iu mblidhnin  
të zhuriturat gjymtyrë,  
edhe me lotë çdo ditë  
t'u vaditnin duke patur  
fytyrën e saj ndër mendje!...  
Me këto mejtime e lotë,

ra si bie një zog i lehtë  
vështrimthellë e pendëplumb.  
Edhe pas atij pallati,  
ku ajo la një kurorë  
dhe një pjesë a krejt vetveten,  
Vida, siç thonë, u bë zog  
dhe qëndroi mbi selvi.  
Në mëngjes puhiza e detit  
që i erdhi prej pallatit,  
sapo u hapën dritësoret,  
nisi e shpupurishi pendët  
dhe nga pallati dëgjoi  
që po flit një zonjë e re,  
që na kish harenë e ngjyrën  
e trëndafilin n'agim:  
dhe Vida-zog mori qiejlin!)

## SHËNIME

Pas botimit të përshtatjeve në gjuhën e sotme të poemave «Këngë të Milosaut» (1974) dhe «Serafina Topia» (1971), me botimin e përshtatjes së poemës «Rrëfime të Arbërit», po u jepet sot lexuesve tanë vepra e tretë poetike e De Radës.

Duke ndjekur po të njëjtat kritere të përshtatjeve të dy poemave «Këngë të Milosaut» dhe «Serafina Topia», edhe këtu kemi marrë për bazë botimin e fundit të vetë poetit, atë të vitit 1848, «Rrëfime (histori) të Arbërit» (pas 1460-ës) botimi Fibreno, Napoli 1848, i cili ndoqi botimin «Arbëria» (prej 1460 gjer më 1485), po i Fibrenos Napoli 1847.

Në këto shënime nuk po japim ndryshimet prej botimit në botim, siç kemi bërë në mënyrë të veçantë për poemën «Këngë të Milosaut», (ku ishte e domosdoshme), pasi nuk na u duk e nevojshme për shumicën e lexuesve.

Si në përshtatjet e tjera, edhe në këtë, duke kërlojtur (manovruar) me kronologjinë, jemi përpjekur që të katër këngët që përbëjnë poemën t'i ndërsuazim (t'inkuadrojmë), sa më afër së vërtetës historike.

Për të vënë më në pah natyrësinë kombëtare, edhe disa antroponime e toponime, duke u qëndruar sa më afër tingujve dhe kuptimit të antroponimeve e toponimeve të përdorura prej poetit, ua kemi përshtatur antroponimeve e to-

ponimeve që kanë qenë ose janë më të njohura, më të përgjithshme ose më afër veshit të lecitësve, ndër arbëreshë dhe ndër ne.

Për t'u shijuar drejtpërdrejt nga lexuesit, vende-vende, ku shprehja poetike, figuracioni ose mejtimi kanë qenë shumë të errët, duke i qëndruar besnik poetit, jemi përpjekur t'i japim më qartë. Në përshtatjen tonë aty-këtu kemi shtëmëngur edhe pak përsëritje ose stërhollime të tepruara jash-të-poetike, filozofike, psikologjike, që të dalin në madhështinë e tyre të vërtetë vlerat e vërteta ideoestetike edhe të kësaj vepre të poetit.

Nga të tre titujt që ka përdorë autori («*Histori të Arbërit*», «*Arbëri*», «*Katër histori*») na u duk më i qëlluar titulli i parë: «*Histori të Arbërit*». Por, pasi poeti fjalën «*histori*» e përdor këtu me kuptimin etimologjik të saj, siç e përdorin në përgjithësi gjithë arbëreshët, (pra, me kuptimin «*tregim*», «*kallzim*», «*rrëfim*»), ne, për ta dhënë më drejtpërdrejt idenë e autorit, këtë fjalë («*histori*») e zëvendësuam me fjalën «*rrëfime*», (pra, «*Rrëfime të Arbrit*»). Mbase do të ishte më i afërt me brendinë titulli «*Vasha të Arbërit*», ose «*Bija të Arbërit*».

Botimin e poemës «*Rrëfime të Arbërit*» poeti e përcillte edhe me një parathënie në italisht. Për rëndësinë e saj, veçanërisht për kohën kur u shkrua (më 1847-1848), po e japim këtu të përkthyer:

«Në pjesën e dytë të shekullit XV, thotë De Rada, pasi otomanët pushtuan Konstantinopolin, një shumicë të parësh të Arbërit, duke u mërguar në Itali me familjet, themeluan bashkësi që sot arrijnë në më tepër se njëqind mijë frymë. Këto ruajnë zakonet, kostumet, gjuhën, besimin e prindërve.

Jeta e këtyre bashkësive arbëreshë rilulëzoi në kushte të një përnguljeje paqesore dhe larg çdo dange, kurdoherë plot me frymë, ndjenja, mejtime pellazge të thjeshta e të

rrepta, e pacënuar asnjëherë nga fryma, ndjenjat, mejtimit e banorëve fqinjë.

Gjuha që flitet në këto bashkësi, arbërishtja, është e beгатë në tinguj sa edhe greqishtja dhe po aq e përplotë në mundësitë e brendshme të zhvillimit të saj; në format gramatikore shtrihet ashtu siç shtrihen edhe gjuhët e lashta japetike e semitike të marra së bashku.

Po stolia më e lartë e këtyre arbëreshëve është besimi se janë një popull dhe një kombësi e veçantë. Ky besim i mbajti kaq të shëndoshë dhe të lidhur me njëri-tjetrin për katërqind vjet. Te ky besim e ka burimin edhe bindja se atdheu i tyre, Arbëri, i goditur rëndë nga theroritë e tij për Evropën kristiane, do të krijohet sërishmi...

Duke parë Italinë, që bashkë me ta vuante (dhe që tani, me qetësinë e një mbretëreshe që zgjuhet pas një gjumi të gjatë po hyn në një epokë të re), këta arbëreshë kujtojnë të kaluarën dhe në zemrat e tyre e ndiejnë se edhe për ta është e afërt një rizgjim i tillë. Dhe të gëzuar shikojnë që në mes tyre ka filluar lëvrimi i gjuhës arbëreshe, gati sikur këtyre u bie barra që ta shkundin Arbërin të përtërijë jetën aq bujare të lashtë, ashtu siç prindët e këtyre bijve të Arbërit qenë në pjesën më të madhe prijës të Arbërit në betejat e lavdishme të lirisë në shekullin XV.

Vetë qielli, që i vuri në sprovë të rënda të zezash e mjerimesh edhe në këtë dhe të huaj, këta arbëreshë sot i ngriti në luftërat për liri. Pra, mbaroi koha për njerëz të huaj që të dërgojnë si përpara këshilla qëllime të këqia në Arbër, për ta sflitur dhe përdhosur me anë përlëshjesh të përgjakshme pa synime të vërteta kombëtare.

Mbaroi koha për të huajt, sepse sot e tutje do të jemi ne (arbëreshët, shqiptarët), që, duke e dashuruar me gjithë zemër Arbërin, Shqipërinë, do t'i themi të vërtetën, do të mbrojmë virtytet, do ta çojmë Arbërin drejt madhësisë së

tij. Nuk do të kalojë shumë kohë e, ashtu siç më në fund rilindi Greqia, edhe nga dega më e parë e më e pastër e trungut pellazg (nga dega arbëreshe, shqiptare) do të shkëlqejë në mes të popujve kurora e saj e lashtë zemërbardhë, sepse kjo degë ka brenda saj të gjitha vlerat, dobinë e sasisë (si popull) virgjërinë e gjuhës, mungesën e një kulture të mëparshme (të papërshtatshme, të huaj) kurdoherë të dëmshme për zhvillimin e lirë dhe origjinal të aftësive mendore dhe artistike të (njerëzve dhe popujve).

Pas kësaj parathënie të shkëlqyer, nis poema e ndarë në katër këngë, të cilat mund të trajtohen edhe si katër poemthe (novela) më vete.

## KËNGA E PARË

MIRANA ARIANITI

*Mirana, bijë e dukës së Kotorit, nga fisi i Arianit — Golem-Kommen ose Kominiat-Topiajve, fill pas vdekjes së kryefatosit të Arbërit, Gjergj Kastriot Skënderbeut, martohet prej të atit me admiralin venedikas, Vanierin, me shpresë se Venediku do t'i bëhej krahë për mbrojtjen e pushtetit të tij në Kotorin e vënë në rrezik nga otomanët turq. Kotori pushtohet dhe çlirohet përsëri nga forcat arbëreshe të vendit dhe vëcanërisht nga ndihma që i shkon prej Artës, Delvinës, Ohrit, kurse flota venedikase bëhet për e gjallë vetëm pasi ka mbaruar lufta. Mirana, pasi ndahet nga e motra, Dilina, shkon bashkë me Vanierin në Napoli. Atje, në një pritje me mbretëreshën, Vanieri has Garentinën, të bijën e dukës së Venedikut, e fejuara dhe gati gruaja e tij, të cilën e ka tradhtuar. Mbretëresha dhe Garentina gjatë vizitës në anijen admiralet, sapo shikojnë Miranën, mbeten të habitura përpara*

bukurisë së saj krenare dhe kuptojnë marrëdhëniet Vanier-Mirana. Mbretëresha, kriminele dhe epsheshthurur, duke dashur që të plotësojë teket e saj epshore me Vanierin bukurosh, i paraqitet si mbrojtëse Garentinës. Dhe në pallat kurdiset komploti për zhdukjen e Miranës, e cila mbaron e mbytur në det.

Veprimi zhvillohet në Kotor, det, Napoli-verë 1468.

Mirana Arianiti = në tekst: «Anmaria Kominiate». Pasi emri «Anmarie» nuk është i përhapur as në arbëreshë, as ndër ne, duke u mbështetur në frajtën e njohur «Mira» për «Maria» dhe duke hedhur nga përpara mbrapa emrin «Ana» të kësaj kompozite, e bëme «Mirana». Emri «Mira», në të njëjtën kohë, si ndër arbëreshët dhe ndër ne, është parakristian dhe ka të bëjë me «E mira», «Të mirët» (e Tomorit). Në arbëreshët «mira» quhet edhe «fata» (ora e fatit, sipas mitologjisë). Kujtoni veprën e Santorit «Emira» dhe emrin e t'atit të protagonistes «Mirianit». Mbiemrin «Kominiate», pasi nuk është shumë i popullarizuar dhe, në të njëjtën kohë, sipas Barletit është me prejardhje «latine» (M. B. «Historia e Skënderbeut», Tiranë 1964, f. 92), e thjeshtësuam në «Arianiti». Nuk përdorëm mbiemrin «Topia» sepse, sipas poetit, Topiajt sundonin kryesisht në Arbërin e Jugut, ku përfshihej edhe Arta. (J. De R. «Serafina Topia», Tiranë 1971), kurse Arianitët, farefis i tyre, sundonin në Arbërin e Veriut, ku përfshihej edhe Kotori. Pra, bregdeti adriatik — jonian, prej Grykave të Kotorit në Gjirin e Artës ishte arbëresh. Që Kotori përfshihej në shekullin XV gjeografikisht brenda Arbërit, kjo vërtetohet edhe nga burime dokumentare. (USHT — «Historia e Shqipërisë», vëll. 1, Tiranë, 1967, f. 170).

## I

1. *Kotori* = «Rizanoni» i vjetër ilir, më vonë i quajtur «De-katera» dhe pastaj «Kotor», në mesjetë ka qenë qendër dukati, ku përfshiheshin toka të Arbrit bashkë me qytete të Dalmacisë. Më përpara kjo qendër ka qenë në Shkodër. («*Historia e Shqipërisë*», vëll I f. 186). Ky qytet ngrihet në rrëzët e malit Lovçen
2. «*me bucela e grihë shpatash*» = Arbëreshët, sipas poetit, jo vetëm u çojnë ujë të plagosurve, por mprehin edhe shpatat e luftëtarëve.
3. «*prej anijesh venedike*» = Këtu shohim goditjen e parë të poetit kundër venedikasve: edhe pse «zbardhëllon deti prej anijesh venedike», turqit as që çajnë kokën për ta.
4. «*se prroiti i Kotorit*» = Se porti i Kotorit.
5. «*që e lavdonin këngë e valle*» = Bozdar Shtresi, nip i Skënderbeut, kryefatosi i Artës, për poetin ishte shumë i njohur, pra, i kënduar edhe në këngë e valle, goftë prej popullit, goftë prej vetë poetit (në poemën «*Serafina Topia*»)
6. «*edhe bindet se Vlladeni*» = Dilina, motra më e vogël e Miranës, e shqetësuar për shëndetin e të fejuarit të saj të plagosur, Vlladan (Vllastar, Vlash) Zënëbishës, prijës i Delvinës duke shkelur zakonet arbëresh për të fejuarat, në vend më të largohej, i afrohet «gati në frymë e fytyrë», Vlladani.
7. «*nusja e Dukëgjinit*» = Serafina (Fina) Topia, protagonistja e poemës omonime që dashurohej me Bozdarin, por që, duke iu bindur prindërve për interesa të larta patriotike, martohet me Nik Dukëgjinin.

## II

1. «*dhe nga toka shquhet ujët*» = Çastet kur sapo fillon agimi i parë, kapërcimi nga nata në ditë.



2. «*lart zantri, tamburë arbër*» = Lart ishin forcat arbëreshe, poshtë ishin forcat otomane. (zantri = bori).
3. «*velin korb*» = Velin, cipën e zezë të vdekjes.
4. «*zemërgurja e pabesë*» = Këto fjalë të Bozdarit janë vetë bindje e poetit se Arbëri (Shqipëria) çlirimin dhe mbrojtjen i pret nga bijtë e bijat e vet edhe askurrë nga Italia, Evropa e pabesë.
5. «*t'anës s'andejme të qiellit*» = Sarkazmë tjetër e poetit ndaj venedikasve.
6. «*gjithë qenieve pa mbrojtje*» = Këtu sarkazma bëhet shumë e fortë kundër venedikasve, të cilët «zgjohen» vetëm pasi ka mbaruar lufta dhe predhat që duhej të përdoreshin kundër armikut të përbashkët, otomanit, tani përdoren për të vrarë peshqit në funde të detit.
7. «*ku përpara shkrepje agimi*» = Këtu kemi shenjën e parë të shqetësimit të Miranës, për kalimin e saj nga vashë («gërsheta lidhsa bardhë») në nuse te Vanieri. Në Venedik si familje aristokrate njihet familja «Venieri». Këtë ne jemi të mendjes se poeti e ka ditur, dhe shtrembërimin e lehtë nga «Venieri» në «Vanieri» e ka bërë me qëllim, pasi «vano» në italisht do të thotë «i zbrazët», «i kotë», «mendjelehtë», pra, për poetin admiral Vanieri është admiral «mendjezbrazëti». Poeti, në krijimtarinë e tij, edhe këtyre hollësive gjuhësore u jepte rëndësi.

### III

1. «*dhe në flakë, e bënin hi*» = De Rada, në krijimtarinë e tij, parapëlqen ritin e djegies së kufomave si në lashtësinë pagane, se sa varrosjen që përdor zakonisht kristianizmi.
2. «*boritë rënë për mallin*» = Meloditë ndërshtjellojnë (interpretojnë) dashurinë e qyteteve ndaj luftëtarëve të tyre, të dërguar për çlirimin e Kotorit, pra ndihen edhe këngë të

Artës, të Ohrit dhe të qyteteve e krahinave arbëreshe që kanë dërguar djemtë e tyre në luftën për çlirimin e Kotorit.

3. «*me mejtime plumb Bozdari*» = Me mejtime të rënda, të shqetësuar për zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme në Arbër. Por këtu poeti mbase jep një shenjëzim (sinjalizim), me anë të parandjenjës së vetë Bozdarit për fundin e tij tragjik fill pas kthimit në Artë, ku vritet nga rrufeja («*Serafina Topia*», Tiranë 1971 f. 202).

#### IV

1. «*dhe pekanët kur i gjenin*» = Dhe çarçafët (kur i gjenin)
2. «*përballë erës ca fërrere*» = Lodër fëmijësh si «mulli ere» që vihet kundër erës dhe bën zhurmë. Mbase nga: fërr-ere.
3. «*pikëllimthi, edhe nga fqinjët*» = E pikëlluar, e pangushëlluar ndahej jo vetëm nga vendlindja, po edhe nga fqinjët, shoqet e fëmijërisë dhe rinisë së saj.
4. «*dhe bulqizat e shtëpisë*» = Dhe çifliqet, tokat bujqësore të shtëpisë.
5. «*e nojtëshë mbi të gjitha*» = E mençur mbi të gjitha.
6. «*që nga ballshi*» = Që nga bashi (ballësi) i anijes.
7. «*dëndësore, lartullore*» = Të dendura dhe të larta.
8. «*dhe Mirana ra përshtrulli*» = Bie mbi dysheme
9. «*edhe një të qetëm vdekje*» = Edhe një qetësi si prej vdekjeje.

#### V

1. «*por në gjì visar do kisha*» = Vasha e kësaj kënge të lash-të me vetëdije nuk pranon për burrë asnjë bir fisnikësh, po kositësin e barit, të cilin e cilson si «visar në gjì» të saj.
2. «*katër herë dha rrush larza*» = Kaluan katër vjet (katër

herë dha rrush hardhia e egër) dhe nusja «ra» (vdiq) në kohën e kallëzave, në qershor-korrik.

3. «*dhe q'andej faneps një mirë*» = Dhe nga mesi i grurit shfaqet një fatë, një orë e fatit.

4. «*namëta i biri i mbretit*» = Në çast, përnjëherësh i biri i mbretit.

## VI

1. «*mes pyjesh plot qe dhe zjarre*» = Anijet kalonin aq afër bregdetit italian të afërsive të Napolit, sa dukej sikur nuk kalonin detit, po një lumit në mes fushash plot qe dhe brigjesh plot pemë e drurë si pyje. Fjala «zjarre» mund të merret: a) si zjarre të zakonshme; b) si zjarre me anë të të cilëve bujqit digjnin çfarë kishte mbetur në ara pas të korrave dhe përpara lërimeve të vjeshtës; ose c) me fjalën «zjarre» këtu poeti mund të ketë pasë përpara syve vetë tokën vullkanore të zonës së Napolit, me Vezuvin në krye. («Vezuvin» poeti e quan *Dhezuri* (i ndezuri), pra, edhe këtij emri i jep prejar-dhje pellazge-arbëreshe).

2. «*përmbi bumbuj dallgësh gjegjen*» = Anijet që ishin mbi dallgë përcillnin bubullimën, zhurmën e gjëmimeve të topave.

3. «*dhe shikojnë djemtë e fqinjve*» = Sulm i poetit kundër martesave të zakonshme në rrethet e aristokracisë, të cilat, duke mos pasë në themel të tyre dashurinë e shoshoqme (reciproke) janë të mbarsura me rrezikun e tradhtive të shoshoqme dhe me dashurira të përkohshme me djem të fqinjve.

4. «*për ti qojtur*» të martuar» = Sipas poetit sa më lart të ngjitesh në rrethet e aristokracisë gjer në pallatin mbretëror, aq më të përgjithshme janë lapërdhia dhe imoraliteti, aq më shumë hidhet valle hipokrizia e «gjethes së fikut». Për të maskuar a përligjur në sy të botës këtë lapërdhi mjaftonte

një shenjë, si një të hedhur dore në mesin e një vajze, që të quheshe «i martuar» dhe pastaj mund të bëje çfarëdo lapërdhie, pa të hyrë ferrë në këmbë në sytë e botës.

5. «*qëndron Mbretëresha e sheh*» = Në krye të të lapërdhosurve (të të korruptuarve) qëndronte kryerrosia dhe kryekriminelja, Mbretëresha, Poeti një herë përmend edhe emrin e vërtetë të mbretëreshës që ka pasë përpara syve, atë të Joanës së Napolit. Por ne e hoqëm emrin për tri arsye: E para, sepse Joana, figurë e njohur për poshtërsitë dhe krimet e saj, në kohën kur zhvillohen ngjarjet e kësaj kënge kishte gati një shekull që kishte vdekur (ajo mbretëroi gjatë viteve 1343-1382). E dyta, sepse Joana ishte e Shtëpisë mbretërore Anzhu, kurse në kohën kur zhvillohen ngjarjet e kësaj kënge sundonte Shtëpia e Aragonës. Arsyeja e tretë edhe më e forta: sepse, si rregull, bijat e aristokracive të vjetra parasitave, edhe kur bëhen mbretëresha, kush më shumë e kush më pak, thuhet të gjitha nuk i kanë lënë dhe nuk i lënë gjë mangët Joanës së Napolit, në mos në krime, të pakën, në epshe të shfrenuara dhe në intriga.

6. «*dhe së bijës së Foskarit*» = Garentina është bijë e dukës së Venedikut, Foskarit, e fejuara «gruaja» zyrtare e Vanierit. Emri «Garentina» nuk është dhe nuk ka qenë shumë i përhapur, me aq sa dimë ne, në Itali. Përkundrazi, në folklorin tonë ky emër zë një vend nderi. (Në legjendën «Kostantini dhe Garentina»). Pra, për një ngjyrësi më italiane, poeti mund të kishte zgjedhur një emër më të përgjithshëm në onomastikën italiane, si f. v. Valentina. Por, duke e ditur se De Rada, si kemi thënë edhe gjëtkë, tregohet shumë i vëmendshëm edhe nga kjo anë, ne mejtojmë që këtë emër e ka zgjedhur, ose sepse mund të jetë mbështetur në ndonjë ngjarje të vërtetë, që ne nuk e njohim, ose sepse (dhe kjo ka më tepër mundësi), emrin Garentinë e ka zgjedhur me dashje, pasi kjo Garentinë venedikase edhe pse aristokrate, është

ende një vashë e pastër, viktimë e Vanierit dhe e Mbretëreshës. Pra, edhe pse antagoniste e Miranës, ka disa cilësi që e afrojnë me Miranën, megjithëse jeton në rrethe prej të cilave nuk ka ç'të pritet gjë e mirë. A merr kjo pjesë në komplotin për zhdukjen e Miranës? Poeti nuk na thotë gjë për këtë. Por na lë të kuptojmë se mbi dyshen Mbretëreshë-Vanier bien të gjitha përgjegjësitë për zhdukjen e Miranës.

7. «*sa kisha dalë / prej kafazit*» = Garentina rininë e saj e kishte kaluar si nxënëse brenda kafazeve të manastirëve të murgeshave.

8. «*tiravolet e rrugenjtë*» = enë ku bëhet djathi prej barinjve e bareshave.

9. «*vasha Psike / në pikzore grekërie*» = Psike, vashë e një bukuri të rrallë në mitologjinë greke, e dashuruar prej Erosit (hyut të dashurisë). Afërdita, nga zilia, e vrau, por Zeusi e ringjalli dhe e bëri të pavdekshme, duke e ngritur fluturimthi nga toka në Olimp si shoqe të Erosit. Miti i Psikes frymëzoi jo vetëm artistët e lashtësisë («pikzoret», pikurat e grekërve), shkrimtarë romakë, si Apulein, por edhe të tjerë shumë më vonë, si skulptorin frëng Pradier, piktorin, po frëng, Prydon, shkrimtarët Molier e Kornej (për një tragjedi-balet) e mjaft të tjerë. Ky mit frymëzoi edhe De Radën, i cili përmjet figurës së Psikes na jep figurën e një gruaje të gjallë tokësore nga më të goditurat (në «*Skënderbeu*» II, 4 në «*Rënia e Rigatës së Arbërit, II, 4*) Për emrin e mbiemrin «grek», «grekërie» De Rada në shënimet në fund të poemës shkruan: «Mua më shkon mendja se zënëfillja e errët e emrit krejt latin «Greci ose «*Grai*» duhet të jetë në pellazgo-arbërishten «Gra», pasi helenët aziatikë, me format, gjuhën, kurmin e hajthëm të tyre, mund t'u jenë dukur pellazgëve titanë më tepër si gra (se sa si burra)».

10. «*një zonjë/e ponishme*» = një zonjë e sjellshme, plot nderime dhe e nderuar.

## VII

1. — «*dil e prite me seni*» = dil e prite me ngrohtësi mik-pritjeje.
2. — «*për të ndarë / valë shoqe*» = për të prishur dashuri dyshesh (çiftesh).
3. — «*shokë vetëm nëpër shqotat*» = Vetëm në rreziqet e luftrave, aristokratët bëhen popullorë dhe të afërm me ushtarë e detarë, por sa mbarojnë rreziqet dhe fillojnë përfitimet e argëtimit, ushtarëve dhe detarëve u kthejnë kurrizin me përbuzje. Një prej detarëve të tillë të përbuzur është edhe plaku spanjoll, i gjymtuar në luftrat me otomanët, për lavdinë e kryqit; (kuptoni: për feudalizmin monarko-kishtar evropian). Dhe kryqi «i shenjtë», as që pyet më për 'të, ashtu siç nuk pyesin as aristokratët feudalë.
4. — «*të një dite Virgjëreshe*» = të një dite feste për Virgjëreshën; mbase me dy kuptime: më të ngrysur të një dite për Shënmrinë, ose edhe më të ngrysur të ditës së fundit të vashës Miranë.
5. — «*zallit ku iu derdh dhe gjaku*» = Roma mbaroi kur nisi të pushtonte vendet e tjera, kryesisht, përtej deteve.

## IX

- I. «*lazanjarët lukuni*» = Lazaronët e Napolit, lypësit, llumpen-proletarët e Napolit në frota të mëdha.
2. «*prehrit Banit, gjithësisë*» = Sipas shënimeve të poetit në fund të poemës, hyjnisë «Pan», emrin më tepër se nga fjala greqishte «pan», *krejt, tërësi*, duhet t'ia gjejmë në pellazgo-arbërishten, «ban», *bën prodhon dhe bana* = e bëra të bërët, krijimi. Pra, edhe emri i *Panit* ndërrohet prej poetit në *Banit*. Për poetin fjala *Pan* shpreh të qenët në moslëvizje, kur-

se fjala *ban* shpreh të bërët, veprimin në lëvizje të pandërprerë, *pan* shpreh statikën, kurse *ban* dinamikën e jetës, e gjithësisë, lëndën në lëvizje.

3. «*dhe fryn jashtë e i ndezi ëndjet*» = dhe mbretëresha del me nxitim jashtë dhe kështu nxit, ndez ëndjet e të pranishmëve në sallë, sepse me largimin e saj, nisin të bëhen më të guximshëm valltarë e valltare në flirtet në mes të tyre.

4. «*prej krahësh i heq pashnikun*» = Vanieri i heq mbretëreshës prej krahësh mbulesën e hollë, shenjë se epshi po bënte punën e tij në mes të tyre dhe ky epsh i nxjerr që të dy jashtë sallës.

5. «*atje një trim e një vashë*» = Kontrast i fortë në mes skenës së lapërdhosur të sallës së pallatit dhe skenës së pastër jashtë në mes të një trimi dhe një vashë nga populli.

## XI

1. «*për ditën q'i hapi plaka*» = Ardhja e plakë Lenës në mëngjes herët i jep të kuptojë Miranës se po niste për të një ditë helmi të pasosur.

## XII

1. «*hanin qetësisht mursillën*» = hanin pasmesditën, zemrën, zemërimin.

2. «*ç'të na bëjnë as ujra detesh*» = Poema mbyllet me notat e një tragjedie optimiste: Mirana, edhe e mbytur në det, e ndien veten panteistikisht si pjesë përbërëse të gjithësisë kurdoherë në lëvizje e veprim dhe me qëndrimin e saj në jetë lë, ashtu si e kushërira, Serafina Topia, shembullën e mirë, andaj edhe për të «prej sheshesh/të botës shumë të largët/zienin këngë plot hare».

## KËNGA E DYTË

DILINA ARIANITI

Kanë kaluar 24 vjet nga zhvillimi i ngjarjeve të këngës së parë dhe motra e Miranës aq e dashur dhe e hedhur, Dilina, në dallgët e mëdha të viteve, jo vetëm është rritur e martuar, por, pas rënies heroike në betejat për mbrojtjen e Arbërit të të shoqit, prijësit Vlladan Zënëbishës së Delvinës mbi shpatulla të saj, kanë rënë edhe barrët e rënda të drejtimit të vendit, të shtëpisë dhe të edukimit të së bijës, Dinës, në kushtet e pushtimit të paduruar otoman. Është duke u gdhirë dita e 25 dhjetorit të vitit 1492 dhe Delvina, në kuadrin e së kremtes së kërkshëndelleve, buçet jo si zakonisht nga gërneta e bibizane. Dilina e zgjuar ngre edhe të bijën, Dinën, dhe teksa ia veshin vajzën, vetë del në prag të derës, shikon, e kujton të kaluarën dhe pastaj menjëherë kthehet brenda, merr përdore të bijën dhe, për të parën herë të bijën njëmbëdhjetëvjeçe e çon në një sallë, që mbahej kurdoherë e mbyllur. Atje Dina sheh në një sërë pikzoresh (tablosh) çaste nga më heroiket e historisë së Arbërit, që prej vdekjes së kryefatosit të kombit, Skënderbeut e gjer te vdekja e kryefatosit të Delvinës, të atit të saj, Vlladanit në mbrojtjen e Delvinës (1491), pasi kishte marrë pjesë edhe në luftëra të tjera, si në atë të mbrojtjes së fundit të Krujës (1478). Pasi shikojnë me radhë gjithë pikzoret, Dilina, shumë e zbetë, ulet për t'u çlodhur dhe teksa dremet, i shfaqet i shoqi, i shqetësuar shumë edhe për rrezikun që i kanoset së shoqes nga prania e otomanëve. Dilina zgjohet, del nga salla me të bijën dhe tek po zbriste shkallët, e tronditur siç ishte nga ëndrra dhe kujtimet e së kaluarës, rrëshqet, duke rënë mbi një gur me majë dhe vdes.

Këtu mbaron kënga e dytë, ngjarjet e së cilës zhvillohen



brenda pak orësh të natës duke u gdhirë 25 dhjetori i vitit 1492.

*Dilina Arianiti* = në orgjinal emri i kësaj kënge është «*Nata e Natalevet*» dhe emri i protagonistes është «*Delia*» = «*Delja*» Pasi në këtë poemë tre nga të katër titujt e këngëve i ka me emra të përveçëm vashash, ne edhe për këtë këngë pëlqyem emrin e protagonistes jo vetëm nga ana formale, po edhe për shkakun e vazhdimësisë prej kënge në këngë, nga motra Mirana Arianiti te motra e saj Dilina Arianiti. Emrin nga «*Delja*» e bëmë «*Dilina*», sepse: a) Emri *Dele-Delja* për njerëz, me sa dimë, nuk ka qenë dhe nuk është i zakonshëm, as në arbëreshë, as ndër ne. b) Sepse De Rada emrin «*Delja*» nuk e përdor në kuptimin e «*dele-delja*» (nga bota e kafshëve), po kryesisht në kuptimin «*djelë-djela*», nga «*diell-dielli*» (nga bota e hyjësive qiellore). Në shkrimet e tij filologjike emrin e ujdhezës së Greqisë «*Dylos*» (Delos) poeti e nxjerr nga pellazgo-arbërishtja «*dili-dielli*». (Po nga emri i kësaj ujdheze edhe Dianës i jepej epiteti «*Delia*» Por në kuptimin etimologjik të De Radës, si arbëreshët si ne, kemi pasë dhe kemi shumë të përhapur për njerëzit emrin *Dilë*, *Dilinë*, *Dilushë*, në arbëreshët edhe formën: *Diell-a*. Të gjitha këto forma kanë lidhje drejtpërdrejt me «*diellin*». Kaq është e vërtetë kjo, sa që në arbëreshët emri me origjinë italiane *Domenika* nuk arbëreshizohet në mënyrë mekanike, duke u nisur nga kuptimi etimologjik i fjalës «*domenica*» (nga latinishtja «*domenica* = ditë e zotit, e perëndisë), por duke i vënë përballë emrit të ditës së shtatë të javës «*domenica-s*» italiane, emrin pagan arbëresh të së njëjtës ditë, të «*ditës së diellit*»; pra, emri i grave italiane *Domenika* arbëreshizohet me *Dila*, *Dilina*, *Dilusha*,

# I

1. «*kjo s'përkulet edhe pret*» = Delvina edhe ndënë zgjedhë nuk nënshtrohet po pret ndryshimin e gjendjes. Gërneta e bibizant, pipzat, boritë, me buçitjen e tyre të jashtëzakontë, ishin shenjë se diçka do të ngjiste së shpejti. Poeti nuk na e thotë. Por, edhe pse këtu kemi të bëjmë me një krijim poetik, ku poetit i njihet e drejta edhe të mos i qëndrojë besnik kronologjisë së ngjarjeve, prapëseprapë këtij pohimi të De Radës i vjen krejtësisht në ndihmë edhe historia, e cila na dëshmon se Delvina, e mbështetur tradicionalisht në miqësinë luftarake të labo-bregdetasve (himarjotëve) edhe pas rënies së Krujës (1478) dhe rënies së Shkodrës (1479) u bëri ballë sulmeve otomane për shumë vjet të tjera. Kjo përkohësisht u pushtua nga sulltan Bajaziti vetëm në vitin 1492, pra, në kohën kur zhvillohen ngjarjet e kësaj kënge. Por shumë shpejt, pra, mbase pas zhvillimit të ngjarjeve të kësaj kënge çlirohet përsëri dhe qëndron si e tillë me një ndërprerje të shkurtër gjer në kohë të sulltan Sulejmanit (1520-1566), konkretisht, gjer në vitin 1537, kur ky sulltan, me anë të Ajaz Pashës, arbëresh atdhemohonjës (renegat) nga Palasa e Bregdetit, e pushton përfundimisht.

2. «*ajo s'gjet një gjurmë shprese*» = Dilina, edhe në një atmosferë të tillë të qytetit, për veten e saj nuk shikon ndonjë shenjë të mirë ndër yjet, apo në yllin e saj. (Mos harroni se jemi në shekullin XV kur besimi në yjet, (në astrologjinë) vazhdonte të ishte i fortë.).

3. «*një kujtim i ëmblë i largët*» = ndoshta ky kujtim kishte të bënte me dashurinë e parë të saj me Vlladanin.

4. «*dhe pandehte se kjo botë*» = Djaloshi nuk besonte se ngjarjet do të rrokulliseshin si u rrokullisën gjersa erdhi edhe koha të ndodhemi ndënë zgjedhën e barbarëve otomanë.

5. «*dhe shkëlqimi habit Dinën*» = poeti kaq rëndësi të madhe

për edukimin patriotik u jep traditave, kujtimeve të lavdisë së të kaluarës, saqë në çdo shtëpi prijësi vendos edhe një sallë-mauzoleum, një sallë-muzeum, ku ruhen si në një tempull kujtimet më të shtrenjta, shtatorre, pikzoret (tablo pikturë), armë, armatime, veshje e të tjera si këto.

6. «*Emri i saj ishte Mirana*» = Me anë të pikzores së Miranës poeti e lidh bukur këngën e parë me të dytën, ashtu siç bën edhe me Dilinën e Vlladanin, të cilët i shikojmë që në këngën e parë. Një mënyrë të tillë poeti e përdor për të ndërlidhur jo vetëm këngën me këngë të një vepre, por edhe veprën me vepër. Kështu në poemën «*Serafina Topia*» ai na përmend protagonistin e poemës «*Këngë të Milosaut*», kurse në këngën e parë të poemës «*Rrëfime të Arbërit*», na nxjerr njërin prej protagonistëve të poemës «*Serafina Topia*», Bozdar Shtresin, të nipin e Skënderbeut. Po me anë të kësaj pikzoreje poeti na thotë edhe se Miranës së vdekur me bren-gën e madhe se arbëreshët dhe Arbëria nuk do t'ia falnin kurrë fajin e rëndë që u besoi premtimeve të një latini, jo vetëm ia kishin falur atë faj, por Miranën e kishin rreshtuar edhe në radhët e figurave simbole të lavdisë arbëreshe.

7. «*me pekan të bardhë sipër*» = Mbi truporen e Skënderbeut të shtrirë mbi tryezë prej mermeri, pekani (çarçafi) i hedhur përsipër *mbase prej të huajsh*, na tregon tërthorazi se të huajt, (qofshin këta turq, qofshin venedikas), bënin çmos që ta shtëmëngnin nga kujtesa arbëreshe figurën e madhe të Skënderbeut, e cila për arbëreshët në atë kohë mbahej si e shenjtë. Nëse hipoteza «*mbase hedhur prej të huajsh*» do të ishte pa baza, po vetëm një dyshim i poetit, atëherë mund edhe të mejtohet që ky pekan të kishte qenë hedhur përsipër nga vetë arbëreshët për ta ruajtur si truporen e një shenjtori, si ka qenë zakon ndër ne.

8. «*mbase zbret frymë e tim shoqi*» = Mbase shembulla e tim shoqi e Vlladanit, delvinjotët i ndez dhe i hedh në luftë për çlirim.

9. «*Fjala «dashuri» ndër njerzit*» = Poeti me anë të fjalëve të mirës (orës-së fatit, fatës) këtu tregohet jo vetëm realist, por edhe me frymë të theksuar klasore: ai na thotë se fjalët «e dashurisë» kristiane nuk pinë ujë, gjersa mbeten vetëm fjalë dhe masat e skamësve të qytetit dhe të fshatit vuajnë, kurse bujarë e kamës mahen. Nëse duam bashkim në luftë për çlirim, atëherë bujarë e kamës duhet të vëllazërohen me masat skamëse me të vërtetë «rreth një vatre si familje» dhe së toku të keqen ta përballim. (Shihni pak më poshtë zhvillimin e kësaj ideje). Ndryshe, edhe neve arbëreshëve, do të na ngjasë si të tjerëve. (Kujtoni skenën e detarit plak spanjoll në këngën e parë, i cili është katandisur për ibret, teksa bijtë e aristokracisë, komandarët e tij notojnë në begati dhe në argëtime.).

10. «*Sërish, pellazgët e lashtë*» = Poeti, i zhuritur nga malli për t'u kthyer sërish në atdheun e stërgjyshërve tok me gjithë të mërguarit arbëreshë, me sytë e mendjes sheh Arbërin e së ardhmes së afërt «lulembushur», «gjirin plot me zogj të lumtur», «kundrejt detit të kulluar», si një «det prej brigjesh mbrojtur nga çdo shqotë», ku të gjithë «do ngazllojmë!»

11. «*grisur rrzhagash shkrepëtimash*» = grisur nga plagë, të shqyera, fasha shkrepëtimash.

12. «*naks i dheut, shkrepëtima*» = të gjithë e të gjitha, aty edhe naksi, (mëria, zilia, nakari i dheut), ishin hedhur në sulm të asgjësonin trimin arbëresh (Vlladanin) por ai të gjithë e të gjitha i mundi, sepse e dashuronte aq shumë atdheun edhe në mjerimet që kishin pllakosur, saqë kurrë nuk do t'i ndahej, edhe sikur po t'i jepnin «si dhuratë gjithë botën!» (shikoni pak më poshtë).

13. «*që iu duk se në syonat*» = Që iu duk se në figurat, pamjet.

14. «*mbi një bosk me shkultën lart*» = Mbi një bosk, ose boskë, lotore me shpatën, stemën lart.

15. «*do pastrohen merimagash*» = Do të mbetën të shkreta

dhe të ndyra, se do t'i marrin ndyracakët otomanë dhe me ty do të bëjnë çfarë të duan. (Shikoni më poshtë).

## II

1. «Këtu isha, dhe te jot ëmë» = Dadë Lena, kjo figurë e thjeshtë fshatareje, motër shpirtërore e Eumeut të «Odisesë» homerike, që iu gjend si mëmë e vërtetë Miranës në çastet më të rënda e tragjike në det e në Napoli (në këngën e parë), merret vesh se është kthyer në Arbër, ka kryer porosinë që i kishte dhënë Mirana; ka ardhur nga Kotori bashkë me Dilinën në Delvinë dhe vazhdon të kryejë detyrën e dadës me vajzën e Dilinës, Dinën.

2. «N'agim mbrij në Moroyll» = Në origjinal ky toponim është «Moroi». Poeti jemi të mendjes se këtë mund ta ketë marrë nga Pukevili. Në veprën e tij «Udhëtime», ky përmend një fshat me emrin «Mauroli», «Moroli» në afërsi të Butrintit, ku, ashtu si Vladani i poetit, edhe Ali Pasha, në kohë të Pukevilit «kishte vendosur shatorret e tij», «pasi ishte bërë zot i Prevezës». (F. Pouqueville — *Voyage... en Albanie*, Tome III, Paris, 1805, f. 16). Kjo betejë me turqit, sipas fjalëve të Lenës, është bërë kur lindi Dina pra njëmbëdhjetë vjet përpara.

3. «ç'bën trille?» = Pse bën naze?

4. «Shkallët zbret edhe mban cohën» = Mban me dorë pallton, manton për të mos iu zhgëryer për shkallësh.

## KËNGA E TRETË

### DINA ZËNEBISHA

Në vitin 1497, otomanët pasi me ndihmën e venedikasve, kanë arritur të dëmtojnë lëvizjet kryengritëse në bregdetin

labo-himarjot dhe në rrethin e Durrësit, nisin boenat (ekspeditat) ndëshkimore; fillojnë të ndreqin rrugët përmes Ballkanit Jugor dhe Arbërit në drejtim të Jonit dhe Adriatikut dhe nisin të ndërtojnë një flotë të madhe për të zbarkuar në Itali. Në këto rrethana mund të ketë rënë përkohësisht për të dytën herë edhe Delvina. Ka ardhur pranvera dhe të Dielën e luleve Delvina paraqitet e zyrtë. Rrugëve bredhërijnë më kuaj katër bijtë e pashait të Janinës. Gratë qenë mbyllur në shtëpitë e tyre. Dina, e bija e Dilinës dhe Vlladan Zënbishës, pas më tepër se katër vjetësh zie për vdekjen e s'emës, pranë një dritareje nga ana e rrugicës nga nuk kalonte njeri, rregullonte gërshetat. Mirëpo andej kalon mbi kalë njëri nga djemtë e pashait. Ky, i rrëmbyer nga bukuritë e kësaj vashe, tani gati gjashtëmbëdhjetëvjeçare, kërkon që ta marrë për grua. Pas disa ditësh, e shoqja e pashait, e shoqëruar nga dy gra të bujarisë delvinjote, shkon ta kërkojë për nuse Dinën, po kjo nuk pranon. Si përgjigje sundimtarët turq i marrin pallatin, gjithë pasurinë dhe Dinën, pas disa muajsh, e dërgojnë në Janinë në një manastir-burg. Dina atje njihet me një shoqe dhe lidh miqësi të ngushtë me të. Po murgeshat i ndajnë. Dy vajzat vuajnë shumë. Dina sëmuret rëndë. Gjyshja e saj, zonja e Arianitëve me ferman otoman, vjen ta lirojë nga burgu, por është vonë: Dina vdes, po kurd'herë qëndron si bijë e denjë e Arbërit dhe e fatosit Vlladan.

Ngjarjet zhvillohen në Delvinë dhe në manastirin e një udheze të liqenit të Janinës brenda një kohe rreth dy vjetësh, duke filluar në Delvinë nga pranvera e vitit 1497 dhe në Janinë mbase nga vjeshta e të njëjtit vit.

«Dina» = Në botimin e autorit emri është «Adhina», «Adina». Pasi një emër i tillë nuk është i zakonshëm as në arbëreshë, as ndër ne, e bëmë «Dina», emër shumë i përhapur, i përdorur edhe nga ilirët (Ndoshta poeti emrin «Adhina» e lidh me «Athina» «E thëna») Edhe mbiemrin poeti nuk e jep,

por ne, duke ditur nga historia se në ato kohë në Gjirokastrë dhe në Delvinë, si familje prijëse ka qenë ajo e Zënëbishajve, Vlladanit i dhamë mbiemrin Zënëbisha; pra, edhe së bijës, Dinës.

## I

1. «*nuk dëgjoheshin fyufyake*» = Poeti thotë në shënimet e tij se «fyufyake» quhen disa vegla muzikore aerofone, të bëra prej degësh të njoma dafinash, të cilave u bien fëmijët të Dielën e luleve (dafinave), kur të rinj të martuar brenda vitit, sipas zakonit, çonin përpara altarit (në kisha) kurorë ose tufë dafinash e lulësh.
2. «*si sheshesh të s'ëmave*» = Me këtë shprehje popullore poeti shfryn dufin e urrejtjes kundër shkelësve otomanë, të cilët silleshin në vendin tonë si të ishin në mall të tyre.
3. «*Dhe pastaj ngarlat gërshetat*» = Dhe pastaj ndën gërshetat.

## II

1. «*vrap zhvesh cohën dhe pështjerit*» = Me të shpejtë zhvesh pallton (e ditëve të kremte) dhe ngjesh përparsen (futën) e ditëve të punës. Malësorët e Veriut «përshtjerit» të arbëreshëve i thonë «pështjellak».

## III

1. «*që të spastrojë lirishtën*» = Që të shkulë barërat e këqia prej ngastrës së mbjellur me li.
2. «*me kufa plot bukë gruri*» = Me shporta kashte rrumbullake e të thella, të mbushura me bukë të grunjte.

3. «Dorën e Gjinlekajve» = Poeti kësaj zonje bujare i jep mbiemrin e «Gjinecëve». Por tradita delvinjote popullore dhe dokumentare na thotë se familja më e vjetër e Delvinës ka qenë ajo e Gjinaleksajve (e Gjinlekajve); andaj edhe ne e bëmë e Gjinlekajve. Poeti, duke vënë në shoqërim të së shoqes së pashait të Janinës dy gra të bujarëve të Delvinës, Dorën e Gjinlekajve dhe Verën e Toçenjve, na tregon se vetë bujarët, me qëndrimin e tyre plot lëshime ndaj otomanëve shkelës, po tradhtonin idealet, për të cilat ishte derdhur aq gjak për lirinë e Arbërit kur ishin gjallë fatosa si Skënderbeu, Bozdari dhe Vlladani me shokë. Helmin e «bashkëjetesës paqësore» me shkëlësit e atdheut, kjo kategori bujarësh kërkonte që t'ia derdhte në rrëmbat edhe Dinës së Zënëbishaive, por kjo (shihni më poshtë) u jep të vetmen përgjigje që i kishte hije: atë të përbuzjes, pa marrë parasysh pasojat shumë të rënda që do t'i binin mbi kokë, ashtu si i ranë.

4. «që nuk doja ç'të kërkoja» = Otomania fodulle, kur e sheh se argumenti «llokum» nuk i piu ujë me Dinën arbëreshë, përnjëherësh nxori argumentin tjetër të të gjithë tiranëve, «kërbaçin» kanosjen: aty për aty — Dinës i jep të kuptojë se gjithë premtimet që i bëri nuk ishin veçse profka e lajka, sa për ta kthyer në një «kopile» haremi për të birin.

5. «në kohën kur nisin pubzat» = Në kohën kur nisin nga puna e tyre krimbat e mëndafshit (pubzat).

6. «shtëpitë shkrepa në mbytje» = Në liqen pasqyroheshin shtëpitë, të përthyerat si me pullaze poshtë.

#### IV

1. «Si ndodh vallë që një zot» = Vashat-murga japin she-njat e para të revoltës së tyre kundër vetë zotit (perëndisë), që me fjalë e predikime priftërinjsh në kisha u paraqitej si



i drejtë, mëshirëmadh, kurse në të vërtetë lejonte të gjitha padrejtësitë, lejonte që të kishte edhe burgje të zymta, siç ishte manastiri i tyre, kurse jashtë vlonte jeta, drita, gëzimi në natyrë, por jo ndër njerëzit, disa prej të cilëve të dërrmuar nga kushtet e rënda të pushtimit otoman edhe vinin e luteshin më kot përpara lartarëve (altarëve) të kishave për të kërkuar, të pakën, përdëllim në jetën e tejvarrit, të cilën askush nuk e ka parë (pra, as që është) kurse jeta e vërtetë për njeriun është këtu në tokë, thotë poeti. (Shihni pak më poshtë).

2. «*vasha Nushë e Cërikut*» = Poeti Nushën e quan Stanisha, por pasi ky emër ndër ne njihet vetëm si emër për meshkuj, përdorëm emrin «Nusha» që është i përhapur dhe që në të njëjtën kohë është edhe zvogëlim i Stanushës. Poeti i jep mbiemrin Cerigo, Cëriku dhe e bën të sjellur këtu nga një ujdhezë. Mbase poeti ka pasë përpara syve ujdhezat e arbëreshëve të Greqisë. Emrin «Nushë» e pëlqyem edhe sepse në një farë mënyre, eufonikisht, dy emrat «Dinë» dhe «Nushë» shqiptohen edhe si një emër i vetëm «Din-Nushë», «Dinushë». Në këtë këngë poeti i thur himn dashurisë së pastër në mes dy njerëzve, të cilët, siç thotë një shprehje popullore «janë dy trupa e një shpirt, një zemër», ashtu si janë këtu edhe dy vashat Dina e Nusha.

## V

1. «*Ato dhe zotin harruan*» = Dy vashat Dina dhe Nusha, më përpara të revoltuara kundër padrejtësive të zotit, që ndante botën në të burgosur e të mjerë dhe në të pasur e të fuqishëm, (kujtoni: vargjet e fillimit të seksionit IV të kësaj kënge), tani zotin e harrojnë fare dhe çaste gëzimi gjejnë vetëm te miqësia e pastër në mes tyre.

2. «*pa nga hekurea shihnin*» = Dhe nga kangjella e hekurt vashat murga shikonin se si nga pasuria që ato patën (tani në duar të kujdestareve të manastirit), kohë pas kohe, bëheshin edhe lëmosha në pleq, të gjymtuar, të cilët ndoshta mund të kishin qenë edhe ish-luftëtarë për mbrojtjen e lirisë së Arbërit, Dhe Dina, më tepër se të tjerat dëshpërohej edhe për shkakun se prej pasurisë së saj, të grabitur prej shtypësve otomanë, thujse asgjë nuk kishte mbetur për t'u përdorur të pakën si ndihmë për këta të mjerë. Por me vargjet e mëposhtme: «ajo kishte më pak pjesë (në këto lëmosha) se më pak ishte e zotit», ne jemi të mendjes se poeti godit edhe vetë institucionet fetare, të cilat u sigurojnë qetësinë shpirtërore» dhe «mbretërinë e qiejve» vetë atyre njerëzve që «u dhurojnë» sa më tepër të mira materiale të kësaj toke vetë institucioneve fetare. (Kujtoni të famëshmet «mëshirata» (indulgenca) në copa letrash të papëve që sa më shtrenjtë paguheshin nga njerëzit aq më të «sigurt» këta e kishin vendin në «parajsën e botës qiellore»!)

3. «*mbrëmjes majës së Tomorit*» = Poeti, ndoshta duke u mbështetur në materiale gjeografike të kohës së tij, përdor emrin skllav «Zagori» (po «zagori» do të thotë edhe «prapamal»), kurse këtu është fjala për maja malesh. Nga manastiri burg, ku qëndron e mbyllur vasha në ujdhezën brenda liqenit të Janinës, mund të duken edhe Xhumerka, që lashtit quhej Tomar, Tomor. Andaj emrin «Zagori» e zëvendësuam me emrin «Tomori».

4. «*atje lidhen nuse e dhëndër*» = Në këto dhe vargjet që pasojnë kemi një sulm të fortë kundër martesave që nuk kanë në themel të tyre dashurinë e vërtetë.

5. «*përqark veshve m'i shakmizte*» = Rreth veshëve m'i shpupuriste.

## VI

1. «*i përzëni ndër të huaj*» = I mërguari, emigranti, njeriu që nuk rri dot në vend të tij të pushtuar nga të huajt; pra, emigranti politik, i detyruar të lerë atdheun dhe të shkojë në vend të huaj.

## VII

1. «*e të bushtrave kllogjresha*» = E shpirtkatraneve, e shpirtgrave murgesha.

2. «*radhëtarisht kuvendonte*» = Bisedonte në mënyrën më të zakonshme popullore. Në Bregdet (Qeparo) «njeri radhëtar» quhet një njeri që s'mbahet me të madh, krejt si një njeri i zakonshëm (ordinar).

3. «*tretur n'ërë, ku gjë s'njohu*» = Lutjet i treteshin në qiell dhe drejt qiellit, ku më kot mendohej të zbulonte zotin, por që nuk e zbuloi, sepse atje, në qiell, në erë nuk ka zot.

## IX

1. «*Akerusi dhe për pak*» = Poeti me emrin e lashtë «Akerusi» quan liqenin e Janinës.

2. «*Zvjerdhur nga të tilla fjalë*» = Edhe vetë zogjtë zvirdden, u vjen të pështyrë, na thotë poeti, kur njerëz të klasave të larta, nisin të shfryjnë urrejtjen e tyre kundër të varfërve (kundër vajzës së mëndeshës e dadës së vajzës aristokrate).

3. «*gjyshja e saj, zonjë Arianitja*» = Këtë personazh e shikojmë që në këngën e parë, në takimin e saj me Bozdarin. Që Arianitët pranuan një farë «bashkjetese paqësore» me sulltanët, kjo na vërtetohet edhe nga historia. Kjo zonjë ka sjellë «vendimrënien e burgimit» fermanin që shfuqizon

(anulon) dënimin me burgim të Dinës. Por, nga përgjigja dhe qëndrimi i Dinës, marrim vesh se në Arbëri ka forca, kryesisht të reja, si Dina me shoqe, që pëlqejnë më mirë vdekjen, se sa rrojtjen në hije të bajrakëve të sulltanëve.

4. «*e tyt eti, trim bujar. . .*» = Nga këto fjale të Nushës kuptojmë se dashuria në mes të dy vashave nuk kishte qenë thjeshtë një dashuri ndjenjash personale, por një dashuri e mbështetur në të njëjtat ideale patriotike: Dina e ka kalitur Nushën edhe si luftëtare për çlirimin e atdheut. Pra, për Nushën, Dina edhe e vdekur mbetet lule e vashave arbëreshe: flamur kushtrimi për mbrojtjen e nderit dhe për çlirimin e atdheut!

## KËNGA E KATËRT

### VIDA ARIANITI

*Me vdekjen e sulltan Bajazitit më 1512 dhe hyrjen në fron të Perandorisë Otomane të sulltan Selimit, për tetë vjetët e sundimit të këtij sulltani (1512-1520) vëmendja otomane nga Evropa kalon në shtypjen e heretikëve, shiitë, të irakëve, armenëve, mamelukëve egjiptianë, sudanezëve. Brenda kësaj kohe ky sulltan i egër, ndaj arbëreshëve përdori demagogjinë e miqësisë, së cilës pati edhe krerë arbëreshë që i besuan përkohësisht. Ndër ta është edhe bujari plak, i rënë nga vakti, i ati i vashës Vidë. Këtë vashë, na thotë poeti, sulltan Selimi (që këtu prej poetit bëhet përmbi njëzet vjet më i ri nga sa ishte në të vërtetë), e njej gjatë strehimit në shtëpinë e saj në një ditë me shi dhe e kërkon për grua. I ati i vashës, duke besuar se mos kështu mund t'i shërbehej më mirë Arbërit dhe familjes së tij, bind vashër. që të pranojë dorën e sulltanit. Anija e sulltanit, e komanduar nga një arbëresh, Gramosi, ndaj të cilit sulltani sillej si mik, vjen*

dhe e merr Vidën. Në udhëtim për në Stamboll, Vida, në bisedat me Gramosin, zgjon ndjenjat e topitura të atdhedashurisë të ky djalosh i zymtë e plot kontradikta. Një vashë spanjolle, e cila krejt e rrëmbyer nga bukuria e Gramosit, kishte lënë familjen dhe ndodhej në anije, sheh tek afrimi Gramos-Vidë rrezikun e dashurisë së saj për Gramosin dhe në çastin kur zbresin në Stamboll, duke mos kontrolluar dot veten, ndjek Vidën dhe futet brenda mureve të pallatit. Kur kupton se ku ndodhet, ikën si e ndërkrayer dhe zhduket. Më vonë merret vesh se kjo ka vdekur, si duket e mbytur në det. Vida, në takimin me Selimin, shfaq shqetësimin e saj për fatin e Arbërit dhe të njerëzve të saj. Sulltani i premtonte lirinë e Arbërit dhe i kërkon një njeri shumë të besuar, me të cilin do të çojë në Arbër lajmin aq shumë të gëzuar. Vasha si njeri shumë të besuar i paraqit Gramosin. Sulltani nuk flet, po largohet. Shpejt marrim vesh se në Arbër ka plasë një kryengritje dhe në krye të saj është vetë Gramosi. Sulltani, që vjen vetë në Arbër për të shtypur kryengritjen, merr vesh se Gramosi qenkej nxitur për kryengritje nga një vashë. Sulltani, që e njihte Gramosin si një të ri që nuk u zinte shumë besë-grave mejtonte se e vetmja grua që mund ta bënte për vete Gramosin nuk mund të ishte veçse Vida. Dhe, pasi ka shpëtuar për qime nga Gramosi, jep urdhër sapo kthehet në Stamboll, që të ndërtohet një pirg i lartë në majë të një shkëmbi, i rrahur nga shiu e të gjitha shqotat; dhe atje mbyll Vidën, me qëllim që të vdesë. Dhe kështu mbaron edhe Vida, e cila, sipas një legjende kthehet në zog.

Ngjarjet e kësaj kënge nisin në Arbër, vazhdojnë në det. mbarojnë në Stamboll, brenda një kohe mjaft të shkurtër të vitit 1512.

«Vida» = Poeti e quan *Vidhelaidhe*, *Videalaide*. Një emër i tillë nuk është i përgjithshëm as ndër arbëreshët, as ndër ne. Ne mbajfëm pjesën e parë *Vidë-a*, sepse është i përgjithshëm ndër ne, dhe në të njëjtën kohë, siç na thotë poeti në fund,

rreth këtij personazhi u krijua legjenda popullore se, sapo vdiq, kjo vashë u kthye në zog, pra, emri Vidë (pëllumbeshë) pajtohet edhe me këtë legjendë. Mbiemër poeti nuk i jep, por e bën mbesë të Muzakajve (shihni seksionin II të kësaj kënge). Ne e dimë se Arianitaj e Muzakaj kanë pasë krushqira në mes tyre. Dimë gjithashtu, se në rrugën e bashkjetesës paqësore dhe të miqësisë me sultanët, ecën, pas vdekjes së Skënderbeut, në mënyrë të veçantë Arianitët. (Këtë na e lë ta kuptojmë edhe poeti në tri këngët e para). Kjo këngë e katërt, që përbën epilogun e poemës «Rrëfime të Arbërit», logjikisht duhet të ketë lidhje po me Arianitët. Në këngën e tretë, një zonjë të Arianitëve (gjyshen e Dinës dhe mëmën e protagonistëve të dy këngëve të para, të Miranës dhe të Dilinës), e shikojmë të katandisur në ndërmjetëse në mes sundimtarëve otomanë dhe viktimave arbëreshe (Dinës së burgosur). Këtu, në këngën e katërt, kjo vijë politike Arianitët nuk mund t'i çojë veçse në katastrofa më të mëdha: në asgjësimin moral dhe fizik, në një tetralogji tragjike, si familje prijësish arbëreshë. Në këto kohë bregdetasit labë-himarjotë, dikur besnikë të Arianitëve dhe tani besnikë të Kastriotëve, kaq shumë i urrejnë pasardhësit e kësaj familjeje, sa nuk ngurrojnë t'i vrasin si tradhtarë. (Kujtoni fundin tragjik të Komnjan Arianitit në fillim të vitit 1486) Për këto shkaqe ne i vumë edhe Vidës mbiemrin Arianiti.

«Gramosi» = Poeti i vë një emër pak të çuditshëm për veshin tonë. E quan «Mosgrave». Gjatë studimit të këngës dhe tipareve që i mvësh kësaj figure poeti, ne arritëm të mejtujmë se ky emër ka shumë mundësi që të jetë një krijim i poetit, një epitete i nxjerrë nga një karakteristikë e kësaj figure: gjatë jetës plot aventura si detar, Gramosi ka arritur të formojë edhe disa koncepte shumë të njëanshme për gratë, këto i duken mendjelehta, dhe ka nisur të mos u zërë besë (me përjashtim të arbëresheve). Pra, nga epitete që i kanë veshur të tjerët, ose edhe ai vetvetes, si «armik i gra-

ve» (greqisht «misogjin») De Rada ka krijuar kompozitën «mos-grave» (*mos* u afro *grave*). Ne, për të ruajtur këtë karakteristikë të kësaj figure, dhe njëkohësisht, për ta bërë të afërt për veshin tonë, dy pjesët përbërëse të kompozitës deradiane i kthyem: pra, nga «mos-grave» bëme «gra-mos», emër i njohur edhe ndër ne edhe për meshkuj, pasi është omonim dhe me emrin e malit Gramos.

## II

1. «*U rrashit anija e niset*» = Ngriti spirancat anija dhe u nis.

2. «*Dhe tani si varr më duket*» = Poeti, vlerësonjës shumë i hollë dhe i thellë i grave të virtytshme, edhe në rrethana kaq delikate, duke i cilësuar si viktime të burrave dhe të ndërleseve (konjunkturave) për të cilat përgjegjësia bie kryesisht mbi burrat, na jep gjendjen e rëndë shpirtërore të Vidës.

3. «*ngazëllimin dhe lirinë*» = Gramosi, djalosh i zymtë, përpara kësaj arbëresheje, si përpara motrës së tij më të dashur, përnjëherësh hap zemrën e tij prej arbëresni: pa liri nuk mund të ketë gëzime, pra, edhe nderi i kësaj vashe e kërkonte që të mos i ndahej Arbërit në asnjë mënyrë.

4. «*siç nuk pyesin edhe ligjet*» = Poeti godit institucionet ligjvënëse, të cilat mbrojnë klasat në fuqi, pa çarë aspak kokën për të mjerët, për masat që shfrytëzohen dhe vuajnë.

## III

1. «*në pod të arenësë*» = Kënga e vashës së Granadës spanjolle duhet të cilësohet si një romancë në mes një vajze dhe një demtari (torrerosi, atleti që ndeshet me demat në arenat spanjolle). Pra vasha, si mund të shkonte në lozhë

të arenës që ta shikonte gjatë ndeshjes, kur ai nuk i afrohej as në terrin e natës?

2. «*pastaj n'ar prej mëmash veshur*» = Bijtë e bujarëve parazitë, që nuk jetojnë me djersën e ballit, po jetojnë dhe vishen e ngjishen nga prindët e tyre.

#### IV

1. «*Apo linda si rrufeja*» = Gramosi dënon vetveten, që u besoi premtimeve dhe lajkave të sulltan Selimit dhe bashkëpunoi me të edhe në luftëra kundër popujve të tjerë. Poeti nuk na thotë si Gramosi ndodhet me otomanët, po nuk ka të ngjarë që të jetë ndonjë jeniçer i rrëmbyer që fëmijë, sepse është shumë i afërt me ngjarjet, zakonet, jetën e Arbërit dhe Julies nuk ia fal përbuzjen që kjo tregon për shokët e tij detarë arbëreshë.

2. «*vetë fronë e gjithë dheut*» = Te fjalët e Gramosit ne shikojmë bindjet e vetë De Radës rreth njerëzve (kuadrove) që meritojnë të drejtojnë: këta nuk mund të jenë veçse njerëz shumë të ndershëm, të virtytshëm, njerëz që janë gati të therorësohen për atdheun dhe popullin.

3. «*E s'dua prehje/në gjë grash: dua liri!*» = Jemi të mendjes se ky është çasti që Gramosi vendos njëherë e mirë të presë urat me sundimtarët otomanë dhe të hidhet në kryengritje për çlirimin e atdheut.

#### V

1. «*si tërzimë karkarelesh*» = Si zhurmërimë bulkthësh. Te kjo skenë e të arratisurit kemi, në të njëjtën kohë, çaste autobiografike të poetit, por edhe çaste nga gjendja shpirtërore e Gramosit, i cili ka vendosë të hidhet në luftë kundër



«zgjedhës së tiranëve» «me plot bindje se edhe bota/do të  
gdhihet pa zinxhirë.»

## VII

1. «*ta gëzojnë gjithë njerëzit*» = Toka duhet t'u takojë atyre që e punojnë dhe nuk duhet të lihet trashëgim, sepse është e të gjithëve.
2. «*në Grainë e lashtë*» = Në Greqinë e lashtë. (Kujtoni shënimin e poetit rreth etimologjisë së kësaj fjale që kemi përmendur më lart).

## VIII

1. «*të zij fronin e rigatës*» = Të zij fronin e mbretërisë.
2. «*sikur dielli vetë i thotë*» = Poeti shpesh i drejtohet diellit si simbolit të përjetësisë dhe të së vërtetës, pra, edhe si dëshmitar të lavdive arbëreshe.

## IX

1. «*që në çdo rrëtokth të egër*» = Që në çdo rrëmbim, pështjellim, marrëmendje të egër të dallgëve.
2. «*një zog pendëkaltër foli*» = Poeti me anë të zogut na jep shumë bukur ngjarjet që u zhvilluan në Arbër, heroizmat e Gramosit dhe fundin e tij.
3. «*bij nga rod që mundi Azinë*» = Arbëreshët, shqiptarët, bij të një populli që dërrmoi me Lekën shkelësit persë dhe me Skënderbenë shkelësit otomanë, kurrë nuk mund të mposhten, po kurdoherë do të fitojnë. Gramosi këtu është për poetin një ndër ata udhëheqës të rinj ushtarakë, të dalë nga gjiri i popullit arbëresh, që me djelmosha si detarët e Gramosit, patjetër do ta çlirojnë Arbërin.
4. «*pasi i kthen qytetit tij/lumturinë që pat humbur*» = Cili

është ky qytet poeti nuk na e thotë. Por ka mundësi që të jetë Arta, pasi pranë saj poeti na jep edhe një të ngushtë deti të banuar prej të huajsh, prej të cilëve Gramosi gjen vdekjen, krejt të papritur, teksa matej të fashite një grindje që befasi kishte plasur në mes këtyre banorëve dhe detarëve të tij nga një keqkuptim i thjeshtë. Ndoshta këtu poeti ka dashë të verë në dukje se për të mposhtur një perandori, siç ishte ajo e otomanëve, duhej jo vetëm bashkimi e dashuria e gjithë arbëreshëve, por edhe mirëkuptimi e bashkërenditja e forcave tona me forca e popujt të tjerë.

## XI

1. «dhe Vida-zog mori qiellin» = Kështu e mbyll këngën e katërt dhe krejt poemën «Rrëfime të Arbërit» poeti. Pra, edhe në vdiq si vashë, Vida u kthye në zog, që fluturon qiejve dhe me shembullën e saj u thotë arbëreshëve: «Mos u besoni premtimeve, fjalëve të bukura të shkelësve, po mbështetuni në veten tuaj, në dashurinë në mes njëri-tjetrit, që të fitoni lirinë dhe të gëzoni jetën si vëllezër e motra të lumtur.»

A. VARFI

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Parathënie .....	3
Kënga e parë: Mirana Arianiti .....	21
Kënga e dytë: Dilina Arianiti .....	81
Kënga e tretë: Dina Zënëbisha .....	99
Kënga e katërt: Vida Arianiti .....	135
Shënime .....	180